ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 18 DHJETOR 2021. NUMËR 161 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

ADIL OLLURI:
KAM SHKRUAR PËR NJË FRIKË TË ZAKONSHME NË NJË TË PAZAKONSHME, SIÇ ISHTE LUFTA E FUNDIT NË KOSOVË

Bisedoi Andreas Dushi

FITUESIT E PANAIRIT TË LIBRIT "FIERI 2021"

HELENA KADARE

MEHMET KRAJA

BARDHYL LONDO

FATMIR TOÇI

GAZETA EXLIBRIS

SFIDAT E SHKENCËS ALBANOLOGJIKE NË HARTIMIN E HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPTARE

Nga Floresha Dado (fq. 6)

Pse sfida të albanologjisë? Sepse ky projekt i madh shkencor jo vetëm pret, prej dekadash, të realizohet në nivelin e një monumenti të rëndësishëm të kulturës shqiptare, por edhe sepse, sipas mendimit tim, akoma nuk po kuptohet se sa i domosdoshëm është diskutimi për zgjidhjen e disa parimeve konceptuale, që do të jenë garantim i suksesit të këtij realizimi...

Mbi disa koncepte të filozofisë hegeliane të historisë

DY ZHVILLIME

nga Edion Petriti (fq. 18)

Sheshi i Padovës, Rudolf Marku dhe piedestali 88

Nga Mark Simoni (fq. 5)

FËMIJËT E SOTËM SHQIPTARË DHE GJUHËT SHUMËNGJYRËSHE

Nga Elona Kola (fq. 8)

SHËNIME PËR LIBRAT

Libri me tregime i Dionis Priftit

BOTA E "BAR SAHARA"

Nga Andi Nika (fq. 8)

Refleksion pas përkthimit të librit "MBI KOHËN DHE UJIN" të autorit islandez Andri Snaer Magnason, "OMBRA GVG"

MBI EKOCIDIN DHE SHPËRFILLJEN

Nga Elvi Proko (fq. 19)

KAFKA: NJË FUND APO NJË FILLIM?

Nga Morten Hoi Jensen (fq. 20)

REMBRANDT: ROJAT E NATËS

Dr. Bledar Kurti (fq. 22)

NË SHTËPI S'DO JETË ASKUSH...

poezi nga BORIS PASTERNAK



(fq. 16)

Përktheu nga origjinali Agron TUFA

BIBLIOTEKË

Luan Rama (fq. 12)
Kthimi i aviatorit anglez

Bajram Sefaj (fq. 9)
Nëpër terr e nëpër natë!

Esmeralda Shpata (fq. 14)
Katër tregime

Dhimitër Fuqi (fq. 15)
Unë e kaluara dhe e ardhmja

Arbër Selmani (fq. 21)
Motrës në karrocë

Dituri Dizdari (fq. 11)
Dashuri nga largësia

TOTEMI GJUHA E SHKRUAR DHE -KALIMI I VDEKJES

Nga Ballsor Hoxha (fq. 4)

SADIK BEJKO DHE NJERIU UNIVERSAL NË POEZI

Nga Ibrahim Vasjari (fq. 9)

PYETËSORI "LIBRAT E JETËS SIME"

BESNIK MUSTAFAJ:

Libri që më ka ndryshuar jetën?

Do të kisha thënë "Pinoku". (fq. 10)

ADIL OLLURI:

KAM SHKRUAR PËR NJË FRIKË TË ZAKONSHME NË NJË TË PAZAKONSHME, SIÇ ISHTE LUFTA E FUNDIT NË KOSOVË.

Bisedoi Andreas Dushi

Vitin e kaluar është botuar në Tiranë romani juaj "Bartësi i shpirtrave të përzënë", pas botimit të parë në Prishtinë. Duke qenë se trajton temën e luftës, a u prit ndryshe në Kosovë e ndryshe në Tiranë?

Botimin e romanit tim edhe në Tiranë nga shtëpia botuese "Onufri" e konsideroj si një gjë shumë të mirë e të vlershme që i ka ndodhur rrugëtimit tim letrar. Nuk do të doja të bëja një krahasim të pritshmërisë në Prishtinë dhe Tiranë. Nuk besoj që më takon mua një gjë e tillë. Për mua Prishtina dhe Tirana janë pjesë e një areali të njëjtë kulturor dhe ndihem i dëshiruar dhe i mirëpritur në të dy kryeqendrat shqiptare. Një vepër e arrirë letrare besoj se do të duhej të pritej njëjtë në të dy qytetet e lartcekura.

Vetëm pak shkëputemi nga ky libër... Ju jeni përkthyer e botuar edhe në gjuhë të huaja. Meqë po flasim për horizontin e pritjes, si është raporti mes pritjes që mendonit dhe pritjes që vërtetë ju bëri lexuesi i huaj?

Shkrimtari do të duhej që krijimin e tij artistik ta përjetojë si një zog shtegtar dhe kudo që ka hapësirë për të fluturuar ta shohë si qiell të tij. Shkrimtari do të duhej që krijimin e tij artistik ta përjetojë si një zog këngëtar dhe kudo që i lejohet dhe mundësohet t'ia thotë këngës ta ndjejë si tokë të tij.

Tregimet e mia janë të përkthyera në disa gjuhë, ndërsa romani ende jo. Përkthimi në gjuhën italiane mund të them se është pritur mjaft mirë. Libri im me tregime u botua me titullin "La fiera dei sogni" dhe për të lajmëruan gazetat e mëdha, si "Corriera della serra", "La Republica" dhe "Il Manifesto". U shkruan mjaft recensione vlerësuese në gazeta e revista kulture. Një gazetë online ("Wordnews.it") nga Napoli e kishte shpallur libër të muajit (mars, 2020). Po ashtu, u shpërbleva me "Premio Ostana Internazionale" dhe në cilësinë e fituesit m'u dha mundësia që ta shkruaja një ese të shkurtër për "La lettura", që është shtojca për kulturë e gazetës "Corriera della Serra". Pra, mund të them se tregimet u pritën mirë dhe do të dëshiroja që edhe romani, nëse jo më shumë, ta ketë së paku këtë pritje që kishte proza ime e shkurtër.

Përpos në gjuhën italiane, tregimi im u përkthye edhe në gjuhën gjermane dhe si rrjedhojë aktorët e teatrit të qytetit të Grazit (Austri) e inskenuan atë ("Kthimi i babait") në një radiodramë, që u transmetua në valët e radiostacioneve austriake. Po ashtu, pati vlerësime të mira edhe në gjuhë të tjera në të cilat prozës sime iu mundësua shtegtimi.

Luftën ju nuk e shihni as nga pozita e fituesit, as nga e humbësit, por nga ajo e të frikësuarit. Pse pikërisht ky këndvështrim?

Lufta është një gjë e shëmtuar. E papastër dhe e fëlliqur në vetvete. Si e tillë, ajo ka pak fitues, disa humbës e shumë të frikësuar. Unë kam vendosur të shkruaj për ata që më së paku shkruhet, për të shumtët, për ata që janë viktima të një ploje që nuk duan ta kujtojnë. Kam shkruar për një frikë të zakonshme në një pazakonshme, siç ishte lufta e fundit në Kosovë. Mendoj se shkrimtarët shqiptarë të Kosovë është mirë të shkruajnë edhe më shumë për luftën, sepse është një temë e gjallë, një motiv letrar që i fton vazhdimisht të flasin me të e për të. Personazhet i kemi mes nesh, i kemi miq, fqinj dhe të afërm që herë pas here na tregojnë për gjëra që mund ta krijonin një prozë të mirëfilltë artistike. Nëse jo për gjë tjetër, së paku për një arkivim shpirtëror të kujtesës është e udhës që t'i kthehemi herë pas here luftës.

Lufta për shqiptarët e Kosovës është një e kaluar që nuk po kalon dot. Kështu që, asnjëherë nuk është vonë të shkruajmë për të.

Mendoni se letërsia shqipe, ajo e shkruar gjatë realizmit socialsit në Shqipëri si dhe ajo e lindur menjëherë pas lufte në Kosovë është e mbingarkuar me qasje epike të betejave, ku heroi e lufta mistifikohet?

Nuk është e udhës ta gjykojmë prodhimin letrar në tërësinë e tij. Unë nuk jam ithtar i këtij pozicioni që e vlerëson një zhvillim të tërë letrare me një prerje thike, duke ngulmuar se kjo ka qenë e mirë e kjo është e keqe. Një gjë e tillë do të na bënte moralizues dhe jo vështrues objektiv të artit letrar. Pozicioni heroik e epik nuk është apriori i keq, përndryshe nuk do të shkruheshin epet që i kanë qëndruar kohës me mijëra vjet. Kjo nuk do të thotë që nëse shkruan një roman për një hero e ke humbur "lojën" që në fillim. Po ashtu, edhe brenda realizmit socialist kemi vepra të arrira letrare, sikurse që vlen ta përmendim Jakov Xoxën, që është një shembull i bukur i prozës artistike shqipe.

Po "Bartësi i shpirtrave të përzënë", përvese si vepër me estetikën e vet unike, mund të shihet edhe si një lloj kundërshtie e asaj letërsie për të cilën folëm më lart?

Unë kam zgjedhur për të rrëfyer, jo për t'iu kundërvënë një doktrine a fenomeni letrar. Nuk do ta bëja këtë në asnjë mënyrë. Unë e kam zgjedhur atë mënyrë rrëfimi që mendoj se më përfaqëson mua më së miri. E kam zgjedhur atë mënyrë rrëfimi që i shkon për shtati, fundja, edhe natyrës sime, karakterit tim dhe mënyrës se si unë i shoh dhe përjetoj gjërat.

Nuk është në dorën time, por nuk do të doja që romani im të lexohej dhe trajtohej si një armë kundër letërsisë me rrëfim heroik. Mendoj se ka vend për të gjithë në botën e letrave, si për heroiken, po ashtu edhe për joheroiken dhe secilën qasje tjetër tematike e estetike. Fundja, një gjë e tillë nuk mund të vendoset nga unë dhe janë të tjerët, lexuesit që mund të vijnë pas shumë e shume vjetëve, të cilët mund ta lexojnë dhe shohin romanin tim si të duan. Jezusi ishte paqësor e paqedashës, por emri i tij u përdor si motiv i madh nxitës për lufta e kryqëzata të kobshme.

A mendoni se proza juaj artistike është vlerësuar sa duhet dhe siç duhet nga kritika letrare shqiptare?

Për dy përmbledhjet e mia me tregime ("Shumë rrugë dhe një rënie", "Kthimi i profetit") dhe romanin tim ("Bartësi...") kishte mjaftueshëm shkrime kritike e interpretuese, që u shkruan nga studiues, profesorë universitarë, po ashtu edhe nga shkrimtarë dhe publicistë të ndryshëm, të cilëve u kishte pëlqyer proza ime dhe thanë atë që menduan se është e vlershme për artin tim. Por, halli është se kritika nuk e ka më rolin e saj të dikurshëm dhe nuk është më nxitëse për leximin e një vepre nga grupe të ndryshme shoqërore. Kritika letrare sot nuk provokon mendim e diskutim rreth një romani a një vepre letrare dhe kjo është për keqardhje. Kritika letrare sot nuk është as promovuese e një vepre të bukur e as sqaruese e goditëse për të metat e një vepre. Pra, ajo sot as nuk promovon e as nuk parandalon gjë. Nuk e di saktë se kush ia ka marrë sot këtë rol, sepse nuk jam sociolog i kulturës për ta dhënë një mendim cilësor për këtë, por që sot kritika më nuk ka ndonjë peshë në zhvillimin e letërsisë, për këtë jam tejet i sigurt, sepse një gjë të tillë e shoh dhe e ndjej.

Si e shihni zhvillimin e letërsisë së sotme shqipe, konkretisht të prozës artistike?

Proza e sotme shqipe ka një zhvillim të lakmueshëm, me të cilin nuk mund të mos jemi të kënaqur. Sot kemi prozatorë dhe romancierë që pa asnjë dyshim janë të krahasueshëm me të ngjashmit e tyre në vende e kultura të tjera evropiane. Kam lexuar mjaftueshëm shkrimtarë të sotëm nga vende të ndryshme ballkanike dhe mund të them se në shumë pika qëndrojmë më mirë. Ajo që i nevojitet prozës së sotme shqipe është përkthimi dhe promovimi i saj në gjuhët e mëdha, si anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja etj, por edhe në gjuhët e fqinjëve tanë. Një përkthim cilësor i prozës së tashme shqipe, një shtëpi e mirëfilltë botuese, një promovim i mirë do t'i radhiste një pjesë të prozatorëve tanë (një pjesë, jo të gjithë) krahas atyre evropianë. Por, para se ta shtrojmë çështjen e përkthimit dhe promovimit të jashtëm, është e udhës të flasim për një promovim dhe nxitje të leximit të prozatorëve tanë nga lexuesi shqiptar. Ky i fundit, i nxitur nga shumë arsye, ku njëra ndër to mund të jetë edhe paragjykimi për vlerat letrare, si duket i ka braktisur paksa krijuesit e sotëm shqiptarë. Kjo gjendje ka nevojë për një shpjegim kulturor. E kemi shumë të nevojshme t'i bindim lexuesit se edhe në mesin tonë kemi krijues të mirëfilltë, të cilët e meritojnë leximin dhe vëmendjen. E kam thënë në një bashkëbisedim letrar me shkrimtarin Virion Graçin, në po këtë gazetë letrare, se kultura dhe shoqëria shqiptare jonë ka nevojë për më shumë kënde ku promovohet leximi i letërsisë shqipe dhe promovuesit e saj të sotëm janë patriotë në kuptimin sublim të fjalës.

A ka nevojë sot kultura jonë për më shumë organizata e klube të shkrimtarëve apo për klube të lexuesve?

Dikur kam qenë ithtar i organizimit të shkrimtarëve në klube e organizata të pavarura letrare, të cilat mendoja se mund ta luajnë një rol qenësor në zhvillimin dhe promovimin e letërsisë së tashme shqipe. Ndërsa, sot mendoj se shoqëria dhe kultura jonë ka nevojë për sa më shumë klube të lexuesve të letërsisë shqipe, të cilët do të mund të organizoheshin në mënyrë të pavarur nga shkrimtarët, botuesit, kritikët e profesorët e ndryshëm të letërsisë. Kemi nevojë për klube të dashamirësve të librit shqip, të cilët janë lexues të pasionuar dhe dashamirës të pasherrë

të krijuesve të sotëm shqiptarë. Do të gëzohesha nëse në të ardhmen do të shihja themelimin e tillave klube të lexuesve që nuk kanë pretendime për t'u bërë edhe vetë shkrimtarë, kritikë a botues, gjë që në vendet tona të tillët është vështirë për t'i gjetur.

Përveçse shkrimtar, ju jeni edhe studiues, veçanërisht i letërsisë postmoderne shqipe. Me këtë term sot abuzohet shumë, ku kategorizimi apo vetëkategorizimi si i tillë mbështjell me mister shumë shkrimtarë. Nuk e di, cili është mendimi juaj për këtë?

Në vitin 2013 e kam botuar në Prishtinë librin tim studimor "Romani postmodern shqiptar", e që pas dy viteve u ribotua në Tiranë nga UETpress. Me këtë vepër doja ta bëja një studim evidencues që dëshmonte praninë e një formacioni a modeli të ri letrar mes nesh. Në të i trajtova një sërë romanesh që kanë natyrë dhe elemente përbërëse të poetikës së postmodernizimit. Ndoshta kam lënë jashtë trajtimit disa romane shqipe që i përkasin kësaj poetike, por qëllimi im nuk ishte ta bëja një studim shterues, por më shumë një studim që dëshmonte praninë e postmodernizimit në letërsinë shqipe me të gjitha tiparet që i ka kjo poetikë. Në vitet 2011-2013, kur shkruaja më shumë rreth teorive letrare dhe kisha më shumë nxitje prej studiuesi, bëhej shumë zhurmë rreth postmodernizimit, si në Tiranë, po ashtu edhe në Prishtinë. Kritikë që nuk kishin njohuri të thella teorike i cilësonin si postmoderne romane që nuk ishin të kësaj natyre, duke menduar se me këtë cilësim po i vlerësonin ata. U përpoqa ta dëshmoja se epiteti postmodern është epitet formal dhe jo aksiologjik. Qëllimi im ishte që ta sqaroja sa më shumë këtë model letrar dhe të dëshmoja se postmodernizmi ishte një yrnek letrar me përbërësit e tij të dallueshëm. Nuk e di sa ia kam arritur këtij qëllimi, sepse ende shoh ngatërrime të tilla, natyrisht jo në masën siç ngjante dhjetë vite më parë.

Të them të drejtën, i dashuri Andreas, unë kam më shumë vepra studimore se sa artistike, por botimet, ribotimet, përkthimet e prozës sime artistike, shkrimet dhe recensionet e shumta për të, sikur i kanë lënë nën hije librat e mi studimorë. Mendoj se mirë kanë bërë. Kam bindjen se shoqëria shqiptare më shumë më ka pranuar dhe mirëpritur si prozator, si krijues, dhe kjo nuk ka asgjë të keqe. Ne nuk mund të vendosim se cila vepër të na vlerësohet e cila jo. Fundja, letërsia artistike në çdo vend lexohet, diskutohet, komentohet dhe vlerësohet më shumë.

Është pyetje e zakonshme dhe e bezdisshme për këdo shkrimtar, por duke qenë se ajo pjesë e bibliotekës ku gjenden librat tuaj nuk numëron shumë tituj, vjen natyrshëm: keni diçka tjetër në dorë këto kohë? Nëse po, çfarë mund të thoni për të?

Jam duke punuar në romanin tim të ri, të dytin më radhë, dhe shpresoj që nëse jo më shumë, së paku të mirëpritet sa "Bartësi i shpirtrave të përzënë". Gjithsesi, nuk është autori ai që vendos për këtë. T'ia lëmë kohës, sepse ajo është gjykuesja më e mirë e gjërave.

TOTEMI GJUHA E SHKRUAR DHE -KALIMI I VDEKJES

nga Ballsor Hoxha

I

Kurbani - kokat e Omer Kaleshit

Kur i shikon pikturat e Omer Kaleshit, ato ngjajnë në lojë fëmijësh. Koka pa trup, e këputur, këputet si lodër dhe bëhet top. Apo koka këputet dhe bëhet qepë. Aq më shumë i shërben fëmijës që të krijoj një univers, qoftë ushtrie, babarogash (fjalë e qëllimshme sllave), apo 'dordolecësh'.

Por, në të vërtetë, këto koka, Kaleshiane, kanë edhe atë që bën të pyetet Kadare, dhe shumë të tjerë që magjepsen nga kjo 'lojë' e Omer Kaleshit, e që është, prej nga vijnë ato? Apo për ta thënë saktë: ç' është kjo dramë? Ç' është kjo tragjedi që i bën kaq të bindur. Kaq të qetë. Kaq shpirtëror, shpirtin shfaqur në fytyrat, në kokat, Kaleshiane.

Kadare në esenë e tij mbi Omer Kaleshin, shpërfaqë tërë historinë e këtij regjioni, përfshirë edhe Stambollin e Parisin, rrënjët si në pikturën e fundit të Van Gogh të Kaleshit, nënën maqedonase, babanë shqiptar, i deportuar në Turqi, dhe i edukuar po aty, e i mirënjohur në Paris. Dhe po ashtu, mëkatin e tij, Kaleshian, artin e tij, si ngulitje në këtë, mëkat? Apo shpërthim tutje tij?

Koka, sikur ajo e kurbanit, flijimit, është tërë ajo që mbetet nga ky rit, nga ky kumt, nga kjo politikë, po ashtu! Trupi, ose hahet, si ai i deles, ose harrohet nën makthin e terrorit të këtij riti.

Në shumë raste, apo qoftë në film e fotografi, ne vetëm në kokën e rënë në tokë, në kokën e prerë, le të themi të deles, shohim të vërtetën e bindjes këtij riti. Shohim, fajin? Shohim konfirmimin e zotit?

Në kokën e shtrirë në tokë, gjakun duke rrjedhë e fluskat e tij që ende nuk i binden ritit, vrasjes e çka do që është kjo, ngulmojmë duke e shikuar po të njëjtën, dhe përkujtojmë veten se edhe jemi, dhe edhe që mund të jemi ne, vetë delja!

Ngjanë e dramatizuar kjo, ngjanë edhe e tmerrshme, ngjanë edhe skandaloze dhe blasfemi!

Në këtë, duke iu kthyer, kokave të Omer Kaleshit, qetësisë së tyre të 'tejjetshme', paqes së tyre, ndërmjet vdekjes e jetës, dhe tërë pranimit të tyre – sikur pranojnë – tërë të qënit, në tërë pambarueshmërinë e njeriut, kokat e pikturave të tij janë vetë vdekja, dhe, po ashtu, vetë spiranca e kësaj pambarueshmërie.

Apo, nëse, shmangim këtë pamje të frikshme, ndoshta, mund të shohim dhe një paqë, e koka të gëzueshme, të dashura, e përplot njerëzi.

Por, Kadare, në këtë, në esenë e tij për Kaleshin, na e jep një udhë tejet tejet të rëndë, të vështirë e të pakalueshme për çdo njeri, jo vetëm të udhës së Kaleshit, por edhe të vetë njeriut të kësaj prejardhjeje. Flakët dhe kafshët e djegura që ikin nga shtalla, njerëz, pastaj po ashtu të kallur, në fëmijërinë e këtij piktori. Pastaj tërë historia e dënimit dhe fajit, në këto rajone, nuk të lënë shumë për të imagjinuar, së paku një fund të lumtur të këtyre kokave!

Por, kjo nuk është më e rëndësishmja në pikturën e Kaleshit. Piktura e tij, në kokë, në koka, në kokëzim të njerëzimit, është edhe hu, dhe edhe ndalesë, sikur pamja e fundit në ikjen e fëmijës nga masakra, nga masakra e njeriut ndaj njeriut.

Mund të shkojmë edhe më larg, e të imagjinojmë kthimin e kokave të prera, të flijuara, të masakruara, të kallura, të vrara, kthimin e tyre, përmes krijimit infantil, si teknikë e Kaleshit, si qerthull që nuk lejon harrimin, jo se njeriu është aq i mirë, por se është 'ligj', siç thotë Kadare.

Mund të shkojmë edhe më tutje, dhe përmes teorisë së psikanalizës, të qëmtojmë gjurmën e ankthit ndaj vdekjes, të vetë autorit, në këta sy, fytyra e koka. Sy të përmbushur, të kënaqur, pranuar dhe bindur, që kumtojnë nga vdekja. Si infantile e cila palosë dhe qetëson vdekjen.

Kadare e shtron kompleksin e dallimit midis trupit dhe kokës, derisa flet për Omer Kaleshin, e në këtë kokat e Kaleshit, veçuar prej trupave të tyre, sikur trupat e flijimit, ritit të kurbanit, të ankthit të njeriut ndaj vdekjes, dhe të ankthit të njeriut ndaj tjetrit, në tërë udhën e tij, pra të Omer Kaleshit, janë hunj, e koka, si ndalesë, e si thurje e pëlhurës së kujtesës, e cila kokëzon njerëzimin por edhe masakrën e njeriut ndaj njeriut.

Prandaj, le t'i kthehemi ritit të kurbanit, këtu, jo vetëm si relikt i egërsisë së njeriut, e të ankthit të njeriut, nga vetë zoti i tij të cilin e bartë në shpinë, vetë krijimi i tij të cilin e ka stërmbushur me – koka -, por edhe si aktuale e njerëzimit (në ish territoret e ISIS e të Irakut, e tash në Afganistan, etj) që doemos duhet të ndalojë 'pambarueshmërinë' e të njohurës së tij, të rikthimit të kokave të prera, dhe të murëzimit të vetes brenda të njohurës së përhershme, ndanë një zoti të shpikur nga ai, nën ankthin e vetë Kainit brenda tij.

II

Kadare – Eskili ky humbës i madh, apo njerëzimi ky humbës i madh

Totemi – pushteti dhe ankthi i njerëzimit në eskilianen (lexo: Kadareanen)

A nuk janë tragjeditë njerëzore, vdekja, ndoshta edhe martesa – përpjekje e vegjëlisë së njeriut në këtë tokë të pamatë -, dhe masakra, e lufta, vetmia e tij, -takimi i fundit, kufirit të tij, njeriut?

Kadare në esenë e tij "Eskili ky humbës i madh", duke e trajtuar Eskilin si humbësi më i madh i njerëzimit, në të vërtetë thënë saktë siç e kodifikon Kadare, e që është njerëzimi i tërë, ky humbës i madh përballë Eskilit dhe eskilianes, përballë origjinën e tragjedisë - "lisin e tragjedisë" – sipas: riteve e relikteve të varrimit dhe të martesës; me filozofinë e Nietzsches saktësisht në këtë -kalim të njerëzimit, pra përmes tragjedisë.

Sipas Kadaresë, në esenë e tij mbi Eskilin dhe lindjen e tragjedisë, guri i varrit, -kaluar në skulpturat e antikitetit, e deri tek ritet e vajtojsave dhe të "*arti*ficiales" së artit, vdekja (qoftë edhe martesa siç u cek më lart), ai/ky qëniesim "me një vrimë në mes", -kaluan në art, në 'udhëzim' të vdekjes, në aftësi njerëzore të 'kthimit' të vdekjes, të qëniesuarit me të. Gjithnjë sipas Kadaresë, vetë ringjallja e Konstantinit, (përkundër riteve dhe besimeve e bindjeve të anëve të tjera të botës, siç është realizmi magjik, p.sh., etj, në të cilin nuk ka një mur ndarës mes vdekjes e qëniesimit), njeriu vetëm duke pas krijuar – artin vetë – kishte arritur të gjente dhe të rikrijonte fushën dhe -kalimin e vdekjes në qëniesim!! Ta sillte 'klandestine' qenien e vdekur, vdekjen, si gjakim për mungesën e për dhembjen, e shkëputjen e botës së njeriut, nga 'ligja' e tokës (Heidegger!)

Sipas Nietzsche 'tragjedia' ishte mekanizëm i lindur nga – falling -, fall, rënia, sipas Deleuze (një prej interpretuesve më të qëndrueshëm të Nietzsche) i njeriut përbrenda 'mekanizmit' të shpirtit të gjërave. Dhe kjo, qoftë si shpërfaqje e festave Dyonisiane, apo edhe të prerjes së kognicionit (njohjes) me maskën e tragjedisë, me korin e me skenën e saj, të inskenimit të vdekjes, njeriut të vdekur, dhe të kufirit qëniesim – vdekje!

Qoftë si kundërvënie, Kadaresë, këtu, e qoftë, aq më shumë si konfirmim i kodifikimit të Kadaresë mbi tragjedinë, Freud bën të njëjtën gjë (shih Derrida për një lexim shumë të saktë të – trace – gjurmës së Freud!!), atë që bëri Eskili, sipas Kadaresë, e atë që bëri njerëzimi në tërë -kalimin dhe -kalimet e tij. – Trace – si fshirje dhe gjurmë, në të njëjtën kohë (Derrida mbi Freud), është vetë vdekja, -kalimi dhe – *arti*ficializimi – i qëniesimit. Përpara dhe pas 'vrimës në mes'. Është identike, me fëmijëroren në ne, me naiven në ne (shih Totemi dhe Tabuja – Freud), me tri shkallët: paaftësinë, në kohë të njeriut për të bërë dallimin ndërmjet fizikes dhe shpirtërores, që u kufizua në shkallën tjetër: animen e njerëzores, pra – *arti*ficializimin – e tokës, në botë (Heidegger): dhe shkallën e radhës, krijimit të çelësve, dhe kodeve të tyre në: 'ligje', në Totem/e.

Ndoshta, në të pavetëdijshmen e trajtimit të Kadaresë, e që është arsyeja e përfshirjes së hallkës Derrida – Freud këtu, gjatë trajtimit të -kalimit të njerëzimit nga 'vrima në mes' që nuk qënieson as nuk ndien, sipas Kadaresë (që është vetëm njëra prej dy anëve të trajtimit të Kadaresë në esenë e tij "Eskili ky humbës i madh"), është e pavetëdijshme në këtë trajtim të tij, shpërfaqja/gjurma/Trace e kodeve që Eskili i – shpërfaqte – në shoqërinë tiranike të antikitetit, ishin edhe kodet e -kalimit të njeriut, nga 'lisi i njerëzores' në 'lisin politikë', në Sokratiken, Platoniken e aq më shumë në Aristotelianen, duke e – etabluar – në përhershmërinë e njeriut, politikën; të mirën; dhe shkëmbimin; ndërshkëmbimin e saj në dhunë/pushtim!

Disa herë Kadare e përsëritë skandalin ndërmjet tragjedisë dhe pushtetit të kohës së Eskilit, si ankth, si vetëdijesim (kjo si Zeitgeist e mundësi e shpërhapjes – përsëritjes/rimëkëmbjes së vullnetit njerëzor përkundër përfuqizimit dhe përqendrimit të ari-stokrates si dhunti e pushtet ndaj tjetrit), dhe si shfaqje e zbulesë e aq më shumë si – Trace – e të – fshirës – të – gjurmës – së njerëzores.

(Po, është ankth dhe gjakim i Kadaresë, qoftë i çdo njeriu, kur kjo i bëhet praktike – humbja e kodit të njerëzimit e njerëzores në të – mirën – Sokratike, Platonike e Aristoteliane -, dhe Kadare ngjanë në fëmijë jetim që di për prejardhjen e tij, si shkrimtar e si 'lis i tragjedisë', por që di po ashtu edhe për – kurbanin – e pajtimit të krimit në njeriun dhe zotërimit të vetë njeriut!! Kadare, mu sikur Mo Yan që flet për të ngrënit të qymyrit gjatë pranimit të çmimit të Nobel, zbulon, si fëmijë, tërë ankthin e tij që e barti!!, në këtë 'luzmë' të njerëzimit – fshirë, e – gjurmuar – pikërisht – sinkopën – e njeriut!!).



Përfundim

Kurbani – ishte/është kufiri, njëlloj guri (i mexhës) së njeriut ndaj ankthit të vetmisë e vdekjes së tij.

Vdekja, (në të cilën u humbën shumë shoqëri njerëzore duke mos pasur një bindje asaj – shih realizmin magjik e strukturalizmin antropologjik si urë – kurban – ndaj kësaj kimere!!), 'vrima në mes', zbrazëtira në mes, e pakthyeshmja, realja (Schopenhauer, Jacques Lacan,etj), -kaluan në Totem! Ajo që Kadare e quan 'të qarë me ligje', e që 'ligje' është pikërisht Totemi, qoftë në semantikë e qoftë në shpërfaqje të kodeve të -kalimit njerëzor.

Totemi dhe – kurbani – në tërë -kalimin e njerëzimit, ishin e njëjta gjë: ajo që Omer Kaleshi e shfaqë në tërë punën e tij: në kokën (e vdekur) njerëzore, si ankth për të ndier qoftë të dashurin e vdekur, qoftë për të mishëruar të dashurin e vdekur, e qoftë për të rikthyer të dashurin e vdekur.

Apo njeriut të vrarë, sikur Gjorgu në "Prillin e thyer", në pamundësi të bëj dallimin e atij që ka vrarë dhe vetes!

SHESHI I PADOVËS, RUDOLFI MARKU DHE PIEDESTALI 88

Nga Mark Simoni



Megjithëse qyteti i vogël i Padovës, (Itali) nuk e ka luksin të ketë një park a shesh të madh, por ama ka fisnikrinë e madhe që, nga ajo pak sipërfaqe e vogël që ka qyteti t'i falë shkrimtarëve dhe filozofëve, njerëzve të dijes dhe të kulturës parkun e pestë më të madh të Europës (Pratto della valle, 90 mijë metër katror), për tu vendosur aty 88 statujat e njerëzve më të famshëm të lindur në Padova, apo të mëdhenjëve të Italisë, që kaluan një pjesë të jetës dhe punës së tyre në këtë qytet. Aty janë poetë, shkrimtarë, dramaturgë, filozofë, mjekë, astrologë, komediografë, përkthyes e gjuhëtar, fizikantë e astrologë, që nga Tit Livi, Torquato Tasso, Petrarca, Galileo si babai i shkencës moderne (observatorin e të cilit e kam vizituar në Padova), Dantja që ishte në ekzil politik në atë qytet në 1306, (dhe strehohej tek shtëpia e piktorit të famshëm Giotto, shtëpinë e të cilit e kam parë që para 30 vitesh), etj.

S'ka në këtë park asnjë statujë tregtari a zyrtari shteti, asnjë pasanik e fajdexhi të famshëm apo njeri të politikave. Fare, fare, asnjë. Ata siç duket janë konsideruar kalimtar dhe jo përcaktues në famën dhe prestigjin e qytetit, janë gjykuar si minorë dhe jo aq të denjë për t'i dhënë famë e fisnikri emrit të Padovës. Ndërsa, krejt në tjetër mënyrë, janë respektuar poetët dhe shkrimtarët, filozofët dhe humanistët, shkenctarët dhe mjekët.

Ky park, që më ka frymëzuar sa herë që kam qenë atje, mu kujtua sot, kur mësova se Rudolf Marku, ish mësuesi im i letërsisë në gjimnaz, një nga poetët, shkrimtarët dhe përkthyesit tanë më të mirë sot në letërsinë tonë, është nderuar me titullin "Qytetar Nderi i Lezhës". Titujt jepen për të nderuar dikënd, por edhe vetë titujt kanë nevojën të nderohen. Dhe për të nderuar titujt ato duhet tu jepen vërtetë vetëm përsonaliteteve që i japin zë, i japin seriozitet dhe dimension qyteteve të tyre. Rasti i Rudolfit është ndër rastet më fatlume, që titulli "Qytetar Nderi i Lezhës" këtë radhë ka shkuar në vendin e duhur, dhe ky titull ndjehet krejt mirë e i përfaqësuar me dinjitet.

Lezha e ka shtëpinë e letërsisë me emra që i bëjnë nder nderit, ndaj dhe mendoj se kjo shtëpi është patjetër njëfarë parku në miniaturë i "Pratto della valle"-s.

Por mos të harrojmë dhe të ngutemi në dhënie titujsh pa kriter, mbasi atje në Padova, statuja e fundit, e 88-ta, është "Piedistallo vuoto" (Piedestal bosh), që pret aty prej dy shekujsh përsonazhin që vërtetë e meriton atë vend, por që deri më tash asnjë se ka përmbushur akoma atë nderim.

Në shkretëtirën e emrave komunar të njerëzve, që herë vinin nga kalendarët e vjetër fetarë, apo herë të tjera emra të nxjerrë prej romanesh, librash e filmash, emri Rudolf më pati stepur. Qeshë fëmijë kur pata rënë në këtë emër krejt të veçantë për veshët e mi, e aq më tepër që ky njeri shkruante dhe vjersha dhe i botonte në gazetat e Tiranës. Në qytetet e vogla çdo gjë që lidhej me emrin e Tiranës kishte një madhështi të veçantë, kishte ca mister distance, dhe ky vend më dukej sikur qe diku përtej atdheut. "Me i shkru letër Tiranës", "Me u vizitu në doktor të Tiranës", "Me shku në eskursion në Tiranë" (Mendoni që në Tiranë pra bëheshe një farë turisti), dhe që ky turist kthehej në provincë me panine të bardha.

Unë nuk jam mekanicist, që të mendoj se njeriun e bën emri apo në emrin e tij është nukli psikologjik dhe karakterial i tij. Unë mendoj se është njeriu që bën emrin e vet, por asnjëherë nuk e shmang impresionin dhe impaktin që ka një emër i veçantë. Unë përsonalisht njoh Ler Martinin, një shkodran të lindur në vitin 1943, që në çertifikatën e lindjes qe emri i pagzimit të tij, Hitler Martini. Dhe unë pavarësisht se e njihja në normalitetin e tij, asnjëherë nga subkoshi im nuk iku për fare energjia që më jepte emri i tij i veçantë.

Mbaj mend se një psikolog gjerman më pati thënë për skuadren e tyre të para shumë viteve, në kohën kur luante Bekenbauer, se "... pothuaj të gjithë lojtarët tanë kanë emrat zanatesh, dhe duket se pas emrit të tyre janë me mijra zanatqinj, ndaj dhe ekipi ynë nuk duket si prej 11 vetësh, por si një ushtri e pafund dhe që vërshon vetëm për fitore. Emrat ndikojnë jo pak në psikologji".

Rudof Marku qysh në krye të herës nuk e la vetëm emrin të bënte përshtypje, por, (ashtu si Rembrandi që u jep ton tipareve të përsonazheve me të kuqen e tij), ky njeri e pasuroi emrin e tij me historinë e tij, që kalonte nëpër rrafshe të thella dijesh dhe kulture, talenti të fortë dhe një rruge andrallash krijimtarie dhe leximesh e përkthimesh të pafund. Sa më shpejt ta kuptosh se sa e pamjaftueshme është një bibliotekë e vogël, se sa e ngushtë është një lagje me rrugicat me kalldrëm, se sa i vogël është një qytet që i rri ngusht botës tënde të madhe, aq më shpejt tenton t'i shpëtosh rrezikut që të mos mbetësh një herë e përgjithmonë në provincën e kulturës, të dijeve, në provincën e kësaj botë të pafund. Dhe nuk ka komardare më të sigurtë se sa dijet për të të nxjerrë në bregun tjetër të asaj bote që ti kërkon. E kam përmendur dhe në një ese timen të para gjashtë viteve se "libri është stil lirie".

Rudolf Marku e ka kuptuar shumë më herët se të tjerët këtë devizë, e ka miqësuar shumë shpejt këtë shpëtimtar. Ky autor ka qenë dhe mbetet ndër shkrimtarët më të kulturuar të të gjithë brezave, madje kultura e tij më rikonfirmon thënien e Murakamit se, letërsitë e mëdha dhe të vërteta shkruhen nga njerëz të kulturave të gjëra e të mëdha. Rudolfi është tipiku që na e konfirmon këtë tezë. Barrë të tëra librash, diturishë dhe gjuhësh të huaja, udhëtime virtuale dhe të vërteta në toka interesante dhe të largëta, një talent krejt specifik e i veçantë, kanë konfiguruar dhe ndërtuar këtë shkrimtar të njohur që kemi ne sot.

Më kujtohet se sapo opinioni ynë mësoi kalkun VIP (Very Important Person- Person i rëndësisë së veçantë) çdo kush u turravrap të etiketonte si të till çdo lloj njeriu që i dukej i rëndësishëm, pa menduar dhe pa e ditur mirë se njerëzit VIP janë të veçantë, të pa zevendsueshëm, të pa përsëritshëm, krejt të dallueshëm prej të tjerëve. Sado i lartë çoftë dikush në hierarkinë e shtetit, në postin e tij ai është i zevendsueshëm, i heqshëm, i pensionuar, ndërsa shkrimtarët, kompozitorët, piktorët janë krejt vetja e tyre e veçantë, janë rrallësia e vetvetes, janë të pa zevendsueshmit. Ka dëgjuar njeri se në vend të Lasgush Poradecit apo Frederik Rreshpjes kemi emruar dhe vënë dy poetë të tjerë, apo thotë ndokush se Mitrushin dhe Anton Pashkun i kemi zevendsuar me filanin dhe me filanin? Kur ikin të mëdhenjtë e krijimit nga kjo botë vendi mbetet bosh, në pazëllin e hartës së madhe mungon forma e tyre. Të gjithë e dijmë se kur turma ra në gjunj, i vetmi që nuk bëri temena dhe qëndroi pip në këmbë qe Saadiu, që u prezantua, se ai qe ndrysh nga të tjerët, qe Poeti.

Rudolfi qe rrebeli në letërsi dhe jetën e tij, një rrebelim substancial, i vërtetë dhe karakterial, aspak si farsë, qe një rrebelim si akt revolte, si antikonformizëm, si frymëzim për të tjerët për të qennë ndryshe nga uniformiteti, Ndaj dhe letërsia e tij ka shenja, sinjale, gjeste të shumta të modernizmit dhe të ekstravagancës estetike dhe letrare,

Popujt me kombet ndryshojnë nga njëri tjetri në shumë e shumë gjëra dhe jo thjeshtë vetëm si terma. Dhe pikë së pari në atë që, më shumë se çdo gjë kombet janë tërësia e përsonaliteteve që kanë nxjerrë prej vetes. Këto përsonalitete janë pesha specifike e një kombi, thotë Izajah Berlin.

Ndër to, të shenjtë shkrimtarët. Kanë diçka prej perëndishë. Rrobaqepësi francez ka dyqind vite që përmendet, vetëm e vetëm se Balzaku ia shkroi emrin në romanin e tij, ndërsa kryepolicit të Parisit ia dijnë emrin prej dy shekujsh, mbasi ai mori pjesë dhe mbajti arkivolin e Hygoit. Ky është bekimi që shkrimtarët e mëdhenj u kanë dhënë atyre dy burrave, që emrat e tyre pa Balzakun e Hygoin, do të kishin humbur pa nam e pa nishan.

Lagja Arcelle, në veri të Italisë e ka pjesën më të madhe të saj të mbushur me rrugë e sheshe që mbajnë emra kompozitorësh, dhe quhet zona e muzikantëve. Emra të famshëm, statuja, simbole muzike, detaje e muze, të urbanizojnë shijen me magjinë e muzikës. Ndërsa Shkodrës, që në njëqind metër rrugicë në Gjuhadol, i kanë lindur njëmbëdhjetë Artista Populli, dhe asgjë, asnjë shenjë, asnjë pllakë, dhe jo më muze e salltanete të tjera. Lezha e Fishtës dhe Mjedës kurgjë. E dijmë të gjithë Jan Kukuzelin, artistin e famshëm të Durrësit dhe emrat e tjerë të dëgjuar të atij qyteti. Por thjeshtë, nëse ai qytet do të kishte edhe një tufë rrugësh të emërtuara, qoftë dhe me emrat e lundërtarëve të famshëm që i ranë botës kryq e tërthor, (pra rruga Vasko De Gama, Kristofor kolombi, Ameriko Vespuçi, Marko Polo etj), a nuk do t'i jepni akoma më tepër atij qyteti shijen e detit dhe krenarinë e portit tonë më të madh?

Do të ndjehesha fatlum dhe do të kuptoja se gjërat po ndryshojnë për mirë, vetëm atëherë kur, në ftesat që më vijnë për promovime librash në librarinë "Frends Book House", të mos shkruhej më shënimi plotësues dhe shpjegimi se ("Libraria Frend Book House ndodhet pranë Drejtorisë së Policisë"), por, kur ndonjë ditë të më thërrisnin në Drejtorinë e Policisë, dhe në fletë-thirrje të shkruhej edhe shpjegimi se ("Drejtoria e Policisë ndodhet pranë Librarisë "Frend Book House""). Do të ndjehesha mirë atë herë kur më shumë qytetarë të Lezhës të dinin emrin e shkrimtarit Rudolf Marku, se sa emrin e policit, shefit të Komisariatit të atjeshëm.

SFIDAT E SHKENCËS ALBANOLOGJIKE NË HARTIMIN E HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPTARE

Nga Floresha Dado

Pse sfida të albanologjisë ?

Sepse ky projekt i madh shkencor jo vetëm pret, prej dekadash, të realizohet në nivelin e një monumenti të rëndësishëm të kulturës shqiptare, por edhe sepse, sipas mendimit tim, akoma nuk po kuptohet se sa i domosdoshëm është diskutimi për zgjidhjen e disa parimeve konceptuale, që do të jenë garantim i suksesit të këtij realizimi. Hartimi i historisë së letërsisë shqiptare nuk është një dëshirë, por përgjegjshmëri shkencore, që duhet të ndjehet që në hapat e konceptimit të saj. Në problematikën shkencore, specifike për një histori letërsie, studiuesit do ndeshen patjetër me disa sfida, të cilat duhen diskutuar në tavolinë specialistësh. Disa prej këtyre sfidave :

Sfida e parë : Do ishte e habitshme për ndonjë, nëse them se nuk njihet tërësisht problematika e konceptimit të historiografisë letrare; kjo ndodh sepse jo gjithnjë është në vemendje kompleksiteti i natyrës së letërsisë. Një tërësi çeshtjesh dëshmojnë sot sa periferikë kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi rreth këtij projekti themelor të kulturës shqiptare. Dilemat që nxit hartimi i "Historisë së Letërsisë Shqiptare" zgjidhen përmes një varg çeshtjesh të karakterit metodologjik, si çeshtjet e kritereve të hartimit, të periodizimit, të metodave të studimit, të kuptimit të raportit të historiografisë letrare me historinë, të marrëdhënies së historianit të sotëm me krijimet në kohë, të raportit midis kuptimit historik dhe evolucionit të strukturave formale të letërsisë etj.

Sfida tjetër : studimi i letërsisë sonë, në shtrirjen e gjatë kohore, në variushmërinë e drejtimeve dhe individualiteteve letrare, nxjerr në plan të parë mbështetjen në një sistem nocionesh teorike mbi thelbin dhe specifikën e objektit të saj (letërsisë), mbi konceptet që kanë të bëjnë me procese të zhvillimit historik, si për shembull : koncepti mbi rrymat dhe drejtimet letrare, mbi poetikat që karakterizojnë çdo drejtim, mbi kriteret e dallimit të gjinive letrare, mbi konceptin e saktë të metodës krijuese, që ka të bëjë me shkrimtarët, por dhe të metodës interpretuese, që ka të bëjë me studiuesin. Ndërsa historia e letërsisë kërkon gjenezën e gjinive dhe formave letrare, evolucionin dhe variacionet e tyre, në kohë dhe në hapësirë, teoria orienton mbi thelbin e strukturës dhe sistemit letrar, qëndrushmërinë dhe ndryshueshmëritë e tyre, modelet dhe normat krijuese, etj.

Sfida tjetër : Historia e letërsisë sonë duhet të përcaktojë qartë kufijtë e objektit, ku në plan të parë është raporti me historinë. Historiografia letrare dhe historiciteti i saj, janë dy koncepte që, sa lidhen ngushtësisht me njeri tjetrin, aq thelbësisht të dallueshme i kanë specifikat e brendshme të tyre. Disa tekste të Historisë së Letërsisë Shqiptare, duke qenë të nënshtruar ndaj konceptit të kronologjisë kohore, nuk kanë realizuar kuptimin e vërtetë të historicitetit të kësaj disipline. Në këtë mënyrë, ndonëse pretendojnë të ishin histori letrare, në të vërtetë mbetën kryesisht kalime në kohë. Evolucioni i raportit estetiko-historik, i shtrirë në kohë, nuk u konceptua si një kriter i rëndësishëm për të ndërtuar drejtë marrëdhëniet midis Historisë së Letërsisë dhe Historisë. Kjo është shumë e rëndësishme për të korregjuar trajtimet e deritanishme të këtij raporti në tekstet e historive të letërsisë.

Sfida tjetër : Saktësimi i natyrës dhe i funksionit të Historisë së Letërsisë korrigjon kuptimin e raportit midis historiografisë letrare dhe metaligjërimve të tjera. Historiografia letrare është një realizim ndërdisiplinor e ndërligjërimor, një nga fushat më bashkëpunuese, më krahasimtare dhe interpretuese. Nëse ajo ka lidhje me disiplina të tjera, si teoria, kritika, poetika, stilistika, tekstologjia, letërsia krahasimtare (si metodë studimi) etj.; me disiplina të karakterit humanist, si filozofia, filologjia, historia e arteve, historia kombëtare, historia e religjioneve, antropologjia, sociologjia, studimet kulturore; si dhe me disiplina të një sfondi më të gjerë të shkencave ekzakte, si statistika, semiotika e përgjithshme, paleografia etj., duhet të kemi parasysh se në këtë specifikë të saj fshihet edhe rreziku i prishjes së kufijve të një histori letërsie.

Sfida tjetër: Historicizmi dhe Historia e letërsisë Ku qëndron dallimi midis historicizmit klasik dhe historicizmit të ri ? Historicizmi i ri zgjeroi, në studimet letrare, kuptimin e raportit midis letërsisë dhe historisë. Në pikëvështrimin e tyre historia nuk shihet thjesht në linjën e vazhdimësisë dhe zhvillimit, por kryesisht nën pushtetin e një force sinkronike, si një forcë produktive, gjenerative. Ky aspekt nuk ka tërhequr vemendjen e studiuesve, ndonëse në kapërximin midis këtyre dy koncepteve të afërta ekziston një kuptim më i thellë i raportit letërsi-histori. Zhvillimi historiko-letrar, duhet parë jo thjesht si dokument, pasqyrim, por si pjesë e brendshme e zhvillimit.

Sfida tjetër Në hartimin e historisë së letërsisë del në plan të parë kuptimi i drejtë i raportit midis realitetit historiko-letrar dhe rrëfimit historiko-letrar, ku asnjeri nuk është i pavarur nga tjetri. Kjo kërkon interpretimin e marëdhënies midis ligjërimit specifik letrar dhe metaligjërimit, që i përket një realiteti në distancë kohore. Dallimi midis këtyre dy kodeve ligjërimore, artistik dhe shkencor, lidhet me qëllimet dhe rrugët e ndryshme që ndjekin për njohjen e së vërtetës njerëzore. Historia e letërsisë synon përshkrimin, sipas standarteve teorike e metodologjike, ajo u referohet gjithë faktorëve të krijimit dhe komunikimit letrar, si shkrimtarit, veprës, lexuesit, kodit, sistemit të konvencioneve kulturore, etj. Kjo bën që ky lloj ligjërimi të shfaqet si kombinim i tipareve teorike, empirike-historike, kritike-interpretuese, pra si një model kompleks ligjërimor mbi letërsinë. Kjo bën, gjithashtu, që ligjërimi i historisë së letërsisë të jetë më standart, më i qëndrueshëm në stereotipet strukturore.

Sfida tjetër : Zgjerimi i teorive moderne, mbi kuptimin e letërsisë, shtron domosdoshmërinë e zgjerimit të metodave të hartimit të historisë së letërsisë. Praktika e deritanishme e historiografisë sonë letrare ka treguar se problemi i metodologjisë dhe i përcaktimit të metodës së studimit është themelori për suksesin të këtij projekti. Në mendimin metodologjik mbi përzgjedhjen e metodave shkencore do mund të diskutohej: a është e mundëshme që në studimin e letërsisë të vendoset një dominante, një metodë kyç e kërkimit; apo a mund të jetë e nevojshme të përdoren metoda plotësuese (policentrizëm metodologjik); dhe së fundi, a duhet kërkuar një metodë tërësore dhe integruese, që mund të karakterizojë studimin e letërsisë (centrizëm metodologjik).? Ky diskutim metodologjik është i rëndësishëm. Kur është fjala për studimin historiko-letrar sistemi i metodave, që mund të përdoren, i përshtatet si studimit të vazhdimësisë, vertikalisht (në diakroni), ashtu dhe studimit horizontal (në sinkroni). Nëse Historia e Letërsisë Shqiptare do të mbështetej kryesisht në konceptin metodologjik të hetimit të evolucioneve stilistikore, kjo do të kërkonte ndjekjen e letërsisë në dy pikësynime kryesore : përcaktimin e fazës së formimit dhe kristalizimit të dominantes letrare, formave poetike; gjithashtu edhe përcaktimin e fazës së ripërtëritjes, ndryshimit, aktualizimit, kur parime estetike zëvendësohen nga parime të reja. Kjo do të thotë se evolucionin e letërsisë sonë duhet ta interpretojmë vetëm si ndryshim të sistemit letrar dhe parimeve të ndërtimit të tij. Natyra e historisë së letërsisë do të kërkonte të përcaktohej se sa sistemi letrar shqiptar e ka transformuar veten gjatë kohëve.

Sfida tjetër : Ç'kuptojmë me periodizim të letërsisë dhe cila është vlera e këtij aspekti në hartimin e historisë së letërsisë? Nocioni i periodizimit është, në një farë mënyre, gjthëpërfshirës, se i përket sa të veçantës së një periudhe të karakterizuar, aq edhe gjithë letërsisë. Kjo do të thotë se, duke përcaktuar periudhat letrare të shqipes, ne nuk i veçojmë ato, por njëkohësisht i kemi përfshirë në një sistem letrar, që i përket gjithë letërsisë shqiptare.

Sfida tjetër: Ç'probleme ka sjellë strukturimi i historisë së letërsisë sonë në analogji të plotë me historinë e Shqipërisë, siç ka ndodhur në disa tekste, që nga fillimi i shekullit XX, ? Kemi një abstraksion mbi tiparet dominuese të zhvillimit në rrjedhë kronologjike të ngjarjeve letrare, që e bën këtë analogji jo një lidhje të rëndësishme ? Asnjë nga këto periodizime nuk mund të realizojë plotësisht sistemimin e letërsisë sonë, në të gjitha dukuritë e brendshme dhe të jashtme të zhvillimit të saj.

Përderisa fenomenet letrare shfaqen e zhduken në periudha të caktuara, përderisa letërsia, në tipologjinë gjinore të saj, shfaqet në nivele të ndryshme të lulëzimit, përderisa poetikat e saj ndryshojnë në aspektin artistik dhe në kushtëzimin hapsinor e kohor, përderisa autorët i përkasin mjediseve dhe ndikimeve kulturore të caktuara, etj. kjo do të thotë se problematika është e gjerë, madje, ajo vështirësohet më shumë për të përcaktuar se cili nga kriteret e shumta të periodizimit letrar, i shkon më përshtat sistemimit historiko-letrar të letërsisë shqiptare ?

Pikëpyetjet e periodizimit shfaqet edhe në një aspekt tjetër, atëhere kur një autor i përket historikisht një periudhe kohore, ndërsa estetikisht një periudhe tjetër, (Asdreni, Çajupi,etj.) Prandaj problemi mbetet gjithnjë i hapur për diskutime midis specialistëve. Ose pyetja tjetër: në ç'masë historia e letërsisë shqiptare respekton përqasje me periodizimin e historisë politike ? A mund të ketë një përputhje absolute midis këtyre dy proceseve, që janë njëlloj historikë ? A është e vërtetë se gjatë zëvendësimit të periudhave historike-politike ndodh edhe ndryshimi i menjëhershëm i stileve dhe parimeve estetike të letërsisë ?.

Sfida tjetër: A është pavarësia e historiografisë letrare e kufizuar, në vartësi të pavarësisë së kufizuar që ka vetë letërsia,?. Ky problem shfaqet sepse konceptet mbi thelbin e letërsisë nisin nga ato që mbështesin pavarësinë ekstreme të saj deri te pikëpamjet që e lidhin thelbin dhe zhvillimin e letërsisë me faktorët socialë (autor, histori, rrethana social-kulturore etj.) Këto qëndrime të skajshme kanë provokuar vazhdimisht mbizotërimin e njerit apo tjetrit pozicion metodologjik. Kjo lidhet drejtpërdrejtë me pyetjen se ta do ta ngushtojë në maksimum historia e letërsisë shqiptare lidhjen me historinë, ? A do kemi vetëm histori të fenomeneve letrare, jashtë zhvillimeve historike : kulturore, fetare, publicistike etj., apo, ky raport do të jetë i kushtëzuar nga veçoritë e letërsive të shekujve të ndryshëm, ku, siç thamë, shekujt letrarë, për vetë thelbin e zhvillimit të tyre, diktojnë një trajtim më specifik ? Dallimi me trajtimet që i janë bërë letërsive të shekujve XVIII, XIX, XX është se në këto të fundit raporti i letërsisë me historinë është diktuar nga koncepti që e kufizonte interpretimin e letërsisë vetëm në kushtet historike të lulëzimit të saj. A është i justifikueshëm koncepti i parë, apo historia e letërsisë duhet të shmangë ato periudha kur kufijtë e letërsisë janë përzierë me krijime të tjera ?

Sfida tjetër: Kriteret e konceptimit të Historisë së Letërsisë Shqiptare në strukturën e brendshme, mund të jenë të ndryshme. Nëse u referohemi dy kohëve : asaj të shkurtër, që ka të bëjë me historinë e rrethanave social-kulturore dhe kohës së gjatë, që ka të bëjë me historinë e jetës së veprave, gjinive, etj., është e pamundur të mos gjendemi përpara vështirësisë së përcaktimit të kriterit të hartimit të historisë së letërsisë. Praktika e hartimit të historive letrare, në kultura të ndryshme, ka hapur mundësinë e zbatimit të kritereve të ndryshme të konceptimit. Kështu : Kriteri gjinor, që është aplikuar në disa histori të letërsisë franceze. (Claude-Edmonde Magny : Histoire du roman français depuis

1918, Édition du Seuil, 1950) ; Kriteri i hartimit të historisë së letërsië shqiptare sipas drejtimeve letrare, atij të romantizmit (Rexhep Qosja : Historia e Letërsisë Shqipe – Romantizmi, I,II,II, Rilindja, botimi i vitit 1990); Kriteri monografik, që niset nga pikësynimi për të realizuar një studim të plotë shterrues mbi jetën dhe krijimtarinë e autorëve më të shquar, që përbëjnë një hallkë të rëndësishme në procesin e zhvillimit historik të letërsisë shqiptare (Floresha Dado: Andon Zako Çajupi - Jeta dhe Vepra, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë, Tiranë, 1983); Kriteri i kombinit të tre ndarjeve të mëdha : të kontekstit historiko-kulturor, të traditës në jetën letrare, të rrokjes së veprave të mëdha, çka do të bënte që praktika letrare të futet në tërësinë e aktivitetit historik. ("L'Histoire de la literature française", koleksioni Pichois (Artaud,1968); Kriteri historik-kronologjik, sipas të cilit pasqyrimi i letërsisë kombinohet me ndarjet e mëdha të zhvillimit historik : periudha e vjetër, mesjeta, renesansa, periudha moderne, shekulli XIX, XX. (Shih: David Lodge: Historicism and Literary History : Mapping the modern Period, London : Routledge, 1981) ; Kriteri : kombinim kriteresh, që është shfaqur në teoritë e sotme. Kjo do të thotë përfshirje dhe interpretime tekstesh të vjetra, ndarja të letërsisë sipas shekujve, trajtim autorësh të veçantë, interpretim të dukurive artistike, etj. (Laërence Buell "Literary History as a Hybrid Genre", në Neë Historical Literary Study. Ed.Jeffrey N. Cox and Larry J. Reynolds, Princeton (NJ): Princeton UP, 1993) Një koncept i tillë e konsideron historinë e letërsisë si një 'gjini hibride';Kriteri i konceptimit të letërsisë së përgjithshme (i trajtuar nga Ëellek dhe Ëarren), që i jep hapësirë shumë të gjerë historiografisë letrare, dhe del nga kuadri i një letërsie të vetme; Kriteri krahasimtar, kur letërsia studiohet në plan përqasës me një, apo disa letërsi të tjera. (kjo sidomos kur kemi të bëjmë me letërsi që mbështeten mbi sisteme gjuhësore të njejta, për shembull letërsitë e gjuhëve sllave, apo latine, etj.); Kriteri hapësinor, që mund të rrokë studimin e letërsive të një rajoni, për shembull letërsia shqipe në letërsinë ballkanike.

Këto, dhe të tjerë kritere, dëshmojnë se studimi historik i letërsisë realizohet në plane e pikëvështrime nga më të ndryshmet. Por, gjithsesi boshti i kësaj sfide është; a do të ketë historia e letërsisë sonë një strukturë të brendshme, që nuk ka të bëjë thjesht me ndarjet e jashtme, formale, në pjesë, kapituj, etj., por me logjikën e realizimit të studimit të gjithë aspekteve, të brendshëm dhe të jashtëm, të letërsisë, e shtrirë kjo në disa shekuj?

Sfida tjetër: Evolucioni letrar dhe estetika e perceptimit, një aspekt tepër i diskutueshëm . A duhet të merremi me autorë minorë, si N.Nikaj, K.Floqi, etj. që shënuan lëvrimin e parë të strukturave të reja (si romanin, dramën, etj.) në momente të caktuara të historisë letrare, apo duhet të qëndrojmë te autorët më të spikatur, që i zhvilluan këto struktura në nivele më të larta artistike ? Sipas nesh, kjo pyetje na ve në vështirësi lidhur me përcaktimin e objektit të historianit të sotëm. A do ta shohim dukurinë e risisë aty ku lind, apo aty ku shfaqet në formën më të përsosur ?.

Duke i qëndruar përsëri tezës së evolucionit të formave letrare, mund të shtrohej problemi se a do të mundëte një historian i letërsisë të përcaktonte raportet midis një forme të re letrare dhe formave më të vjetra ? Dhe më tej, sa do ta ndihmonte ky veprim përvijimin e saktë të zhvillimit të letërsisë sonë në aspektin e evoluimit të vlerave artistike ? A mundet të kalohet nëpër këtë rrugë : nëpërmjet një forme letrare të mund të arrijmë tek një formë pothuajse e harruar ? Kështu do të shtrohej problemi në përcaktimin e evolucionit

të formave të poezisë së Mjedës, pak të përcaktuara në tekstet e deritanishme, për të shkuar te format paraprijse të tyre, apo përcaktimi i rrugës ku të çojnë trajtat poetike të Migjenit, etj. Për Eliotin problemi themelor nuk është përcaktimi i vlerave më të arrira letrare, por fakti që letërsia është vazhdimisht në lëvizje, në ndryshim. Domethënë, jo çdo formë letrare, që vjen më pas, kapërxen format paraardhëse. Kjo do të krijonte një pikëvështrim të ri në historinë e letërsisë : jo përcaktim të hierarkisë së vlerave, por hetim të dukurisë së ndryshimit të vazhdueshëm të formave letrare. Sipas nesh, ky pikëvështrim do të ishte i vlefshëm në rastin e hartimit të historisë së letërsisë shqiptare, shumë periudha letrare të së cilës nuk shquhen për kapërcime të theksuara artistike dhe ku ka rëndësi të përcaktohen dukuritë e ndryshimeve që kanë pësuar format letrare.

Sfida tjetër: Mënyra e kombinimit të qasjes në dy plane: diakronik e sinkronik

Të bësh një histori letërsie, do të thotë të konceptosh raportet diakronike dhe sinkronike midis letërsisë dhe metodologjisë së studimit të saj. Thelbi i kësaj marrëdhënieje përfshin rrokjen e dyanshme, ku shkojnë krahas : nga njera anë gjykimi i proceseve letrare, si zhvillime historike, nga ana tjetër përcaktimi i vlerave estetike, që shpërfaqen në një periudhë të veçantë historike.

Studimi diakronik, që në të vërtetë është qasja më e parë në studimin e historisë së zhvillimit së letërsisë sonë, ka në themel të tij interpretimin e një vepre apo fenomeni letrar si një kategori, e parë jo thjesht në seri kronologjike të dukurive letrare, apo si një prezantim historik të letërsisë. Me këtë kemi parasysh përcaktimin e atyre faktorëve që i bëjnë poezitë e De Radës, Mjedës, Lasgushit etj. me të vërtetë të reja dhe sa u njohën dukuritë e tyre letrare në momentin e shfaqjes, në ç'përmasa u realizua kuptimi i tyre i plotë dhe a ishte momenti kulturor i tillë që këto dukuri të reja të ndryshonin parimet krijuese të traditave letrare paraardhëse ? Analiza në plan diakronik na krijon mundësinë për të kuptuar dhe interpretuar fenomenin letrar të Koliqit, Kutelit, etj. si dukuri që u bënë kategori estetike, për të përcaktuar se a ndryshoi potenciali i tyre artistik rrjedhën historike të letërsisë shqiptare të ½ së parë të shekullit XX ? Pra, dimensioni i vështrimit diakronik të letërsisë sonë të traditës ka një përmasë më të gjerë se sa thjesht ndërtimi i një serie kronologjike veprash, të cilat kanë vlerën e paraqitjes historike të letërsisë sonë.

Por vështrimi diakronik duket sikur përmban brenda vetes edhe një sfidë. Në vështrimin diakronik, historiani i letërsisë arrin të dallojë se këto veçori tipologjike nuk shfaqen, në të gjitha periudhat, në trajta të njëllojta. Poezia e shekullit XIX nuk është e njëllojtë me poezinë e shekullit XX; kështu mund të thuhej edhe për prozën e për dramën. Kjo do të thotë se në qasjen ndaj letërsisë sonë, në rrafsh diakronik, krijohet një raport i veçantë midis tipareve tipologjike, të formësuara që nga fillimet e lulëzimit të një gjinie, apo lloji letrar, dhe dukurisë së evolucionit, ndryshimit që pësojnë këto kategori, nga një periudhë në tjetrën, nga një autor te tjetri. Studimi diakronik depërton në zhvillimet graduale të letërsisë, që kulmojnë në një ndryshim të dukshëm në stilin letrar të një autori, e sidomos të një periudhe. Kështu do ta interpretonte historiani i sotëm poezinë e Migjenit, që arriti pikën kulmore, si rezultat i zhvillimeve graduale që ndodhnin në letërsinë tonë gjatë viteve '30-'40

Kontributi themelor i historianit të sotëm të letërsisë sonë do të ishte vetëdija për të hetuar dhe për të provuar se si analiza diakronike ndihmon për të nxjerrë në pah një kategori të re estetike historike, atëhere kur thellohet jo vetëm te përcaktimi i faktorëve të vërtetë historikë, që shkaktojnë diçka të re në një fenomen letrar, në ç'masë ajo modifikoi perspektivën e zhvillimit të letërsisë shqiptare. Kjo është thelbësore dhe thelbi i qasjes në plan diakronik.

Sfida tjetër : A ka rrafsh sinkronik në historinë e letërsisë ?

Diakronia mund të ndalojë, të ngrijë në një moment të caktuar të zhvillimit të letërsisë, për të hapur rrugën e zbulimit të raporteve të shkrimtarit, veprave letrare me bashkëkohësinë e tyre. Në prerjen sinkronike historiani i letërsisë do të mund të thellohej në një fazë të zhvillimit letrar, do të mund të depërtonte më mirë në strukturën letrare të një momenti të caktuar, për të pasqyruar evolucionin e vërtetë nga një periudhë në tjetrën. Në aspektin metodologjik, kjo do të thotë se, kur flitet për karakterin historik të letërsisë shqiptare, të cilësdo periudhe, trajtimi diakronik shkon krahas me ndalesën, ndërprerjen sinkronike, dhe vetëm në këtë mënyrë mund të përcaktohet dimensioni i vërtetë historik i saj.

Sfidë themelore : Realiteti i historisë dhe realiteti i të kuptuarit letrar të historisë.

A mund të pranohet se letërsia e kaluar, e shtrirë në periudha të ndryshme, vjen në historinë e letërsisë së hartuar sot në një kuptim "të ri" historik? A ndikon ky kalim kohor që vlerësimet të ndryshojnë, që ajo që është konsideruar në një kohë të caktuar vlerë estetike, të mos jetë më e tillë në ditët e sotme ?

Raporti i sistemit letrar me historinë e periudhës së krijimit, por dhe me historinë e periudhës së sotme të interpretimit, duhet parë në një spektër më të vemendshëm : nga njera anë nuk do të duhej të skematizohej ideja se çdo zhvillim letrar është thjesht "produkt i historisë", por "produkt historik", çka shpreh një dallim të rëndësishëm në mënyrën e konceptimit dhe të interpretimit të procesit tonë letrar. Estetika e krijimit të veprave të periudhave të ndryshme dhe estetika e kohës së sotme të interpretimit krijojnë marrëdhënie tepër të vështira, çka e ve historianin në pozicion jo të lehtë. Shtrohet pyetja : si do të kapërxehen këto mospërputhje estetike, për shembull me autorë të tillë si N.Nikaj, M.Grebllesha, H.Stërmillit etj?. A ekzistonr rreziku i vlerësimit sipas shijeve të sotme ? Një problem i tillë çon në pikëpamjen se çdo vepër e së kaluarës, për shembull nga romantizmi, sentimentalizmi, etj., nuk mund t'i krijojë çdo studiuesi të sotëm të njejtat përjetime estetike. A do duhej të pranonim se në hartimin e historisë së letërsisë sonë fenomeni letrar ka lidhje jo vetëm me momentin e krijimit dhe botimit të tij, por edhe me kontekstin e momentit të hartuesve të kësaj historie ?.

Eshtë fare e qartë se ky fakt komplikon qëndrimin e historianit të sotëm ndaj trashëgimisë letrare, të krijuar në faza të ndryshme të pjekurisë letrare.

***

Duke i kaluar shumë shkurt disa prej problematikave të hartimit të historisë së letërsisë sonë theksoj se kjo ndërmarrje ka nevojë për 1. konceptimin e një strukture të qartë, që reflekton, në radhë të parë, zgjidhjen e një tërësi problemesh teoriko-shkencore. Studiuesve të shekullit XXI, u duhet të interpretojnë zhvillimin historik të një letërsie 5 shekullore, hapësira dokumentare e së cilës dhe spektri i dukurive është shumë i gjerë.

"Historia e Letërsisë Shqiptare" do të duhet të zgjidhë gjithashtu, përfundimisht, me kritere shkencore, problemin e gjeografisë së përfshirjes së letërsisë shqiptare, jo vetëm të shkrimtarëve të Kosovës, të arbëreshëve të Italisë, por të gjithë diasporës shqiptare. Ekuilibri midis aspektit etnik dhe atij estetik, në këtë rast, është tepër delikat dhe kërkon një kriter të përcaktuar mirë dhe përfundimtar.

2. "Historia e Letërsisë Shqiptare", e shkruar sot, duhet të kuptohet edhe si një eksperiencë e re interpretuese. Krahas njohjes së poetikës dhe metodologjisë së interpretimit, ndërtimi i një bibliografie shterruese, kërkimi i gjithë dorëshkrimeve të mundshme, në arkiva, biblioteka e institucione që kanë qenë lidhur me jetën e autorëve, njohja e konteksteve historiko-kulturore të periudhave, ndjekja e shtypit të kohës dhe e organeve shkencore e kulturore, njohja e mjedisit të formimit kulturor, të raporteve me letërsitë e huaja, apo me autorë vendas, etj. etj. janë fushë tepër e gjerë, që parapërgatit hartimin e kësaj vepre madhore të kulturës shqiptare. Duke qenë vepër kolektive (nuk përjashtohen kurrsesi edhe iniciativat individuale) ajo është punë e specialistëve të letërsisë, të cilët duhet të unifikojnë kriteret e konceptimit dhe nocionet e trajtimit historiko-poetik të letërsisë sonë. Veç pasionit dhe intuitës interpretuese, është e rëndësishme të kuptohet se studimi historik i një letërsie dallon rrënjësisht nga interpretimi eseistik, apo nga natyra e një shkrimi kritik, ku aspekti subjektiv është i theksuar. Kështu, përballë qasjeve të tilla thelbësore në hartimin e Historisë së Letërsisë Shqiptare kuptohet sa i domosdoshëm është orientimi mbi bazën e disa kriterve konceptuale, të pranuar shkencërisht.

(Gjuha e lojës - gjuha më e preferuar e fëmijëve. Si të adresojmë disa çështje te fëmijëve qe flasin dy ose më shumë gjuhë dhe përpjekjet e vazhdueshme për të percjellë shqipen brez pas brezi)

FËMIJET E SOTËM SHQIPTARË DHE GJUHËT SHUMËNGJYRËSHE

Nga Elona Kola

Në një ditë te zakonshme në aeroportin e Tiranës është e natyrshme të të tërheqin vëmendjen copëza bisedash të vogla aty-këtu midis udhëtareve, fëmijëve dhe prindërve të tyre, gjysëm në shqip e gjysëm në gjuhë të huaj. Vecanërisht në kohën e pushimeve e stinës të verës në plazhet tona është mëse normale të ndeshësh femijë të vegjël qe komunikojnë lezetshëm me njerëzit përreth tyre në italisht, greqisht, anglisht, gjermanisht etj, dhe të tjerët qe buzëqeshin teksa i veshtrojnë. Në kushtet e sotme ku numri i shqiptarëve që jetojnë jashte kufijeve është pothuaj i njëjtë me atë brenda tyre dhe dimensioni i lëvizjes është ingranuar thellë, tashmë asnjë nuk cuditet kur përballet me bashkëbisedime në gjithëfare formash e mënyrash ku shqipja ndërvepron me gjuhët e tjera në nivele nga më të ndryshmet deri në situata krejt komike. Aktualisht, pothuaj te gjithë shqiptaret kanë te paktën një lidhje familjare, shoqërore apo biznesi me botën e jashtme, dhe mendoj se të gjithë e kemi përjetuar këtë larmishmëri gjuhësh ku shpesh ka një dozë përzierje të shqipes me të tjerat.

Çështja e dy apo shumë-gjuhësise nuk mund të diskutohet më nëse është "mirë" apo jo, pasi ky fenomen është prezent dhe i rëndësishëm për shqiptarët, e sigurisht që është edhe një çështje opinioni, por si i mesojmë femijët me gjuhët e dyta dhe si ia përcjellim atyre trashëgimine e shqipes është jetike për kombin tonë.

Familjet që kthehen ne Shqiperi me fëmijet e tyre perjetojnë një lloj vështiresie kalimtare përsa i përket gjuhës, por kjo kapercehet lehtësisht (shprehen ekspertët, por dhe praktika e ka treguar) pasi fëmijët flasin me gjuhën e lojës dhe të shokëve, pra cdo ekspozim që ndodh, cdo leksion apo edhe detyrë nëse jepet para se gjithash ne formë argëtuese dhe me tone zbavitëse përvetesohet më pas ne formë informuese dhe edukuese. Sigurisht, së bashku me përfshirjen ne shkollë dhe disiplinat mësimore, mundësohet edhe nje integrim i shpejtë.

Mësimi i gjuhëve të huaja ka qënë dhe është njëfaktor shumë i rëndësishëm per ekzistencën dhe prosperitetin e shqiptarëve, por kjo gjë në të kaluarën ishte njëlloj detyrimi/privilegji më shumë i të rriturve, ndërsa tani vërejme me kënaqesi qe fëmijet po i mësojnë ato gjithmonë e më tepër nga ana praktike e i flasin me rrjedhshmëri e lehtësi që është për t'u patur zili. Të nxitur për shkak te mass-medias dhe internetit, ekspozimi ndaj gjuhëve te huaja është mjaft i gjerë, e para besoj anglishtja, por edhe gjuhët e tjera nuk mbeten shumë pas. Për fat te keq, nuk i kushtohet ky kujdes dhe vëmendje gjuhës shqipe e cila është deformuar dhe varfëruar disi, dhe në aspekte jo te vogla e për arsye te shumta, por edhe kjo nuk duhet parë me sy krejt pesimist.

Nga ana tjetër, niveli i shqipes se fëmijëve që janë lindur, rritur dhe jetojnë jashtë Shqipërise është në proporcion të drejtë me nivelin e përdorimit te gjuhës shqipe nga prindërit. Parësore mbetet pa dyshim, gjuha e përditshme, ajo më te cilën ata përballen në më të shumtën e kohës dhe kryejnë aktivitetet kryesore e nuk duhet të kalohet në ekstreme. Duhet pohuar që në vendet e huaja ku mungon arsimimi formal në shqip është tejet e vështire të mësohet e ushtrohet gjuha e shkruar dhe e lexuar me forma gramatikore të rregullta, por jo e pamundur. Thelbësore është qe ata ta degjojnë e ta degjojnë pa pushim, pasi eshte nje fakt universal i ditur qe femijët do flasin atë gjuhë qe dëgjojnë më shumë. Pushimet e verës shërbejnë shumë mirë për këtë qëllim dhe është ngazëllyese kur sheh femijët e vegjël që pa u sforcuar flasin me gjyshërit e tyre në shqip pasi nuk kanë rrugë tjetër dhe e kthejnë gjuhën sipas interesit të tyre.

Në ushtrimin dhe përdorimin e një gjuhe të dytë, mbi te gjitha, ka të bëjë qëndrimi i relaksuar por edhe i vazhdueshëm i prindërve. Përvec rasteve kur janë lëndë mësimore, nëse do t'i prezantojmë femijët me një gjuhë të dytë, 5-10 fjalë të reja dhe 15 minuta ushtrime cdo dy ditë bëjnë diferencen, pa i detyruar ata të thellohen në gramatikë dhe të memorizojnë pafundësisht tekste të vështira. Nëse bëhet me detyrim apo nuk është argëtuese, fëmija e sheh si një detyrë klase apo shtëpie dhe shpejt e humbet interesin. Është fat kur prindërit e flasin të dy një gjuhë te dyte, por edhe në të kundërt, cdo njohuri ne një gjuhë tjetër duhet te konsiderohet si dhuratë. Pse te mos flitet gjuha e nënës kur ajo flet shqip?

Përmirësimi dhe vazhdimësia e mësimit te gjuhës shqipe në emigracion, nuk duhet parë si një lloj anakronizmi apo një gjëje të "vjeter" me ngjyrime inferiore, por përkundrazi, të shihet si epërsi e tipareve kulturore dhe si një fije e fortë që na bashkon te gjithëve kudo nëpër botë. Komunitetet e kombësive të tjera mundohen me fanatizëm të ruajnë nëpër breza gjuhën e tyre e pse të mos e bejme edhe ne? Shqipja ka patur nje rrugë fort te mundimshme, por vazhdon të jetë gjuha jonë e gjallë, e jemi entuziastë që numri i shqipfolësve është më i madh se kurrë ndonjëherë. Le t'i mësojmë brezave që vijnë gjuhën e Naimit e të Fishtës e të mos e lemë mbas dore këtë gjuhë, "trashigim, që na i la i Pari".

BOTA E "BAR SAHARA"

Nga Andi Nika

Avull, mjegull, tym, rrota e tela. Një botë e ftohtë gri. Një botë mekanike që e ka humbur shpirtin e saj dhe e kërkon atë si e marrë. Një botë ku copëzat e mbetura të një lidhjeje të shëndetshme të njeriut me natyrën paraqiten tanimë si horrore paradoksale. Një kokë gomari që pëllet, si ofshama e fundit e një natyre që përdhunohet, gjehet në kroskotin e një makine pune, si shëmbëlltyra e jetës teknike. Shpirti i kësaj natyre nuk mund të integrohet në mënyrë të shëndetshme në këtë lloj jete, larg saj, në zhurmat e rrotave të qytetit. Por njeriu ngulmon ta bëjë, duke e zbutur atë nën shërbimin e tij. Por, fatkeqësisht, kjo natyrë e zbutur s'është gjë tjetër veçse një kokë gomari që pëllet.

E tillë është bota e Bar Saharasë. Është një botë ku individi frymon i pashpresë brenda 'kutisë' së ndërgjegjes së vobektë, duke përmbushur kështu profecinë Platonike të njeriut shpirthekur i cili, i prangosur në zinxhirët e frikës dhe padijes në shpellën e tij të ngrohtë, adhuron etshëm hijet që e rrethojnë. Ai e ka humbur sensin e dritës, ngjyrës, vetë jetës. Jeta tanimë ka rrota dhe këtij të mjerit i duket sikur mund ta ngasë. A thua të jetë e justifikuar krekosja?

Por peisazhi që pikturojnë këto tregime është një peisazh jo për të gjithë; një peisazh i cili, pas 'nënqeshjes së tij të çuditshme', fsheh një detyrë të rëndë; një thirrje për guxim. Nuk ka asgjë të këndshme rreth ankthit ekzistencial që ofrojnë këto tregime. Por përballja me këtë ankth është e vetmja antidotë ndaj marrëzisë së modernizmit. Ankthi Kierkegardian, si kusht i nevojshëm i misionit arkaik të arritjes së të mirës dhe të vërtetës Sokratike, është i vetmi korrier i shpirtit si të tillë, dhe një botë që e ka humbur shpirtin e saj është një botë nevojtare ndaj këtij korrieri.

Këtu qëndron dhe origjinaliteti i këtyre tregimeve. Nga njëra anë kemi vrazhdësinë e modernitetit, me të gjithë teknologjinë e tij si panacea përfundimtare e njeriut, dhe nga ana tjetër absurditetin me të cilin karakteret përballen. Kjo martesë midis vrazhdësisë moderniste dhe absurdit karakterizues sjell dhe ndjesinë e pashmangshme të Ankthit. Absurdi ndodh pikërisht kur, nën atmosferën e një rendi vlerash që po bie, ndërgjegja e patabantë ngre pyetjen e pashmangshme mbi vërtetësinë e tyre dhe, si rrjedhojë, mbi kuptimin e vetë jetës. Dhe Mëkati Fillestar i jep këtij absurdi një përgjigje aporike: nën petkun e teknologjisë, pjellës më të arrirë të kohës sonë dhe shenjuesit më të përsosur të një ndërgjegjeje racionale e post-dogmatike, Aleksandri kryen aktin tipik irracional, ritualin Biblik të vrasjes së parë në 'botën e re'. Dhe Abeli i tregimit si personifikimi arketipal i ndërgjegjes moderne, ngre pyetje që e përforcojnë absurdin. Në çastet e fundit të jetës së tij ai rrethohet nga supozime, në dukje të palogjikshme, por që përbëjnë dhe simptomën karakterizuese të kësaj kohe. Çështja nuk është më përjetësia e shpirtit, por zgjatja e agonisë së jetës, pra, mbijetesë veç për hir të mbijetesës. Kjo ndërgjegje është aq e frikësuar dhe burracake, saqë edhe nën agoninë e dhimbshme të pranëvdekjes, përsëri përgjërohet për jetën e mishtë. Edhe pse e mbyllur në kutinë e dëshpërimit izolues, përsëri kërkon të qëndrojë brenda saj, me justifikimin se bota jashtë s'ka ndonjë vlerë të madhe, duke u identifikuar kështu me antinominë e *élan vital*-it, tkurrjen e pashmangshme të forcës jetësore.

Nga ana tjetër Abeli ynë na shpall pikërisht rënien e një rendi vlerash: kush e dënon 'Vrasjen e Parë' të dytë? Kush e dëbon Aleksandrin nga Edeni? Askush. Askushi si i tillë: dogma që i zë vendin çdo sistemi teologjik, idhulli i një metafizike të plotë nihiliste. Sepse zotat vdiqën. Dhe ky mëkat arketipal i dyfishtë, ai i vrasjes së zotave dhe të një kushtetimi të tërë ndërgjegjësor, bartet kudo ku njeriu shkel. Të gjithë brezat pasardhës të planeta64040 do kenë në ballë damkën e Kainit që karakterizon etërit e tyre. Ky njeri që përpiqet ta çrrënjosë veten nga tradita tërhiqet zvarrë nën prangat saj. Ndërgjegja e tij fëminore do qëndrojë e prangosur derisa ajo të veshë dhe njëherë mantelin e lashtë të virtyteve më të larta të njeriut dhe të përballet me vetveten. Vetëm kjo përballje mund t'i japë zgjidhje Ankthit. Dhe në këtë kontekst, këta tregime na ftojnë drejt një rruge heroike, e cila, si kusht fillestar, ka pikërisht këtë përballje.

Nëpër terr e nëpër natë!

Tregim nga Bajram Sefaj

Tamam kur sapo mbylli sytë e lodhur e ra në gjumë të thellë të natës së dimrit të parë, një ëndërr e keqe, fort e hidhur dhe plot ankth, e trazoi pa masë. Nga pellgu i së cilës s'kishte si të dilte pa u bë ashtu siç u bë. Ideja ishte aq e pamëshirshme, idhnake, katile e rebele në origjinalitetin dhe kryeneçësinë e saj idiote, sa nuk bënte fare, fare nuk bënte, lihej për nesër, ose të qitej pas mëndësh, të harrohej fare. Humbje e parikuperueshme do të ishte ajo, zot i lumë. Ëndrra, bash si një bletë e krahëlehtë Mbretëreshe, shtriu dorën dhe shtypi pullën e duhur të kompjuterit. E kyçi (e konektoi!). Dora e dridhur e plakut në natë, nuk i kënaq vetëm me kaq. Me regjistrimin, në faqen e bardhë të kompjuterit, emrin (titullin) e idesë, e të vazhdoi episodin e radhës së gjumit të trazuar pleqërisht. Jo, ai kishte ecur përpara. Kishte vazhduar të shkruaj në ajrin e dendur të ëndrrës së natës terr. Ai vetë, kompjuteri i kyçur në ëndërr, as zogjtë e Alpeve të vendlindjes, as gurtë e thatë të kanioneve e grykave të thepisura, të kaubojve të Perëndimit të Egër, të Amerikës së Egër, ama bash askush, as djajtë e pandemisë, as engjëjt e pabesë të lirisë së humbur, nuk dinin se ç'po ndodhë e ç'po zihej, atje poshtë, në shtratin e një plakushi, nën plafin e jorganit të tij, plotë dergj e duhmë të keqe gazrash. - Ani, rini qeshu, qeshu rini qeshu, bota është e jote!

Po atje poshtë, ndërkohë, kishte ndodhë hataja. Kishte lindur ideja për një rrëfim i paparë deri më sot. Një tregim ëndërr. Me tamam. Ashtu taze, siç ishte, simite ende padalë mirë nga furra e bukës, i pa zënë mirë, i pa ngjizur si duhet, kishte marrë turr e, sa ora, kishte pushtuar Planetin tokë, të gjitha kontinentet, i gatshëm të pushtojë edhe aq e, më shumë, kontinente që do të zbulohen, do të dalin në sipërfaqe nesër! U bë nami krejt. Agjencitë e njohura, të mëdha e të vogla, gazeta e revista, shtëpitë botuese, anë e manë botës, e kishin prishë gjumin e natës. Tregimi ëndrrës ishte përkthyer në të gjitha gjuhët e gjalla dhe të vdekura të botës. Në gjuhet jo ekzistuese (inekzistente). Në gjuhë të panjohura, të pa zbuluara. Gjuhë që do të lindin, që do të vijnë, nesër e pasnesër... E tillë ishte jehona e atij tregimi të pashkruar: e rrufeshme, plot shkrepëtima. Vdekjeprurëse për ata që shkruajnë e, talentin e kanë me grat!

*

Të nesërmen e asaj nate të stuhishme dimërore, saktësisht në ora 02.52 minuta, në lindje të agut të ditës së re, në shtratin e tij të gjumit, gdhiu i pa jetë. Tash kish ra në gjumë të përjetshëm, eternel. Gishtërinjtë e duarve të thata i kishin ngelur kacavjerrë, në pozicionin e rrahjes mbi tastaturë të kompjuterit tekstin e tregimit të pa shkruar. Ndër fulqi të ngrira, sikur bluante porosinë e fundit testament, që kjo sajesë e ëndërruar letrare, t'i të zbardhët pikërisht, në faqet e kësaj gazete! (Gaillard, 03.12.2021)

SADIK BEJKO DHE NJERIU UNIVERSAL NË POEZI

Nga Ibrahim Vasjari

Duhet theksuar, se qysh në fillimet e veta poetike, si rrallëkush në atë kohë, S.Bejko me mënyrën e vet nuk iu përgjigj komandës ushtarake "Eja në radhë!". Me një pjekuri të parakohshme ai u kujdes që qetë-qetë e gradualisht, por gjithnjë në rritje e deri në kristalizimin e plotë të identitetit të tij, të pasurojë thesarin poetik me prurje të reja cilësore, duke sjellë një zë krejt të veçantë në ansamblin e poetikës shqiptare. Nuk mund të themi se fusha e novatorizmit të tematikës dhe kryesisht formës, mjeteve shprehëse dhe larmisë së stileve ishte krejt e palëvruar, ajo kishte një traditë të hershme migjeniane. Në vazhdimësi të kësaj tradite dhe në kushte të reja, në vitet 60-70 pati disa përpjekje, disa sprova të rinjsh për t'iu shmangur kodeve të ngurta të realizmit socialist, por që u mbytën qysh në djep: disa prej tyre e kyçën gojën nën dajakun e Inkuizicionit revolucionar, ca u mobilizuan, veshën uniformën revolucionare të Partisë, ca të tjerë u lejuan përkohësisht deri në një "urdhër të dytë". Në udhën e traditës së novatorizmit kryesisht të formës dhe larmisë së mjeteve shprehëse artistike, ashtu siç shpërtheu fuqishëm poeti Fatos Arapi, po ato vite nisi rrugëtimin e sukseshëm letrar edhe Sadik Bejko. Po e bëj këtë qasje jo rastësisht, por sepse, falë disa tipareve krijuese, i shoh të dy si "vëllezër poetikë". Natyrisht, ashtu siç ndodh tek gjithë vëllezërit, ata kanë edhe të veçantat e tyre. Nisur nga këto veçanti, do të varej edhe rrugëtimi i tyre poetik, edhe fati i tyre jetësor: F. Arapi do të ishte "i paprekshëm", ndërsa S. Bejko "i brishtë".

S.Bejko, falë një prirjeje të brendshme të natyrës së tij, qysh në fillimet e para letrare, ndryshe nga të tjerët, **vuri në fokusin poetik njeriun universal.** Nëse F. Arapi u përqendrua në temat e mëdha, në shqetësimet epokale të historisë dhe revolucionit, duke përfshirë në to si pjesë integrale edhe kontributin shqiptar, dhe këtu padyshim pati realizime dinjitoze cilësore, S. Bejko, përkundrazi, nuk u ngjit lart në qiejt e temave epokale, por zbriti poshtë, hyri thellë vetvetes, thellë njeriut, thellë asaj bote të brendshme, atij shpirti të trazuar njerëzor ku gërshetohen dhe grinden përjetësisht dashuritë dhe urrejtjet, gëzimet dhe trishtimet, dilemat dhe paradokset e njeriut universal, njeriut mbikombëtar.

Pranë teje qan një grua në mbrëmje.
Ti vetmohesh, ndihesh fill e i vetëm në botë.
Bota e madhe me qytetet, me pyjet, shkretëtirat,
Ti vidhisur krejt tek kokrra-kokrra
Një grua thërrmohet në lotë.

Një grua, vetëm grua që qan.
Botën tërë e tëhollon, e shndrin në ca lotë
Qan heshtur, heshtur si më e heshtura: Nën gurë
po shtrydhen rrush te m'e bukura shportë?

"Qan një grua"

Edhe F. Arapi, meqë e përmenda më lart, duhet thënë se me kohë, falë talentit të tij të fuqishëm, gradualisht zbriti nga qiejt e historisë e të revolucionit, zbriti në botën e pasur e të thellë të njeriut. Dhe në këtë fushë ka lënë mjaft poezi (të botuara vonë), perla të vërteta.

Sadik Bejko zë një vend të veçantë, mbetet i rrallë në profilin hulumtues të njeriut universal, jo ngushtësisht shqiptar, por përtejshqiptar, njeriu i botës, ai që vjen nga rruga e gjatë dhe e lashtë e njerëzimit që nga piramidat e Egjiptit tek Haamurabit dhe këngët e Solomonit. Falë kësaj të veçante, ashtu siç ndodh kudo, poetët e këtij lloji janë qytetarë të botës, ata kanë privilegjin që, të përkthyer në gjuhët e huaja, të ndihen anglezë në anglisht, francezë në frengjisht dhe indianë në indisht. Sepse bejko kërkoi dhe kërkon tjetër dritë në poezinë bashkohore shqipe. Dritën e poezisë së ngjizur me lënde hyjnore. Ashtu si mugari i shpellës Aram që kërkonte dritën e së vërtetave të epërme, ashtu poeti ynë solli në letërsinë shqipe, poezi të një kalibri që jo çdokush mund të arrijë t'i kuptojë e t'i shijojë. Kredoja poetike e Bejkos tingëllon më bukur se askund tjetër në këto vargje të tij të poezisë "Letër Hamurabit".

Pse më tundon, zoti im, me sjellje të këso bote?
Njerëzit këtu janë me nga një bodrum të zi,
me nga një hambar terri mbi shpinë dhe nën tru.
Kur ata bien nga shpellat në bodrumin e vetes,
për ta s'ka më nënë, mik e të dashur,
janë më të ftohtë se një gur,
më të thatë se një dru.



Pyetësori "Librat e jetës sime"

BESNIK MUSTAFAJ

Libri që më ka ndryshuar jetën?

Do të kisha thënë "Pinoku".



Libri që po lexoj ndërkohë

Unë lexoj çdo ditë. Në mënyrën time të jetesës këtu në katund nuk kam asnjë argëtim tjetër veç leximit. Tani po lexoj "Figura shqiptare në Lindjen e Mesme gjatë shekujve XVI – XX" të Muhamed Mufakut.

Libri që më ka ndryshuar jetën

Do të kisha thënë "Pinoku". Është ndoshta libri i parë që kam lexuar, kur sapo kisha mësuar germat. Ky libër mbolli tek unë pasionin e leximit. Parë nga lartësitë e të sotmes, jam i sigurt që jeta ime ado të kishte qenë shumë më ndryshe, pa dyshim e varfër, pa këtë pasion.

Libri që do të doja të kisha lexuar

Nuk kam ndonjë libër që do të kisha dashur ta lexoja dhe nuk e kam lexuar. Në sajë edhe të gjuhëve të huaja, sot mund të gjej dhe të lexoj çdo libër.

Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

Ndoshta "Procesi" i Kafkës. E kam lexuar në frengjisht kur isha student në vitin e parë të fakultetit. Për një periudhë prej disa muajsh, në mënyrë të çuditshme, pas atij leximi, nuk e shihja më me sy letersinë klasike. M'u desh kështu një kohë që ta kuptoja çfarë lidhjeje të brendshme kishte midis prozës së Kafkës dhe letersisë së madhe klasike. Vetëm atëherë gjeta qetësi.

Libri që më ndryshoi mendjen

Nuk jam në gjedje të identifikoj një libër të caktuar, i cili të ma ketë ndryshuar mendjen. Nuk besoj të kem patur një rast të tillë.

Libri i fundit që më bëri të qaj

Asnjë libër nuk më bën të qaj. Nuk dua të besoj se ky fakt mund të shprehë mungesë ndjeshmërie nga ana ime ndaj përmbajtjes së librave që lexoj.

Libri i fundit që më bëri të qesh

Një botim i ri me thëniet më të paharrueshme nga Çërçill. Ka ndodhur para pak javësh. E kam lexuar në një gjuhë të huaj.

Libri që më vjen turp që s'e kam lexuar ende

Turp është fjalë fort e rëndë për të përcaktuar keqardhjen që ndjej kur shoh sa shumë libra të mirë nuk i kam lexuar ende. Madje edhe që i kam në bibliotekën time e që i kam blerë me gëzim të madh.

Librat që kam dhuruar

Ka shumë. Unë dhuroj gjithë kohën libra. Dhuroj madje vetëm libra që i kam lexuar e që më kanë pëlqyer. Nuk kam asnjë ushtje bibliomanie.

Libri me të cilin dua të mbahem mend

Sinqerisht nuk e di. Ende nuk kam filluar të mendoj për pavdekësinë time. Tani, duke u ndalur një çast te pyetja juaj, po me bie nder mend se diku te romani i fundit, "366 rrëfenja për të ndjellë gjumin" jam argalisur pak pikërisht me një dilemë të tillë.

Libri që me bën të ndihem mirë

Nëse e keni fjalën për librat që kam shkruar unë, do të përgjigjesha pa ngurrim se është "Autoportret me teleskop". Për shumë arsye.

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar

Nuk e di. Nuk e kam bërë kurrë dhe nuk jam ende i gatshëm ta bëj një bilanc të tillë.

DASHURI NGA LARGËSIA

letër të dashurit

nga Dituri Dizdari

Nuk e kisha menduar asnjëherë se një ditë do të shkruaja dhe do të tregoja atë që përjetova dhe që është historia e dashurisë sime, të paktën për kuptimin tim, jo se unë pata dyshime tek ti, porse tashmë mund të flas vetëm për veten, edhe pse e di që edhe ti mendoje për mua. Ti jeton larg dhe nuk e di po të ishe këtu në Tiranë a do të guxoja të thosha ato pak gjëra që ti nuk i di, porse, edhe po t'i marrësh me mend, të paktën për diçka të jesh i sigurt lidhur me mua.

Ne u njohëm në zbor, ose stërvitje ushtarake që quhej atëherë e që zgjati disa ditë. Ti sapo ishe emëruar në Institut, ndërsa unë në vitin e parë të universitetit. As që mund ta dija se aty në atë ambient, që asnjë prej nesh nuk e donte, porse qemë të detyruar, do të më ndodhte të zgjohesha një mëngjes nga një dritë thellë shpirtit tim e që dritësoi përjetësisht jetën time.

Një djalë i zgjuar dhe me tis të lehtë humori, më re në sy menjëherë. Thjeshtësia dhe sportiviteti yt më tërhoqën drejt teje, mua, vajzën që nuk di as sot të dojë me mendje një shok, por as edhe një shoqe. Lexoja e studioja gjithë kohën dhe pasioni për librat më ka larguar gjithmonë nga njerëzit, por për këtë nuk kam ndonjë keqardhje. Pikërisht një vajze si unë do t'i dukej mrekulli një njeri si ti aq i lirshëm dhe do t'i dukej vetë perëndia e zbritur në tokë zgjuarsia jote. Ishe njeriu i dytë më i zgjuar pas babait tim.

Çfarë rastësie, të dy ishit nga e njëjta krahinë.

Çadrat tona i ndante një tavolinë e gjatë druri, ku drekonim apo mblidheshim mbrëmjeve edhe për të parë televizorin bardhezi. Po kush e kishte mendjen tek ai ekran!

Unë isha pranë teje dhe një botë gjithë mister më ishte përqasur.

Prisja me ngut të zbardhte, të të shihja dhe ti më çudisje me humorin tënd, thjeshtësinë e të qenit ndryshe, i vëmendshëm, i sjellshëm, shumë i zgjuar.

Një ditë nuk ishe në zgjimin e mëngjesit. Një natë më parë rreth zjarrit, duke parë televizor, të vështrova, m'u duke i lodhur. Më pas më tregove se ishe fshehur nën batanije; vije i dobët dhe bëre sikur në krevat nuk kishte njeri. Sa kam qeshur me këtë, vërtet qe tmerr të ishe gatitu, sapo binte alarmi. Në gjashtë të mëngjesit! Kush ngrihej me dëshirë? As edhe një!

Por ja që edhe ajo stërvitje ushtarake e atëhershme bëri një mrekulli. Të njoha ty!

Të vështroja dhe isha në ëndërr, krejt i lirshëm na shpjegoje teorinë, më shihje kinse në të rrallë, zemra ime rrihte fort, dita vinte e gëzuar, mbrëmja me ëndrra. Ishte freskët dhe natën binte vesë. Qe prag vjeshte.

Kur mbaruam stërvitjen, pak ditë më pas tek ecnim së bashku nëpër Tiranë, papritur më the:

- Je më e mirë kështu!

Ndala hapin dhe të vështrova, ishte komplimenti yt i parë. Ti më kishe njohur veshur me uniformë ushtari dhe unë ndjeva miklimin e jetës sime, u lulëkuqa.

Shtëpitë tona nuk janë larg njëra-tjetrës as sot dhe Bibliotekën Kombëtare e kishim afër.

Nuk lamë takim asnjëherë. Të dy e dinim ku ndodheshim, në çdo orë të ditës.

Ti sapo ishe emëruar në Institut, ndërsa unë fill nga leksionet në universitet, studioja në bibliotekë. Aty shiheshim, vije nga puna, tërhiqje materialet e tua për disertacionin dhe unë vështroja se si gjithçka tek ti ishte njëherësh aq fantastike: mënyra si vije me librat dhe kërkoje vend në sallë, si më shikoje dhe buzëqeshje po aq çlirshëm. Të gjitha këto më robëronin, ndihesha jotja me gjithsej dhe si të doja të ruaja me fanatizëm zjarrin që digjej, sillesha jo dhe aq ngrohtë, krenare.

Edhe sot habitem. Përse shfaqesha ndryshe ashtu sikur nuk isha, ashtu sikur nuk ndieja, unë që flatroja qiellit? Përse fshihja ëndrrën për t'u dukur ndryshe? Po unë ku isha? Pse nuk e pyeta një herë të vetme veten se çfarë kërkonte? Çfarë doja të fshihja, që më vriste po aq sa më lumturonte, pse krenaria më kishte robëruar mua, vetë mua, të blatuarën e qiellit? Kujt do t'ia besoja unë këtë kumt të shenjtë njeriu, e ngjizur nga ëndrra, se unë vetëm kështu mund të dashuroja, nën flatrat e saj?

Po ti, nga do t'i dije të gjitha këto?

Ti zije vend dhe shfletoje me interes dispensat, enciklopeditë. Unë nuk mund të studioja më, të vështroja tinës, doja vetëm të ulesha pranë teje, të isha me ty e të të ndieja kur lexoje e kur mbaje shënime në një fletore të trashë. Doja vetë qiellin tim të më përkunde brenda kupolës së tij. Por nuk bëja asgjë nga këto dhe rrija e të vështroja, si të ishte hera e parë.

E shtangur nga drita.

Ti sigurisht nuk i di të gjitha këto, sepse e kam menduar gjatë, ethshëm, aq sa kam çmendur netët: "Çfarë më ndalonte mua, që më shumë ëndërroja se jetoja, t'i thosha ndjenjat e mia, t'i tregoja ato, se nuk kisha asnjë të drejtë të privoja edhe ty nga ndjenja jonë dhe pastaj të të thosha, duke m'u dridhur zëri dhe shpirti, se nuk të ndaja nga Edmonti i Luçisë, te *Bijë e mallkuar*, se kësaj bote ti ishe njeriu i vetëm që doja?"

Do të blija një stilograf dhe bash ashtu si e doja, vishnje me rreth të artë. U shkëputëm të dy nga studimi, lamë librat, unë çantën e shkollës dhe me paratë të mbledhura shuk në dorën time, dolëm. Pamë në disa vitrina, por unë nuk vendosja dhe duke ecur e nervozuar ashtu kot, më ranë disa monedha nga dora e u rrokullisën trotuarit. U ule t'i mblidhje dhe më vështrove.

U bëra keq.

Çfarë vajze isha unë që nuk mbaja kuletë për paratë?

Më erdhi turp prej teje, u ndjeva jo e denjë dhe ky lloj ngurrimi po më ndodhte shpesh tani mua që kundërshtoja veten në gjithçka, binte ndesh me kokën time të fortë.

Nuk isha e lirë, gjeni im kishte zgjedhur tokën në vend të qiellit dhe ky gabim i përjetshëm më kishte robëruar, isha e tendosur, krenaria nuk më linte të thosha çfarë doja, të bëja çfarë doja, isha një njeri që del në skenë dhe ka harruar tekstin.

Paratë i mbaja në xhepin e çantës së shkollës. Po çfarë vajze isha unë që nuk kisha as edhe një pasqyrë, nuk vija kurrë laps të zi rreth syrit, asnjëherë të kuq buzësh, edhe pse zgjidhja me kujdes sapunin "Pranvera", kremin "Nivea" dhe kërkoja si të mundesha pak miligram nga parfumi im i preferuar, një nga gjërat më të vështira të asaj kohe.

Ti kishe marrë rrogën dhe më ftove të merrnim bashkë diçka.

Ishte hera e parë në jetën time që do të ulesha në një lokal me një djalë.

Po studioja në bibliotekë dhe e ndjeva pa e ngritur kryet se ti po rrije në këmbë dhe po më vështroje. Ti nuk e di sa e lumtur u ndjeva në ato çaste, zemra përjetonte qiellin e ndjenjës, se askush deri atëherë nuk më kishte vështruar ashtu, nuk më kishte bërë që të dridhem me gjithsej, mua që as dorën nuk të kisha prekur, as dhe fjalën të dua nuk ia thamë njëri-tjetrit. Puthja jonë – foshnja që nuk lindi kurrë. Edhe sot vuaj.

Por ndoshta kështu e mendoja dashurinë atëherë, kështu doja apo dija të ndodhte, të flasin sytë, se ata thonë më shumë se fjalët, të robërohej shpirti prej ndjenjës më të çmuar të dheut që mbante vetes. E kujt mund t'ia besoja këtë shenjtësi? Të verbonte ajo dritë për ta besuar, ishte vetë hyjnia për ta jetuar, ndaj nuk bëja asgjë.

Ja tani kjo dëshirë jotja u bë keqkuptimi im, gabimi im që më dënoi, na dënoi të dyve.

A mund të më kuptosh nga këta rreshta, nga fjalët e zemrës sime në këto çaste, se gjithçka po të them është e gjallë ende tek unë, se nuk i dola dot përballë asaj deri më sot, se ndoshta kjo letër që po të shkruaj është çlirimi im?

A do të më falësh ndonjëherë?

Nuk di si të them... ecëm pak hapa dhe dolëm nga sallat e bibliotekës. Ti e di, e mban mend atë kohë kur nga salla e madhe e leximit dhe holli ku skedoheshin e kërkoheshin librat ngjitej direkt lart nëpërmjet shkallëve, në katin e katërt, ku ndodheshin kafja dhe pastiçeria.

Pa u ngjitur ende nëpër ato shkallë, unë u ndala.

Se ç'më tha mendja prej vajze që i paramendon si të shkruara që në placentë të gjitha gjërat e kësaj bote, se unë, vajza që nuk kisha bërë as një hap me një djalë në jetën time, po bëja tani diçka të gabuar dhe ajo që më trandi shpirtin në çast nuk ishte dëshira, do të vija me ty deri në fund të botës, por ideja se çfarë do të mendoje ti për mua, çfarë do të thoshe ti kur unë të ulesha në pastiçeri me ty?

Tani që e mendoj! Po ku ishte mendja ime për të kuptuar se ajo farë pyetjeje as që kishte vend në ato momente? A kishte vend mendimi kur ti më zgjate dorën, kur më vështrove aq sa unë e humba edhe më?

Atëherë mendja jo, shpirti jo e jo, çfarë më shtyu të prish pa ditur se çfarë po bëja, me duart e mia, atë magji perëndie? Atë ndjenjë që si foshnjë gulçonte të jetonte?

Edhe sot e ndiej të këlthasë e të kërkojë përgjigje prej meje. Po çfarë t'i them? Kam një jetë të tërë që nuk i them dot asgjë!

Po ti çfarë mendove pas kësaj?

Ti e di, atëkohë vajzat vdisnin të lidheshin me djem të punësuar e të stabilizuar në Tiranë, për shkak të emërimeve katrahurë në çdo cep të vendit. Po unë ç'hyja këtu, përse mendja ime po stërhollte tani atë që nuk e kishte menduar kurrë më parë?

Unë as që kam dashur të di se ç'ndodhte përqark, më ka mjaftuar vetja, odëzat aty, ndjenja që përjetoja e që nuk më linte të flija, se emrin tënd e thosha me zë të lartë në mendjen time, aq sa më buçiste koka. Të doja dhe qeshë marrosur pas teje.

Pak kohë më parë, një i këtillë, pra një i punësuar në Tiranë, kishte sjellë shkuese xhaxheshën time që të fejohej me mua.

- Është nga familje e mirë, soj, - shprehej ajo, - punon në ministri. - Ka rrogë të mirë, - plotësonte mikesha e shtëpisë sonë.

Mamanë time nuk e zinte vendi. Unë nuk e di a kisha mendje se çfarë flitej.

Të nesërmen djali erdhi në shtëpi. Më dha dorën si të lutej dhe unë të isha perëndia, si të qe ngritur i ngrati lëngatës së gjatë.

As sot nuk e harroj dot atë takim dore. "Ky do të ishte burri im?"

Rashë për të fjetur, isha shumë e lodhur. Nga kuzhina vinin zëra të gëzuar. Zero koncept. Më zuri gjumi në çast.

Rreth orës shtatë të mëngjesit, si të kishte rënë kambana e orës së qytetit, brita me zë, sa ma dha koka, duke ndalur në çdo rrokje:

- Nuk do të fe-jo-hem!

Këtë ta tregova për të thënë se e kam ndier herët se nuk mund të lidhesha me dikë pa e dashur dhe ky ishte një pakt i bërë me shpirtin, ku unë nuk hyja asgjëkund.

Atëherë ç'hynte këtu Tirana apo që do të ulesha për herë të parë në kafe me një djalë dhe pse në sekondë ndryshova mendje, pastaj kuptim. Të doja ty dhe pikë! Përse i dhashë rol pavlerës? Përse vrava përfundimisht atë ndjesi perëndie?

- Nuk jam për ty!

Ku e gjeta këtë fjalë, nga ç'shtresë e trurit apo subkoshiencës zbriti? Gjeni im të mbartte një marrëzi të tillë?

Nuk mund ta besoj as sot. E si mund ta besoje ti?

Por druaj se nuk e mësove kurrë këtë gjyq të ashpër që ndodh edhe sot brenda meje dhe që ngre kokë sa herë do. Ti ndoshta ngrite një pikëpyetje të madhe, e kjo për fajin tim.

Gabova, krenaria më robëroi, vetja, desha më shumë atë se dashurinë time, dashurinë tonë, burgosa shpirtin tim, i cili nuk mund të harrojë kurrë.

"Më fal, i dashur, nëse mund të më falësh për atë, ne, që jetoi aq pak, por aq mrekullisht".

Ti u largove i çmeritur. Më e pakta që ke menduar atë çast: "Kjo vajzë është e marrë!"

Nuk e dija që kjo do të ishte dita e fundit që fola me ty.

Tani kthehesha nga leksionet në shtëpi. Në bibliotekë shkoja çdo mbasdite në orën katër. Ishte bash koha kur ti kthehesha nga Instituti në shtëpi, me biçikletë. Të të shikoja ty përballë, në ato pak çaste, çdo ditë, në të njëjtën orë, u bë rituali im, i pas-atyre ditëve me ty, dallgë që nuk bën dot pa bregun, u bë frymëmarrja ime, jeta.

A të kujtohen ato ditë kur ti kthehesha për në shtëpi e unë isha aty buzë trotuarit kinse rastësisht duke ecur, vetëm për të parë aq pak sekonda sa e lejonte përballjen shpejtësia e biçikletës sate? Ti e kujton siluetën time, ku lexohej nga koka te këmbët krenaria, por tani e pleksur me pendimin. Por ti mbete i njëjti, vështrimi dhe buzëqeshja jote më flisnin ende, çfarë doja më shumë prej teje?

Të faleminderit, i dashur!

Më lejo ta them këtë, e bindur se aq sa zgjati e gjitha vazhdon të jetojë tek unë si të qe dje, pavarësisht kohës, moshës, botëkuptimit, rrethanave, që më treguan se nuk vlejnë asgjë përpara dashurisë.

KTHIMI I AVIATORIT ANGLEZ

tregim nga Luan Rama

Po perëndonte kur i ati mbylli sytë. Ajo dritë e dielltë që vinte nga dritarja sikur i praronte flokët e tij të rrallë.

- Fli pak babush, - i pëshpëriti ajo dhe shkoi të mbyllë dritaren e dhomës së spitalit.

- Jo, nuk më flihet. Kam kohë për të fjetur. Tani më duhet të udhëtoj…

Ajo stepi një çast dhe e vështroi e habitur. Për ç'udhëtim e kishte fjalën. Vallë po fliste përçart apo si?

Ai burrë 85 vjeçar qëndronte gjithnjë symbyllur. Në fytyrën e tij të imët e të verdhë ndjehej se vdekja po afronte.

- Ishte natë…

- Ç'po thua baba?

- Po, ishte mesnatë kur fluturonim mbi Menuls.

Vetëm kur shqiptoi këtë emër ajo e kuptoi se nuk po fliste përçart. Kohët e fundit gjithnjë e më shumë ai fliste për kohën e luftës, Normandinë, Menuls...

Iu afrua dhe kapi dorën e tij të dobët dhe të lëshuar pa forcë.

- Ishte një natë e bukur, një qiell plot yje por ne s'kishim kohë ta kundronim atë botë të magjishme qiellore.

- Për kë natë e ke fjalën.

Ai pëshpëriti diçka të pakuptueshme dhe pastaj heshti. Ajo e vështroi gjatë. E dinte që vuante shumë dhe se tani as morfina nuk arrinte ta qetësonte.

- Po perëndonte kur ekuipazhi ynë i Lancaster linte bazën tonë në Brize Norton dhe nisej përsëri drejt La Manshit, Normandisë, Yvelines e Pointivin… Më kujtohet mirë kur atë buzëmbrëmje në bazë pimë nga një uski me komandantin Smith. Një ditë më parë aleatët zbarkonin në brigjet e Normandisë. Netët tani më ngatërrohen dhe unë jam gjithnjë me ta. Në drejtim të avionit ishte piloti Conlon, në krah kisha kapitenin Eliot Hopton dhe pas tij serxhentin Larkins. Përballë, ulur pranë mitrolozëve të tyre ndodheshin serxhentët Wood dhe Gibbes… radisti Mayes përgjonte pranë aparateve të tij. Ndërkohë që fluturonim papritur dëgjuam të shtëna nga bateritë gjermane që përgjonin në tokë. Na kishin pikasur. Vazhdonin të qëllonin mbi ne. Atëherë fikëm dritat duke shpresuar pak mjegull. Pastaj një predhë qëlloi mbi ne… Dhe ne e ndjemë se po binim duke humbur lartësinë. Alarmi në avion nuk pushonte. Lietnanti Conlon ishte qëlluar në kokë.

- Baba, çfarë thua? Atë natë ti nuk ishe me ta?

Ai hapi sytë dhe e pa i habitur.

- Ashtu? - dhe vështroi përreth duke pikasur se ishte ende në atë dhomë spitali.

- Ah, po, e di… por ja që ende jetoj me ta, - psherëtiu më së fundi ai.

Ajo e vështroi me dhimbje por ai i mbylli sytë sërish. Fliste në errësirë. Ndoshta kjo e ndihmonte të jetonte në një kohë tjetër, atë që s'donte ta harronte kurrë.

- Atë ditë dhe unë vdiqa me ta!

Ajo u afrua dhe e puthi përsëri në ballë. Një lot i rrëshqiti dhe padashur i ra dhe atij në faqe. U drithërua. "At im i mjerë", pëshpëriti ajo me vete duke menduar njëkohësisht: Përse kështu? Çfarë vallë e shtynte atë gjithnjë e më shumë drejt asaj nate të zezë kur u shua jeta e gjithë ekupazhit të tij, kur pas më shumë se gjysmë shekulli plagët e luftës ishin mbyllur?...

Kapiteni Leigh kishte kohë që jetonte luftën. Pas vdekjes së gruas së tij Elisabeta, dhjetë vjet më parë, ai ishte angazhuar me shoqatën e pilotëve të Normandisë dhe shpesh shkruante kujtime dhe artikuj për revistën ushtarake. Skudriljet angleze në kohën e luftës së Dytë Botërore ishin një nga armët më të fuqishme të mbretërisë për të përballur sulmin nazist dhe bombardimet e tmerrshme që iu bënë veçanërisht Londrës gjatë "Betejës së Anglisë". Kryeministri Çurçill kishte besimin e plotë në ta por me zbarkimin në Normandi, mijra nga aviatorët britanikë kishin rënë në luftën kundër ushtrisë gjermane që shpejt do të tërhiqej me shpejtësi. Në misione të shumta kapiteni Leight kishte bombarduar parreshtur rradhët e ushtrisë naziste gjer në tërheqjen e tyre përfundimtare, në Gjermani. Madje, pas bombardimit të Drezdenit, me avionin e tij Lancaster ai kishte bombarduar dhe mbi bunkerët e Hitlerit, i cili fshihej brenda Berlinit.

Pas luftës, jo rrallë Leight kishte pyetur veten se pse pikërisht ai kishte shpëtuar nga ekuipazhi i tij i Lancaster dhe nuk kishte vdekur me shokët e tij. Vallë një fuqi e mbinatyrshme e kishte larguar atë natë nga detyra. Përse kishte ndodhur kjo? Ishte e vërtetë që atë ditë ai ishte i sëmurë dhe kishte qenë komandanti Scott që e kishte penguar të shkonte edhe pse ai kishte këmbëngulur. Në vend të tij kishte hipur në avion serxhenti Jones. Megjithatë, me kalimin e viteve, kjo brerje e ndërgjegjes, ky peng enigmatik ishte shuar ngadalë. Tre vjet pas luftës, në Oksord, ai ishte martuar me Elisabetën dhe shpejt ishin bërë me një vajzë, Bernardetën, që ishte gëzimi i tyre më i madh. Megjithatë kur vinte dita përkujtimore e Menuls, një ankth i madh e pushtonte dhe atëherë gjente gjithnjë një arësye të largohej nga shtëpia, të ikte, të bridhte fushave në vetminë dhe dhimbjen e tij dhe të kthehej vetëm të nesërmen. Pak nga pak Elisabeta u mësua me arratinë e tij dhe e dinte që ajo ditë ishte tronditëse për të. Njëherë kishte dashur ta shoqëronte, kudo që të ishte, por ai nuk pranonte. Donte të ishte vetëm dhe të përjetonte humbjen e tyre, të pinte dhe të flinte diku i dehur, të humbiste në errësirë në bidonvilet e Londrës edhe pse ishte një oficer i nderuar i flotës britanike. Pinte dhe qante për shokët e tij duke folur me ta sikur ata të ishin aty, para tij, në tavernën e varfër të bazës ushtarake duke kujtuar të dashurat e tyre. Pinte në një mejhane të ndyrë duke rreshtuar para vetes mbi tavoline tetë gota të mbushura me whisky, një për secilin nga ata, dhe kështu, në çdo gotë që kthente, ai përshëndeste shokun e tij të dikurshëm, qeshte me të, tregonte një histori dashurie e kështu me rradhë. Por dhe ata i flisnin, në fillim me mërmërima, pastaj zëri i tyre bëhej i plotë, bëheshin të gjallë. Dhe kështu ai harronte nocionin e kohës.

- Ktheje Steve, të urojmë të kthehemi gjallë nga misioni i nesërm.

- Gëzuar John! E di që në dasmën tënde do dehem dhe do pi i çmendur për dashurinë tuaj.

- Ej, Lemon, çke që mendon kaq shumë. Ngrije gotën për të dashurat tona që na presin me aq mall.

- Bob? … Ku është Bob irlandezi?

Dhe ai vazhdonte të ngrinte gotat duke kujtuar historitë e tyre dhe luftën në ajër për mbrojtjen e Londrës. E atëherë i shfaqej ajo ditë kur në perëndim të diellit, verbuar nga dielli, nuk i kishte vënë re dy Messerchmitt që e ndiqnin nga pas dhe po i afroheshin ta godisnin. Ishte Bob që i kishte pikasur dhe ishte kthyer për ta mbrojtur nga ajo vdekje e sigurtë duke u sulur mbi gjermanët. Por ndërkohë u kujtua. Dëgjoi përsëri zërin e një prej shokëve që kishte thënë me dhimbje: - Bobi ka humbur në oqean tashmë!... E kështu, koka iu shëmb mbi tavolinën e tavernës duke humbur në atë botë të vrarësh që kishin humbur në atë luftë dhe nuk do të ktheheshin më. Pastaj, i dehur, një qetësi e thellë e rrethonte. Përse endej kështu në këto netë të errta, në heshtjen e madhe të botës?

Kështu kalonin vitet me pengun e madh, i cili rizgjohej sa herë afrohej ajo datë e tmerrshme. Më vonë, si anëtar i Shoqatës së Aviatorëve Britanikë të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore në Normandi, ai nisi të vijë në brigjet franceze të La Manshit dhe pikërisht në Menuls, për të përkujtuar vdekjen e shokëve të tij. Menuls ishte një fshat i gjelbëruar në Yvelines, me një kishëz mesjetare dhe varrezat pranë saj, ku në ballë ishin varret e aviatorëve britanikë. Sa herë vinte, në ceremoninë një orkestër e fshatit do të luante për ta të njëjtën muzikë që ishte luajtur në atë kishë kur ata i kishin varrosur: "God Save The Queen!…" Dhe kjo muzikë e bënte atë vend akoma më të shenjtë duke i falur një dashuri të jashtëzakonshme për shokët e rënë. Dy ditë më vonë Rezistenca Franceze

e kishte njoftuar komandën angleze se të gjithë aviatorët e vrarë i kishin varrosur në varrezat e fshatit. E kujtonte mirë atë perëndim dielli të 7 qershorit të vitit 1944, kur ekuipazhi po hipte mbi Lancaster. I shikonte tek e përqafonin dhe nxitonin drejt pistës, nën dritën e zbehtë të prozhektorëve të aerodromit ushtarak. I shfaqej avioni që shkiste në natën që binte dhe fytyrat e tyre brenda avionit bombardues. I shikonte me rradhë sërish, siç i kishte parë në misionet e panumurta mbi Lancaster. Mjerisht, të gjithë ishin vrarë atë natë… Ja pse Menuls ishte kthyer kështu në vendin e tij të shenjtë, nga ku e kishte të vështirë të largohej.

Por diçka e çuditëshme ndodhi me të pas vdekjes së Elisabetës: tashmë gjithnjë e më shumë jetonte me kohën e luftës, kujtimet, misionet e tij mbi Normandi. Madje gjatë këtyre viteve të fundit, duke vizituar jo pak vende të Normandisë si anëtar i shoqatës"Krahët e thyer", në shumë prej varrezave kishte parë memorialet për aviatorët anglezë rënë gjatë luftës. I kishte parë ato në Yonne, Giverny, Baumont-le Roger, Saint-Sever në Calvados, Saint-Leger en Yvelines, Mazargues, Tregunc, Boulogne-sur-Mer, Muneville-sur-Mer.

Vitet kalonin ndërsa kapiteni Leight i Air Royal Force, me pengun e madh në shpirtin e tij, dukej sikur shkonte në të kundërt të kohës. Për 35 vjet me rradhë ai kishte shërbyer në shkollën e formimit të pilotëve të rinj të ushtrisë britanike. Tashmë nuk ishin më avionët e vjetër Lancaster apo Bristol, Hawker, gjuajtësit Spitfire etj… Tani avionët ishin supersonik dhe teknologjia më e fundit e shkencës. Dukej sikur koha për të nuk kishte më të ardhme dhe sa më shumë ajo kalonte, aq më shumë rikthehej në atë datë fatale kur ai duhej të ishte bashkë me ekuipazhin në momentin tragjik. Koha për të kishte ndaluar, madje ai kishte një lloj ndjesie se akrepat e sahatit të vjetër në murin e sallonit tashmë shkonin mbrapsht. Gjithnjë e më shpesh, në shtëpi, me miqtë e tij apo pilotët e rinj të shkollës, ai fliste për misionet që bënte me Lancaster-in e tij, duke treguar kurajon dhe trimërinë e shokëve gjatë luftës. Shumë herë e kishte parë vdekjen drejt në sy ashtu si në një nga misionet e para në vitin 1940 kur fluturonin mbi Pas de Calais dhe kur u qëllua nga avionët gjermanë. Avioni i tij zbriste me shpejtësi drejt detit ndjekur nga një tym i zi dhe pikërisht në momentin e fundit, duke u përpjekur ta ulte mbi ujë, ai u hodh, ndërkohë që avioni zhytej me një zhurmë të llahtarshme në det. Gjithë atë natë kishte qëndruar mes dallgëve të detit dhe të ftohtit të madh duke ndjerë se vdekja po i afrohej, por në ag, në përhumbjen e shpresës së madhe, një motovedetë britanike kishte ardhur dhe e kishte marrë. Ishte plagosur në krah.

Disa vjet pas vdekjes së Elisabetës, diçka tjetër do ta rikthente në kohën e luftës: njohja e tij me Laurën në një nga fermat afër qytetit verior të Lilës. Një ditë, duke riparuar strehën e shtëpisë së tyre, lart nën çati, Bernardeta kishte zbuluar një tufë letrash dhe meqë ishin në frëngjisht. I ati kurrë nuk kishte folur për to dhe ato letra e kishin bërë tepër kureshtare. Ishin letra të kohës së luftës dhe pikërisht atëherë, kur në tetorin e vitit 1944 kapiteni Leight bashkë me serxhentin Norman, gjatë një dyluftimi në ajër u ndeshën me tre Messerchmitt gjermanë. Papritmas avioni i tyre kishte marrë flakë dhe ata më

së fundi kishin mundur të shkëputeshin nga avioni duke u hedhur me parashutë. Këtë histori i ati e kishte treguar shpesh, por për këto letra të marra nga francezja Laura, ai nuk kishte folur. Ishte një sekret i tij. Në shumë prej tyre, në fund, do kishte të vizatuar gjithnjë një zemër, një lule apo buzë çka zbulonin qartë dashurinë e asaj kohe. Vallë e kishte ditur nëna e saj? Gjithë atë natë kishte menduar rreth atyre letrave të fshehta duke kërkuar të imagjinonte se kush fshihej pas atij emri. Vallë a ishte gjallë? Kur kishte ndodhur kjo dhe pse ishin ndarë? Të nesërmen, më së fundi e kishte pyetur të atin:

- Baba, në një nga kutitë e tua gjeta këto letra, - dhe ajo ia kishte zgjatur.

Babai i kishte marrë në duar, kishte hezituar një çast dhe pastaj kishte qeshur lehtë.

- Eh, një histori e largët… Por nëna tënde e dinte.

- Çfarë? Një histori dashurie?

- Mund ta quash kështu edhe pse bëhet fjalë për një periudhë fare të shkurtër. Dëgjomë bija ime. Atëherë po fluturonim mbi qytetin e Lilës me një Spitfire kur sapo e kaluam u ndeshëm me tre gjuajtës gjermanë Messerchmitt. Avioni mori flakë dhe ne u detyruam të hidhemi me parashutë… Më kujtohet që ishte nga mesi i vjeshtës dhe ne ramë mes një pylli të dëndur. Miku im Norman ndrydhi këmbën dhe e kishte të pamundur të ecte. Pasi fshehëm parashutat, ashtu të armatosur, gjatë natës, me Normanin në krahë, fillova të kërkoj përreth dhe më së fundi pas gjashtë kilometrash gjeta një fermë. Pikërisht atje u njoha me Laurën, vajzën e Rozhesë, patronit të fermës. Ishte një vajzë e bukur dhe mjaft e brishtë. Ne shpejt u miqësuam. Sigurisht, gjermanët na kërkuan atë kohë por ne na fshehën në një vend të fshehtë në hambarin e madh të barit, ku Rozheja kishte krijuar një vend të fshehtë nën tokë. Një ditë një kompani gjermane erdhi papritur por lumturisht ata nuk kontrolluan si zakonisht. E kishin hallin të merrni barin për kuajt që tërhiqnin topat për të vazhduar tërheqjen drejt Gjermanisë. Historia jonë e dashurisë vazhdoi veç dy muaj, pasi një avion i flotës sonë erdhi dhe na mori. Kështu ne u nisëm përsëri në ndjekje të gjermanëve. Ishte beteja e madhe për pushtimin e Anhem, në Hollandë.

- Po Laura?

- Sigurisht më donte, por atëherë ishte luftë. Laura priste të kthehesha tek ajo dhe pastaj të shkonim në Oskford, por kjo u bë e pamundur. Për më tepër letrat merrnin muaj që të mbërrinin në destinacion. Ekuipazhi ynë bashkë me 20 ekuipazhe të tjerë qëndruan në bazën ushtarake të Berlinit. Kur unë u ktheva në Oksord, gjeta një letër të Laurës që më njoftonte për martesën e saj. Prindërit saj nuk besonin në dashurinë tonë dhe më së fundi ajo ishte thyer. Ajo vajzë e brishtë nuk e kishte kuptuar se çdo të thoshte luftë dhe se beteja për Berlinin ishte beteja përfundimtare për mposhtjen e nazizmit.

Pastaj ai kishte heshtur… Kështu kishin kaluar vitet pa u ndjerë dhe gjithnjë me pengun e madh. Në sallonin, vendosur në një kornizë, mbante gjithnjë atë fotografi të shtrenjtë dalë me gjithë ekuipazhin, një ditë para një misioni. Të gjithë të qeshur, por fati kishte dashur që vetëm ai të mbijetonte nga ajo luftë gjer në këto ditë kur vdekja po i afrohej dhe atij…

- Bija ime, - pëshpëriti kapiteni Leight, - tashmë ti e di dëshirën time të fundit. Dua të më përcjellësh në Menuls.

- Përse?

- Të më varrosësh atje.

- Oh, po pse mi thua këto… ne duhet të shpresojmë.

- Dje doktori ta bëri të qartë. Kjo mund të ndodhë sonte, nesër ose një javë më vonë. Eshtë e pashmangëshme.

Bernardeta heshti. Ndërsa i ati vazhdonte. Tashmë e shikonte drejt e në sy.

- Për këtë i kam dërguar një letër ministrit të Mbrojtjes dhe po kështu dhe ministrisë së Jashtme. Dua të kthehem tek shokët e mi.

- E di, por nuk e kuptoj këmbënguljen tënde, - shtoi e dëshpëruar ajo.

- Bija ime e shtrenjtë. Unë duhej të kisha vdekur në 7 qershor të vitit 1944. Gjithë këto vitet e fundit fytyrat e shokëve të mi nuk më janë ndarë. Me ta luftuam së bashku gjatë gjithë kohës së luftës. Bashkë kaluam sprovat më të mëdha kur vdekja na përgjonte çdo çast. Ishte Campbell që një ditë mbi brigjet e Nantes më shpëtoi nga vdekja e sigurtë kur dy Messerchmitt më ndiqnin pas me bataretë e tyre. Pilotin Campbell e doja si vëlla. Dhe ai dashuronte dhe fotografinë e të dashurës e mbante gjithnjë në xhepin e xhaketës. Kapiteni Foster kishte dy fëmijë të vegjël, por ai s'do ti shikonte më fëmijët e tij pas asaj nate, kur më së fundi nuk u kthye në bazë. Më kot e pritëm. Duhej të ishte rrëzuar diku në La Mansh por ne kurrë nuk e gjetëm trupin e tij. Vdekja na përgjonte çdo çast, por ne i jepnim kurajo njëri-tjetrit. Fati deshi që unë të mbijetoja, të njihja nënën tënde, të kisha një vajzë si ty, por tani, pas kaq vitesh, kthimi tek shokët e mi do mi lehtësojë të gjitha dhimbjet edhe pse jam në prag të vdekjes.

Ai ndaloi dhe mori frymë thellë. Pastaj vazhdoi.

- Jetova gjatë… tashmë mund të shkoj të pushoj i lumtur. Franca nuk është larg që këtu dhe ti mund të vish kur të mundesh… Nuk do të jem vetëm.

Një heshtje e madhe ra mbi ta. Tashmë vetëm akrepat e sahatit të vjetër mbi mur dëgjoheshin: tik-tak, tik-tak. «Koha për tu kthyer», mendoi ai dhe pastaj pëshpëriti:

- E çuditëshme. Në prag të vdekjes, të gjithë shpresojnë se do të shkojnë në një vend tjetër, diku, tek të dashurit e tyre. Disa mendojnë Parajsën, të tjerët në oborrin qiellor të Zotit, ndërsa unë mendoj kthimin tim. Dua të më përcjellësh bija ime që më së fundi të bashkohem me ata.

Kapiteni Leigh zgjati dorën dhe preku fytyrën e vajzës së tij.

- Më fal bija ime… të paktën kështu do të flë me ta në paqen e pafund.

Atë ditë në spital, vajza e kapitenit Leight qëndroi gjatë. E ndjeu se ishte e kotë të vazhdonte ti mbushte mendjen se s'kishte pse të largohej nga familja dhe të shkonte gjer në Menuls. Rrugës, duke u kthyer për në shtëpi iu shfaq sërrish fytyra e të atit me një lloj drite dhe gëzimi të habitshëm tek i fliste për kthimin e afërt të tij. Shpirti i tij nuk kërkonte as nderet që bëhen në këto raste dhe as lavdinë, por veç të shkonte në atë tokë, që edhe pse e huaj, mbante në gjirin e vet miqtë e tij me të cilët dikur kishte luftuar vdekjen e pashmangëshme.

Tri ditë më vonë kapiteni Leight dha frymën e fundit. Shoqata e aviatorëve të vrarë britanikë «Krahët e thyera» i kishte bërë gati të gjitha formalitetet. Një përfaqësues i flotës ajrore të Air Royal Force do të ishte i pranishëm ditën e varrimit në Menuls.

Dy javë më vonë, mbi varrezat e Menuls binte një diell i bukur dhe i ngrohtë. Para se ta zbrisnin në banesën e fundit, një orkestër luajti himnin e famshëm «God Save The Queen… Gjithçka ishte në fjalët e atij himni: «Që Zoti të mbrojë mbretërinë! Bëje atë fitimtare, të lumtur dhe të lavdishme!...»

Ishte mars i vitit 2006 kur kapiteni Leight u varros pranë shokëve të tij… I njëjti himn që ishte dëgjuar dhe atë ditë të 8 qershorit të vitit 1944. Një himn që ngrihej lart si diçka hyjnore për të përqafuar kështu gjithë botën.

TREGIME NGA ESMERALDA SHPATA

GËRSHËRËZA

Gërshërëza nxori kokën e saj të vogël nga shega ku ishte futur dhe rrëshqiti duke tundur trupin mbi dysheme. Nuk e di sa milimetra i zgjaste shikimi, por sapo hipte mbi dicka të lartë bënte një rrotullim njëqind e tetëdhjetë gradë dhe ndryshonte drejtim. Çuditem si u gjenda i përfshirë nga lëvizjet e saj të çoroditura. Më hutoi ajo gjallese myku e lagështire.

Për habinë time e pagëzova menjëherë me emrin Lara. Ky emër më doli tak-fak nga mendja. Sikur kishte pritur të shfaqej sapo të më dilte para një gërshërëz. E nxora nga ajo ditë që e pashë të shtrirë e të vdekur, të zverdhur e të rrethuar me një amzë dylli të sapo shkrirë.

Lara gërshërëz sikur i ndjeu sytë e mi mbi veten dhe i shpejtoi lëvizjet. Herë-herë rrokullisej nga nxitimi dhe i shihja një barkth pak të rrumbullakosur e me ngjyrë më të çelur se pjesa e sipërme e trupit të saj. Nuk e mora vesh as vetë si u gjenda në gjunjë , i përfshirë i gjithi nga ato lëvizje të trembura. I dhashë pak trupit dhe lashë t'i binte një fashë drite dyshemesë ku lëvizte si në skenë Lara. Për një çast më dukej e sëmurë dhe e lajthitur, sikur trupi i kërkonte të çlirohej nga demonët dhe përplaste bishtin e ndarë në mënyrë të njejtë, në dy tehe gërshërësh, nga të cilat ka marrë dhe emrin. Herë tjetër më dukej sikur brenda i vlonte pezmi për llojin e gjallesës që i kishte rënë për pjesë të ishte. Drejtonte dy antenat që kishte majë asaj grimce që mund të quhej kokë dhe gjuante ajrin e rraskapitur, sepse ato veprime të dëshpëruara as nuk mund të shquheshin.

Lara ma shtrëngonte dorën gjithmonë që ndiente se këmbët i bëheshin të ngurta, më shikonte në dritë të syrit dhe shquante brenda vështrimit tim. Zvarritej mes retinës duke rënkuar e me zor, aq sa në fund u dorëzua e shtrirë në një dërrasë, nga e cila buisën një re gërshërëzash pothuajse të gjitha njëlloj.

Më mbytën këto kujtime dhe iu vura pas me gishtin tregues gërshërëzës. Goja m'u mbush me lëng dhe rrahjet e zemrës m'u shtuan. Më hipi gjaku në kokë dhe i rashë me grusht dyshemesë aq fort, saqë dërrasa lëvizi nga vendi dhe krijoi një të çarë të errët. Gërshërëza shpëtoi nga grushti im dhe rrëshqiti në errësirën mes dërrasave. M'u ligështua aq shumë vështrimi, saqë rashë pa asnjë shpresë në dysheme. U lëshova si një thes i zbrazur, gjerba lotet që më dilnin nga sytë dhe hundët dhe iu dorëzova dhimbjes. U ndjeva i humbur e i dërrmuar, që atëherë kur e humba për së dyti Larën e di mirë se ç'është pikëllimi.

Për shumë kohë nuk ua hodha sytë shegëve, sepse nga to më binin për pjesë gërshërëzat. Por edhe tani që kanë kaluar aq vite dhe kujtimet pothuajse më janë shuar, më hipën gjaku sapo shoh një gërshërëz. I qepem pas në çdo cep që futet, e shkel me këmbë ose e shtyp me gishta, aq sa bindem se kalbësia e saj nuk do ta qelbë më shumë botën. Për ta hequr nga çdo forme jete atë, e hedh në qypin e banjës, i urinoj sipër dhe e shkarkoj ujin disa herë rresht.

NJËRI NGA NE KA FRIKË

Kam gjetur një të dashur, zonjushë Anjën. Buzëqeshja e saj është si diell dhe më zotëron shqisat. Natyrisht, nisur nga logjika, pamja ime e shqetësuar nuk mund ta shmangë dot dashurinë e shfaqur hapur për të.

Është shumë e shkathët, humbet për ditë të tëra në botën e saj të fshehtë. E kërkoj gjithmonë, më është bërë shtysë. Ndonjëherë lodhem shumë ta gjej. Ka raste që dhe tërhiqem, veçse, kur e ndërmend ç'vajzë e gjendur është, e gjej forcën sërish.

E kam ende ne mendje herën e pare që e ndoqa. Padashur, mendja më shkoi te sikleti që ndjeva kur u pamë në sy. Prania e saj më pengonte ta shihja më qartë, ula syte në tokë dhe një sëmbim në zemër gati më paralizoi.

Anja nuk më ka dashur ndonjëherë aq sa e dua unë. Këtë e ndiej, jo vetëm kaq, e ndiej dhe e di sepse e ndoqa një ditë kur doli nga puna.

Ajo ecte shkujdesur, unë i përvidhesha dhjetë metra pas me majë të gishtave.

Dyshimet e mia qenë kaq të forta, saqë kisha kohë që e planifikoja ta ndiqja. E ndoqa pra, pa e bërë fjalë me asnjeri tjetër.

M'u ftohën duart dhe ngriva në këmbë kur e pashë që trokiti në një derë të vjetër.

Trokiti tri herë dhe dera kërciti dhe e përthithi brenda. Më erdhi një mendim i ndyrë dhe volla.

Tani që e risjell në mendje atë rast e quaj veten me shumë fat që u ndjeva më mirë pas të vjellave. Instinkti im mashkullor i ra në të, e kuptoi menjëherë sesa e vështirë ishte lidhja me Anjën.

Nuk kam kujt t'i ankohem, mbase do të lehtësohesha disi në qoftë se do të kisha dikë t'i hapja zemrën.

Jam një burrë frikacak, e kam më të lehtë t'ia mbath gjetkë, nëpër përfytyrime, sesa t'i dal para dhe t'i flas çfarë ndiej së dashurës sime. Tani që e gjeta , mundem ta quaj kështu, e dashura ime. Më vonë do mundohem t'i shoh gjërat më qartë, por mbase deri atëherë do ta quaj të dashur.

I hapa derën e shtëpisë, i janë ndryshkur menteshat dhe kërcet kur e hap. E kemi lënë me fjalë, pas tri trokitjeve ia hapim derën njëri-tjetrit. Megjithëse në lagjen tonë nuk ka shumë lëvizje, vetëm disa çifte të moshuara që mbyllen brenda herët, nga frika se mos dikush i përndjek për t'i vjedhur.

Një dyshim i sëmurë, ca spazma të tmerrshme ankthi ma morën frymën në mënyrën më të keqe kur e pashë Anjën të tmerruar nga prania ime në rrugë. Ashtu në hall siç isha ia vura duart mbi fytyrë, ia zura hundët dhe ia shtrëngova aq fort sa më nëpërmendën përpëlitjet e fundit të këmbëve të saj.

Anjën e lëndova sepse e dua. Instinkti im i panginjur nuk i përket më së ardhmes sime, unë këtë e di, ama ajo tani është e qetë. Nuk e ndjek më askush, ajo është bërë imja me të gjitha, pa asnjë përjashtim. Sipas rastit, ajo nuk vjen në shtëpi për ditë të tëra. Ndërkaq unë jam përndjekësi i saj i betuar, është e kotë të shtirem, më i lënduari në të gjithë këtë unë jam. Nuk e di si nuk u morëm vesh e na humbi filli fare, nuk patëm asnjë parandjenjë për t'u kapur e për të mos humbur shpresat. Në fakt shtëpinë e blemë të dy, do të ishte e tepërt të thosha se unë kam kontribuar më shumë për të.

Veçse për derën nuk u morëm vesh ta ndërronim, ajo ma besoi mua, unë ia pata me hile, plus që u druajta për jehonën e tri të trokiturave.

TË KAM, TË GJETA

U mor vesh se e gjetën mënyrën për të të ngarkuar rëndë. Në mes të rrugës, aty ku ndahen drejtimet për nga do të mbash për gjithë jetën, kalon një mace pak më pak e zezë se e zeza. Dielli të bie mbi kokë, djersët përzihen me pluhur, por ty aq të bën. Megjithëse është vapë e tmerrshme ti nuk rri në një vend dhe as me mendje nuk e kërkon një hije apo pak ujë për t'u freskuar.

Më vjen keq djalosh, pak më tej është një bordurë ku mund të mbështetesh e të shpëtosh sado pak nga pesha mbi supe. Para teje është një hije e sajuar nga kalimtarë të lodhur nga vapa, para teje ka mundësi plot për ta lehtësuar ngarkesën mbi shpinë, por ky duket sikur nuk është halli yt. Nëse do ma besoje mua peshën e madhe mbi kokë unë do të ndihmoja, do të kërkoja të gjitha mundësitë për të shpëtuar ty. Dhe mos mendo se njerëzit nuk kanë shpikur e sajuar rrugë të dukshme e shtigje të fshehta për ta shpëtuar veten dhe rrethin e tyre të ngushtë. Nuk kam ç'të të them më, ti i di të gjitha. Klithmat e mia të inatit nuk e shpëtojnë dot dëshirën tënde të lëndët, as duke e kapërdirë masën e madhe të neverisë që ndien për mua e shqetësimin tim të vërtetë, as për historinë time njerëzore, atë që e ngjiza me kujdes për të mbijetuar.

Ti nga mesi i rrugës, aty ku takohen të gjitha shpikjet e botës mban në supe dhe kundron i ngazëllyer të vërtetën time, atë që mua më shëmbëllen me një mace apokaliptike. Nga ana tjetër të dhimbsem e kërkon të më shpëtosh. Rruga nuk është më as me pluhur, as me diell e mace, as me bordura e të vërteta që fshihen dhe veshin thelbet me shkëlqim të rremë.

Rruga që më shtrove është një kthinë, një rreng a lojë që e kanë shpikur të tjerë para nesh për një arsye të vetme, të dridhshme e mbase të rëndomtë për ta munduar aq shumë veten.

Përunjem para teje o miku im i vjetër, për ta lehtësuar këtë peshë të jetës, për t'u ndier i lirë me mua jashtë rregullave tona duke i shtrirë duart me përgjërimë natyrore.

M'i zgjat krahët të mbështetem e të vdes mbi gjoksin tënd e për herë të parë ta gjej mënyrën për ta hequr peshën e mirësjelljes.

Paturpësisht të dua!

TABLO E HAPUR

Në mes te njerëzve ia mban së qarës, një ligjërate të vjetër, nga ato që të krijojnë një trazim të ligë në stomak.

Lypset ta themi se dikush, një burrë i gjatë, me xhaketë të re e supe të rëna, i afrohet dhe po i thotë me zë të lartë:

"Pusho!"

Një pushim i shkurtër... Por një tjetër, dikush nga turma, me supe të rëna dhe ky, merret me rastin dhe po e tërheq me takt ndërprerësin e dialektikës së brishtë.

Lajmëtari i rrugës dredh zërin dhe i duket me vend ta përgëzojë me vështrim të riun, atë që po ndihmon të mos e ndërpresë vajin.

Çështja merr hov dhe e qara e e të urtit, shtrin kujen në shesh, aq sa valët e saj përmbytin rrugët me një frikë të madhe e të pacipë.

Po kush e njeh në këtë çast atë që flet?!

Atë nuk e njeh askush, as zërin e tij.

E sigurt është se në vjeshtën e tretë, ku vagullt del dielli, një zë i pagdhendur tendos kordat dhe del në shesh e inspekton njerëzit. E keqja dhe e liga do këngë dhe nota.

Kështu, që të mos lindin keqkuptime të tjera, njerëzit përreth dëgjojnë dhe dënesin njëherazi thagmën e tyre të vjetër.

Ka të ngjarë, që mes zërave ka ndonjë rastësi , regëtin ndonjë frymë e dëlirë që krijon portret zëri me dromca fati të mbarë.

Aty në kapërcyell të zverkut, ku lëshohen mornicat e ftohta ngjizet një zë, ndërplekset me këngën dhe buçet sa shemben skutat. Gjërat e liga e të këqija renditen. Nuk bishtnon asnjëra prej tyre, për të bindur veten më shumë se s'ka fund. Asgjë nuk ka lidhje të ngushtë me epërsinë, ajo është një shtjellë e ndritshme entuziazmi që ta ha kokën.

Në këtë jetë i lumtë atij që di të qajë e të krijojë një respekt të sikletshëm te ngushëlluesit e rastit.

Rehatohet e qan i qetë në një fron të thurur me shqopë të njomë. Qan në vetmi, larg syve, qan për fatin e tij të shkruar.

UNË E KALUARA DHE E ARDHMJA

poezi nga Dhimitër FUQI

UNË E KALUARA DHE E ARDHMJA

Sapo isha ndarë
nga hapësira e madhe,
për të qenë
me qenien time
e ardhmja pa kufi,
një pjesë e ekzistencës
së plotë.
Dhe bërtita
siç bërtasin
jo zakonisht
rëndomtë,
prejardhje e qelizës
dhe më e përparme
se ekzistenca,
se çdo lloj mendimi,
bëra zhurmë,
dhe hapësira u mbush
me flatra
trasparente dhe
jo të mira
pa simetri dhe
të lira.
Bëra zhurmë
siç gëlltit një
kupë helmi
në trupin e yndyrtë,
siç bën zemra e kumbuar
nga mijra trokëllima
të kristalta.
Ditë të numëruara
ditë të pazgjatshme...
Dhe ndjeva sa
unë ekzistoja.
Shpesh e trazoj dhimbjen
që më shkakton
gurra e kujtimeve.
Guralecë të ftohtë
dhe të papërmbajtshëm
më bëjnë që të flas
vetëm me "Ti".
Kisha rendur mes
parkut të hapur
pa andrralla
i bindur se aty
do t'i gjeja të gjitha,
edhe pasqyrën, rrethin dhe
këngën
dhe u gabova,
siç gabohen zakonisht
ata që s'gabojnë.
E ndjeva dhe vetëm
qukat e qiellit
më bënë shoqëri
për të vështruar
sa të gjeja arsyen time.
Aty njoha kufijtë e vetvetes.
Sërishmi u pashë
në ajrin e tejdukshëm
si në pasqyrë
ishte trashur loti
prej pikëllimit,
do të doja që edhe
zemra të ishte e rëndomtë,
siç do t'i caktoja
zonat e reve.

Gusht 1986.

GJUMI

E thurra dhe unë
dantellën e ëndrrave,
se dua që të puth
vlagën e vesës
në buzët e saj
të shijoj me majat
e mollzave
vezullimet lakuriqe
sinoret e sheshtë
të ndjenjave delikate
dua t'i mat trupit
sa pulse që ka.

Ajo,
bashkë me natën
më fshehin atë pasqyrë
të trëndafiltë,
të liqentë,
hënëzat m'i uli
siç fshihen algat
pellgjeve
dhe më fali vetëm
lakuriqësinë e misterit.

Gusht 1986.

KA DHE DIÇKA

Ashtu siç janë pasqyrat e rrjedhës
të fejuara dhe të dashura,
nuk mund të veçosh nga ato
një, dhe një të vetme për t'u krehur.
Të imagjinohesh ndërtues
shtresash transparente
si gëlbaza të stërholluara
do të të neveritet
naiviteti dhe thjeshtësia.
Nuk mund të ulesh pa flatra
në atë trung luleje të stisur
të remtë,
në atë erë të çmendur mullage.
Do të të urreja,
ashtu siç kam mësuar të të dua.
Të dua!
Pikë, hapësirë,
pjesë telefoni.

Gusht 1986.

E PËRDITSHMJA

Që një shelg me degë të njoma
hapësirës me sy të xhamtë
i buzëqesh,
që një flutur e vogël zvarritet
që një vajzë sy trëndafili
akullsinë e miklon përditë,
që unë me vëllain
ajrin e vështruam
plot zëra nervozë,
s'jam pesimist,
nuk mërzitem
që hapësira rrethore
ka ngjyrën e syve të tij,
do të isha i lumtur
që këtu të fundosej
çdo gjë.

Mos bërtit.
Tani nis e gjitha.
Ka rrjedhur e përditshmja.

Gusht 1986.

ASGJË NJERËZORE NUK ËSHTË E HUAJ

Nata,
e strukur
nën hijen e diellit,
e pafuqishme është
ndaj shkëlqimit
të pazakontë
të yjeve të vesës,
të pluhurosur nga bota
e shpejtë.

Ngazëllehem,
dhe luaj me topat e gazit
që më fal njerëzorja.

Zogu,
më i pafuqishmi
ndaj realitetit
struket i zbardhëllyer
nga e bukura.

Trupi i zbuluar
lakuriq i insektit
shkëlqen dhe sytë e njeriut
e kanë të vështirë
ta mohojnë realitetin
që insekti zvarritet plot jargë
për t'iu gëzuar hijes.

Mollzat e mia
fare mirë
mund të lenë një gjurmë.

Gusht 1986.

MREKULLIA E KRIJIMIT

Buzëqeshe,
dhe sërishmi shtratin e dëshirave
vendose,
në muzgun e trëndafiltë,
këmishën e dashurisë
qepe
me gjilpërat e gëzimit,
me gishtat e hollë
brumin e jetës e solle,
dhe më fale kaq lumturi.
Dy këngë të ngrohta,
të zjarrta
m'i zgjate
në atë kohë të pambarimtë
dh ndjeva që kufiri
ishte kaq i gjatë,
niste tek unë,
mbaronte tek ty!

1987.

KTHIMI I ËNDRRËS NË DALLËNDYSHE

1.
Ishte kaq e brishtë
sa toka me siguri
do ta thyente!
Nga dëshira për
të vërtetën tokësore
mbylli sytë
dhe po aq çiltër
jetoi me atë të madhen
ëndërr!

2.
Kur rikrijoi
vlerat e veta,
hapi sytë
piu një hurbë qiell
dhe po aq qetaz
mbaroi!

FESTA E KËRSHËNDELLAVE

Në fund të fundit
jo çdo rrugë të nxjerr
të parrugë
nis dhe mbaron
në fole milingonash,
të paktën!
Po diellin pse e kërkon
me ngut në qiell
kur ai brohoret
dhe në palcë të
lules?

GJITHË NATËN VERBËR

Gjithë natën verbër
dhe rrugës
ecja fare mirë!
Në mëngjes
pak ishte ngrohtë
dhe njerëzit më
thirrën Yll!

1988.

ME EMRA TË NDRYSHËM

I heshtur njëherë
plot zulm dhe erë
kur bëre tutje
i vërtetë,
si rrëmujë lufte
një fije bari pe në gurët
që s'lëvizin:
asnjë lule!

do të zgjohesh një natë
mbaje mend
dhe loti mbi prehër
ashtu do të bjerë
që ti papushim do
të nxehesh
me vetveten
me duart që do pleksen
me pyetjen
pse e gjitha kjo, përse,
dhe do të të qeshet
mbaje mend.

Lulet më nuk çelin
bari jo që jo
ti t'u shkosh nga afër
ato edhe nga
mosekzistenca
do të të thonë:
i penduari - vrasës!

Ti do vish si re
që tutje
ashtu me erë
e rrëmujë lufte
pa fjalë po munde
ta shprehësh
pendimin
ashtu si të lashtët
e kishi adhurimin
për lulet, për barin
për tokën dhe zogjtë
pa u skuqur
në fytyrë,
që vetes t'i them
melankolik,
si mëngjes i bruztë -
ti je!

1989.

NË SHTËPI S'DO JETË ASKUSH...

poezi nga BORIS PASTERNAK

Përktheu nga origjinali Agron TUFA

* * *

Shkurt. Të nxjerrësh bojë dhe të qash!
Shkurtin ta shkruash me ngashërimë,
Gjersa të rëndën llohë të trashë
Si serm të zi ta djegë kjo stinë.

Të marrç pajtonin. Për gjashtë grosh,
Nën jeh kambanash, vizgë rrotash,
Ku rreh rrebeshi të mëtosh
Më fort se boja dhe lotët.

Ku porsi dardhat shkrumbur pemësh,
Njëmijë mëllenja ngrihen qiejve
Tek turren dhe shkapetin pellgjesh
Trishtim të thatë në fund të syve.

Nxin toka mes borës së shkrirë,
Era – grirë në ulërimë,
Dhe sa më rastësisht, më mirë
Vargjet dalin - ngashërimë.

1912

NË SHTËPI S'DO JETË ASKUSH...

Në shtëpi s'do jetë askush
Përveç muzgjeve. E veteme
Dritë e dimërt dhomën mbush
prej të çarave të perdeve.

Veç të lagta, t'bardha fjolla
Pushatake frullojnë shpejt.
Veç çati, borë e, përpos
Çati, borë e asgjësend.

Dhë sërishmi shtrohet bryma,
Dhe sërishmi kaplon egër
Pikëllim' i tjetër dimri
Edhe breng' e dimrit tjetër.

Vjen dhe sot sërish më mbyt
Faji, si një komb në grykë,
Dhe dritaren trajtë-kryq
I drunjti thëllim e shtyp.

Vrapon perdesh me të katra
Drithma që të hyn në mish.
Heshtjen tek e mat me hapa,
Si e ardhmja ti do hysh.

Ti do shfaqesh në prag porte
Me të bardha, pa manierë,
Me diç drejt prej asaj cope,
Nga flokboret janë prerë.

1931

NDARJA

Ç›prej pragu po sheh një njeri -
pa njohur dot shtëpinë,
ikja e saj si arrati
ka lënë gjithkund rrënim.

Në dhoma kaos tejpërtej -
përmasë rrënimi therës.
S'e lënë lotët ta vërejë
dhe krizat e migrenës.

Mëngjesesh njëfarë zhurme kap.
Jermon a është në vete?
Dhe pse në trutë e tij prapë
mendja i bredh ndër dete?

Kur përmes brymës në dritare
as dritë e Zotit s'çan
brenga dyfish pa rrugëdalje
shkretisë në det i ngjan.

Aq e shtrenjtë ajo mbeti -
kontur i dashurisë,
si linjat e suvalës deti
përgjatë brigjeve ngjiz.

Sikundër kallamat përmbyt
fill pas suvalës dallga
iu krodhën thellë gjer në shpirt
kontur' i saj dhe trajta.

Në vite vuajtjesh, gjithkund -
jetë që s'ta rrok truri
një dallgë fati që përfund
atë drejt tij e shpuri.

Përmes pengesave pa prâ,
e shmangur prej çdo kurthi,
dallga e prû atë e prû
dhe krejtësisht i puqi.

Dhe tani ikja e saj, ja
përdhunshëm po i vjen:
ndarja të dy ata i ha
dhe kockat brenga bren.

Dhe tek sheh rrotull ky njeri -
ajo n'largim e sipër
gjithçka përmbysi leshelí
mbi komo e kanistër.

Ai përsillet dhe ndajnatë
i palton me dhéle,
copërat flakur gjith' inat
dhe mostrat për modele.

Dhe sesi shpohet pas qëndismash
me një gjilpërë ndërmes, -
i ngjallet ajo krejt papritmas
dhe heshtur zë dënes.

ËNDËRR

M'u shtir vjeshta me qelqet dritëpakë,
Ti me miq në hoka e kuvende,
Dhe si fajkua, që qiejsh gjuan gjak -
Zbriti zemra në pëllëmbën tënde.

Por kalon koha, tek plaket dhe tretet,
Serm të zi korniza shtron prej zorit,
Agu prej nga kopshti zbulon qelqet
Me lotët e përgjakur të shtatorit.

Por iku ajo kohë, u plak. Si akull
Mëndafsh' i kolltukëve u brejt anash
Dhe ty, zëri t'u bor e befas heshte,
U mek ëndrra ime si jeh kambanash.

U zgjova. Ag' i errët, si ditë vjeshte,
Dhe era merr në karro me gjithsej
Shiun ikanak prej fijesh kashte -
Kreshtat e mështeknave nëpër qiej.

1913-1928

* * *

Si një mangall i bronxtë me shpuzë
Kotet kopshti brumbujsh - plim.
Rrafsh me qiririn tim për buzë
Varen botërat në lulim.

Si në një fe të padëgjuar,
Këtë natë - matanë bie,
Ku plepi plak e i irnuar
Cakut të hënës i bën hije,

Ku si mister që hapet - gjoli,
Ku dallg' e mollëve lehtaz fshan,
Ku plintash varet pezull kopshti
Dhe para vetes qiellin mban.

1912

NATË DIMRI

Tufan, tufan kjo botë e zezë
në gjitha shtigjet
qiriri digjet në tryezë
qiriri digjet.

Mushkonjat siç roitin verës
në flakë flatrim,
flokëboret i sulen dritares
më me tërbim.

Tufani qelqet vesh krahnezë
rrathët, vijëzimet.
Qiriri digjet në tryezë,
qiriri digjet.

Në tavanin e përndritur
hijet janë shtruar,
kryquar këmbë: duarlidhur,
fat-kryqëzuar.

Dy këpucë me zhurmë ranë
për dyshemeje,
dhe lot' i dylltë rrodh mbi fustan
prej idareje.

Dhe fsheh gjithçka dëbor' e zezë
të bardhë e t'thinjur.
Qiriri digjet në tryezë
Qiriri digjet.

Dhe qoshja fryri mbi qiri;
flaka tundueshëm
si engjëll nxori flatra dy,
kryqëzueshëm.

Gjithë muajit shkurt - suferinë
në gjitha shtigjet.
Qiriri digjet në tryezë,
qiriri digjet.

1946

BIE BORË

Bie borë, bie borë.
Yj' të bardhë të ferfëllazës -
elbaroza pret në dorë -
tej parvazit të dritares.

Bie borë, gjithçka – përndezë,
gjithçka turret në flatrim: -
shkallinat e shkallës së zezë,
dhe kthesat në kryqëzim.

Bie borë, pa pushuar,
sikur bie jo flokë-flokë,
po mbi një mantel t'arrnuar
kup' e qiellt zbret në tokë.

Kryeshkallës,që nga sheshi,
me një pamje çatrafili,
tinës, si në kukafshehti,
zbret nga papafingo qielli.

Sepse jeta – gjatë nuk pret.
Kërshëndellat – vrik, një timtë.
Intervali – grimë e shpejtë:
Viti i Ri – beh sa hap sytë.

Bie dendur, mizëri.
N'ato gjurmë, në një hap,
me at' temp, at' përtaci
apo me at' shpejtësi,
Koha nget e ikën vrap?

Një nga një vitet, ndoshta,
shtrohen siç bie dëbora,
a si fjalët në poemë?
Bora bie, bie bora,

bie borë e trazon dhenë:
zbardhet shtegtari saora,
gand habi janë bimë e pemë,
kthesat kryqëzimesh flenë.

GUSHT

Siç premtoi, pa farë mashtrimi,
Kithtas, me një fashë shafrani
Dielli çau buzë agimi
Që nga perdet e tek divani.

Ai kaploi me okër të nxehtë
Pyllin fqinj, të fshatit shtëpiza,
Çarçafët e mi, nënkresën e lagur,
Dhe murin pas raftit me libra.

Befas kuptova, se përse vallë
Kish lagështi pak në nënkresë.
M'u shtir: po vinit në funeral
Njëri pas tjetrit, pyllit përmes.

Ju vinit sërë-sërë, në tek e çift,
Befas dikush tha, se bash sodit
Gjashtë gushti me të vjetrën ish'
Dita e Shndërrimit të Zotit.

Zakonisht një dritë e paflakë
Shkrep nga Tabori këtë ditë,
Dhe vjesht' e kthjellë, si bajrak,
Tek vetja na i përpin sytë.

Kaluat vërrishtën, imcakun pyll,
skamnor, cullak, të drithëruar -
Varret me prozhmin e kuq-xhenxhefil,
Të djegur, si kulaç i stampuar.

Me lartësitë e tij në fashë
E qiellit ngrihej madhështia,
Dhe me zërat e kaposhave
Jehonte zvargur largësia.

Si gjeometre qeveritare
Mes varresh vdekja sipas shartit,
Ma kqyr fytyrën vdekatare,
T'më mih' një varr në masë të shtatit.

I kapshëm prej gjithkujt, fizik,
Në zë i qetë aty mbërrini.
Zëri im që pata, profetik,
Pamort kumbonte prej rrënimi:

«Lamtumirë, e shndërrimit kaltërsi
O ar i Shpëtimit të dytë -
Me t'mbramen dhele femre ti
Zbutma brengën e orës së ligë.

Lamtumirë, vite të pakohë,
Mirëmbeç, hon i poshtërimit -
O grua që më vë në sprovë!
Jam fusha jote e luftimit.

Lamtumirë, të ndehura flatra,
Ngulmim krenar fluturimi, -
Imazh' i botës, shfaqur te fjala,
Dhe krijimi, dhe mrekullimi."

1953

HAMLETI

Zhurma rreshti. Unë dola në skenë.
Në shtalkë të derës mbështetur rri,
Nga jeh' i largët kap me parandjenjë
Çfarë në shekullin tim po bën vaki.

Më mësyn në shenjë muzgu i natës,
Me boshtin prej njëmijë dylbish.
Veç të ish e mundur, ave Atë,
Këtë kupë të ma hiqje sysh.

E dua trillin tënd mendjendamë,
Dhe pranoj ta luaj këtë rol.
Porse tash po luhet tjetër dramë,
Që këtë herë më la në stol.

I menduar krejt - rend' i lëvizjeve,
Dhe të rrugës fundin s'e kthej dot.
Vetëm. Gjithçka zhytet n'fariseizëm.
Jeta s'është një fushë lule-plot.

1946

ÇMIMI NOBEL

Si bisha në gjah unë humba.
Diku ka njerëz, dritë, vullnet.
Po pas meje - zhurm' e përndjekjes -
Dhe shpëtim për mua s'do ketë.
Pyll' i errët. I gjolit breg.
Bredhat - trarë të vithisur.
S'më kanë lënë kund shteg.
Le të bëhet ç'është kurdisur.
Ç›gjë të fajshme kam bërë vallë,
Qesh katil e bëra krime?
Botën krejt e bëra të qajë
Me bukuritë e tokës sime.
Por dhe kështu, buzë varrit,
Besoj, vjen koha më në fund -
Që forcën e ligë të gjakatarit
Frym' e mirësisë do ta mundë.

1958

SHËNIME:

Rreth poezisë «Gusht»

Vitet e fundit të Pasternakut, dihet, kanë qenë tepër të vështira. Ende para se të publikohej në Perëndim romani i tij «Doktor Zhivago» poeti e shkrimtari pati ndjerë darën e shtrëngimit të vazhdueshëm të pushtetit komunist. Kolegët e Lidhjes së Shkrimtarëve nuk ia falnin ndërhyrjen e tij tek Stalini për të shpëtuar nga pushkatimi burrin dhe djalin e Anna Ahmatovës e më vonë, ndërhyrjen e tij, edhe pse të papërfillur, për të shpëtuar jetën e Osip Mandelshtamit. Përjetimi dhe frika për fatin vetjak shpunë, që në vitin 1952 të pësonte infarkt. Duke ndjerë frymëmarrjen e afërt të vdekjes, ai filloi të ndërtonte raporte më të lehta me jetën e vet. Në vitin 1953 Pasternaku shkruan poezinë «Gusht», në të cilën aludon hapur për mundësinë e vdekjes së tij të afërt.

Poezia nis me përshkrimin e një agimi të zakonshëm fundvere. Heroi lirik zgjohet në shtratin e tij dhe zbulon befas, që jastëku është i lagur. Duke kërkuar arsyen, ai ndërmend një ëndërr të pazakontë e të qartë që ka parë ndaj të gdhirë. Autorit i shtiret vetë vdekja e vet dhe procesi i përcjelljes së funeralit. Ai ka parë një numër të madh miqsh, që morën pjesë në varrim.

Mandej vjen momenti kyç i poezisë dhe ëndrra e heroit lirik: një nga përcjellësit e tij në rrugëtimin e fundit ndërmend me vonesë, se pikërisht në atë ditë kisha ortodokse feston ditën e Shndërrimit të Zotit («gjashtë gushti me të vjetrën»). Në popull kjo festë kishte popullaritet të madh dhe quhej «Shpëtimi i mollëve». Konsiderohej si dita e bilanceve të krejt vitit, fillimi i vjeshtës dhe kohës së mbledhjes se bereqetit dhe frutave. Në këtë festë «drita del pa flakë ... nga mali Tabor» (mal në Izrael, në të cilin tre apostujt e zgjedhur u bënë dëshmitarë të Shndërrimit të Jezu Krishtit) dhe kjo dritë, sipas legjendës biblike, përhapet në gjithë lëmshin tokësor.

Pasternaku nuk frigohet për përndjekjet e mundshme para fytyrës së afërme të vdekjes, prandaj fut me guxim në poezi tematikën e ndaluar religjioze. Ai sheh «gjeometren qeveritare» — vdekjen, e cila ka kohë që e pret në varreza. Pjesa finale e poezisë është «zëri profetik» i poetit, i cili lamtumiroset me jetën tokësore. Heroit lirik nuk i vjen keq të ndahet me vlerat materiale.

Ai ua ka mësuar tashmë kotësinë. Poeti i jep lamtumirë «Kaltërsisë së shndërrimit», «viteve të pakohë», dhe më kryesores, – «krijimtarisë dhe mrekullisë». Ai ka kaluar një jetë të gjatë, të mbushur si me gëzime, ashtu dhe me «hone poshtërimi». Duke e braktisur këtë botë, atij ndjen keqardhjeje vetëm për faktin, se do të humbasë dhuntinë e tij të paçmuar hyjnore – mundësinë për të krijuar. Ëndrra profetike e Pasternakut u përmbush jo menjëherë. Poeti jetoi dhe shtatë vjet të tjera. Por këto qenë vitet më të vështira të jetës së tij. Njeriun e sëmurë rëndë nisën ta sulmojnë nga të gjitha anët; një perandori u lëshua në kryqëzatë të egër anateme propagandistike kundër tij, deri sa e detyruan të hiqte dorë, ta refuzonte çmimin Nobel, që kishte marrë më 1959 për romanin «Doktor Zhivago». E refuzoi që të mos pësonin familjarët e tij, dhe dihet që pezmin për këtë refuzim të detyruar e shprehu në poezinë "Çmimi Nobel".

Fakti më i hidhur (që e ligështoi jo pak), qe se i dolën kundër të gjithë miqtë e tij, gjithë Lidhja e Shkrimtarëve sovjetikë, të cilët e përjashtuan nga Lidhja dhe propozuan të arrestohet. Në njëfarë kuptimi këto trazime e dhanë efektin: brenda një viti poetit iu shfaqën dy metastaza në stomak dhe me 30 maj 1960 ndërroi jetë. Vdekjen ai e kundroi si një mundësi të pritur gjatë për t'i shpëtuar torturës dhe mundimeve.

Rreth poezisë «Hamleti»

Tragjedia e pavdekshme e Shekspirit «Hamleti» nuk e ka humbur aktualitetin e saj as në kohën tonë. Çështjet filozofike gjithënjerëzore të ngritura në të u kanë interesuar njerëzve të çdo epoke e të çdo kombësie. Pasternakut i takon një prej varianteve të përkthimeve më të qëlluara të kësaj tragjedie. Ai ka bërë një punë të madhe për analizën e saj dhe përkthimin e përpiktë të artit dhe mendimit të Shekspirit në rusisht. Prandaj dhe poezia «Hamleti» (1946) hap, jo rastësisht, pjesën poetike të romanit «Doktor Zhivago». Në figurën e Jurit, Pasternaku ka pasqyruar dyshimet torturuese hamletiane në zgjedhjen e rrugës së drejtë.

Në këtë poezi shfrytëzohen krahasime shumëshkallëshe. Para së gjithash, heroi lirik e krahason veten jo me personazhin e tragjedisë, po me aktorin, i cili duhet ta luajë këtë rol. Interpretimi i rolit të Hamletit konsiderohet në botën teatrore si një nga më të vështirët. Për një përcjellje të saktë të të gjithë plotmënisë së konfliktit shpirtëror të heroit kryesor aktori duhet të hyjë tekstualisht në lëkurën e Hamletit, që të mund të ndjejë tragjedinë e jetës së tij. Pasternaku riprodhon momentin e daljes së aktorit në skenë. Tek ai është përqendruar gjithë vëmendja e shikuesve në sallë përmes "njëmijë dylbive". Aktori gjendet në gjendjen më të lartë të fluturimit shpirtëror për shkak të rëndësisë së asaj që po ngjet.

Lind edhe një analogji tjetër. Heroi lirik krahasohet me Jezu Krishtin. Në akord me legjendën ungjillore, Krishti duhej të pinte kupën e hidhur, që do të thoshte pranim për të marrë mbi vete të gjitha mëkatet njerëzore dhe mundimet e ardhshme. «Duke ndjerë frikë në zemër», ai i kërkon Zotit t'ia heqë këtë kupë, por prapë gjen fuqi në vetvete dhe e pi këtë kupë të hidhur gjer në fund. Imazhi i kupës u bë mandej një metaforë rutinë gjatë përshkrimit të zgjedhjeve të vështira në jetë.

Në pjesën e dytë të poezisë, Pasternaku aludon hapur për shoqërinë totalitare sovjetike. Heroi lirik është dakord me interpretimin e rolit të Hamletit në skenë, por ai kupton njëkohësisht se po e njëjta tragjedi po ndodh dhe në jetën e tij. Është e kuptueshme që tragjedia merr fund gjithnjë, si zakonisht, përderisa të gjitha fjalët dhe veprimet e personazheve dihen që më parë. Por çfarë të bësh nëse jeta reale e njeriut të gjallë shndërrohet gjithsej veçse në një rol në interpretimin e dikujt në spektakël?

Finalja e poezisë është tejet pesimiste. Të gjithë personazhet e krahasuar (Krishti, Hamleti, Zhivago, aktori) përmblidhen të gjithë në fund në një: tek autori, i cili, i vetmuar, sheh se si gjithçka përreth tij "fundoset në fariseizëm" (çka përmbyll dhe përsiatjet mbi imazhin biblik). Jeta në shtetin totalitar është e privuar nga liria dhe kalon e gjitha nën drejtimin e «regjizorit kryesor». Tortura e zgjedhjes është veçse një lojë, prej saj asgjë nuk varet.

Mbi disa koncepte të filozofisë hegeliane të historisë

DY ZHVILLIME

nga Edion Petriti

Pjesa I

Nga dialektika hegeliane, si dhe nga metoda sintetike e Fichte-s kemi mësuar se na duhet një tezë e mirëmenduar dhe e kundërta e saj, të cilat ia nënshtrojmë kritikës, për të arritur në një të vërtetë më të lartë, ose në një sintezë. Na lind kështu një problem: a mund ta përsërisim pafundësisht këtë proces? Ky proces është i fundmë apo i pafundmë? Nëse procesi është i fundmë, arrijmë kështu në një sintezë të të gjitha ideve, në një ide absolute nga e cila rrjedhin gjithë idetë e tjera, që intelekti e krijon mbi gjithë objektet e njohjes dhe që ka natyrë hierarkike. Vetë hierarkia kuptohet si një lloj rregullimi i karakterizuar nga mënyra e ndarjes dhe ushtrimit të pushtetit prej një shumësie organesh të pajisura me funksione specifike, të nënvendosura ndaj njëra-tjetrës dhe me në krye një të epërm. Dhe vetë shoqëria hierarkike është e organizuar në një shumësi klasash shoqërore të nënshtruara ndaj njëra-tjetrës – diçka që sjell edhe pabarazi pasurie, privilegjesh, pushteti – brenda gjirit të bashkësisë njerëzore. Shembuj të sistemeve hierarkike përfshijnë mendimin e Kantit dhe Dekartit, Kanti e bazon sistemin e vet te *a priori* si themel i patundur; sipas tij gjërat njihen *a priori*. Ndërsa Dekarti ka për bazë të filozofisë së tij *cogito-n*. Pasi është i sigurt se ekziston, ai nis të shtjellojë mënyrën me të cilën ai di dhe njeh botën.

Nëse procesi është i pafundmë, atëherë gjithçka shndërrohet në një zinxhir shkak-pasojash ku ndryshimi sasior kthehet në një ndryshim cilësor që i jep skemës sonë një natyrë ciklike, të rikthimit të përjetshëm ku pasojat e së djeshmes shërbejnë si shkak i të sotmes – kuptojmë me këtë zhvillimin ciklik. Zhvillimi ciklik ka të bëjë me fenomenet ose serinë e fenomeneve që zhvillohen sipas një rendi të përcaktuar që më parë, që riprodhohen periodikisht. Ndër tiparet e ciklicitetit, mund të përmendim: *jolinearitetin, mungesën e supozimeve fillestare* dhe *vetëjustifikimin*. Mungesa e supozimeve fillestare do të thotë se sistemi është i vetëpërmbyllur; ai nuk presupozon një përshkrim të njohurive para se t'i vendosë ato thelbësisht. Ndërsa në një sistem hierarkik, sistemi varet nga baza e vet për justifikimin e ekzistencës, sistemet ciklike janë vetëjustifikuese pasi zhvillimi varet vetëm nga përparimi rrethor (progresioni cirkular). Në sistemet hierarkike, hasen pra parimet e linearitetit, pranisë së domosdoshme të supozimeve të vërteta fillestare dhe të justifikueshme.

P.sh. qarkullimi i elitave është rishpërndarja periodike e një shtrese të vendosur në majë të hierarkisë shoqërore. Kjo mund të bëhet me ose pa pjesëmarrjen e shtresave më të ulta. Nëse ajo ndodh me pjesëmarrjen e shtresave të ulta shoqërore, kemi të bëjmë me një *revolucion*. Pra, "revolucion quajmë qarkullimin e justifikuar të elitave me anë të shtresave më të ulta shoqërore".

Të dyja këto sisteme, ai ciklik dhe ai hierarkik, bashkëveprojnë e bashkërendojnë njëra-tjetrën, ku hera herës merr epërsi e mbizotëron njëri, e herë tjetri. Nga kjo analizë që bëjmë, mund të arrijmë në konkluzionin se sinteza e një teze dhe një antiteze jo domosdoshmërisht është një kompromis i të dyjave, por një ide e mëvetësishme, pozitive, origjinale në vetvete. Me pak fjalë, çfarëdolloj filozofie idealiste ka një natyrë hierarkike, ndërsa ateizmi është një rikthim i përjetshëm, absolut në vetvete. Pra, ne postulojmë dy lloj zhvillimesh historike: zhvillimin ciklik dhe atë hierarkik.

Sipas filozofit gjerman Walter Kaufmann:

Fichte futi në filozofinë gjermane trehapëshin e tezës, antitezës dhe sintezës, duke përdorur këto tri terma. Schellingu e mori dhe e përzgjodhi këtë terminologji. Hegeli nuk e bëri këtë. *Ai asnjëherë nuk i përdori këto tri terma së bashku për të përcaktuar tri faza në një diskutim ose shpjegim në ndonjë prej librave të veta. Dhe këto nuk na ndihmojnë të kuptojmë* Fenomenologjinë, Logjikën *e tij, ose filozofinë e tij të historisë; ato pengojnë çdo kuptim mendjehapur të asaj që ai bën, duke e detyruar të futet në një skemë që mund të ishte e përdorshme prej tij dhe të cilën ai qëllimisht e refuzoi.*[1]

Megjithatë, Hegeli përdori një model logjik me tri vlera – shumë të ngjashëm me modelin antitetik. Termat e përdorura prej Hegelit ishin: abstrakte-negative-konkrete. Vetë Hegeli e ka shpjeguar këtë terminologji: triada abstrakte-negative-konkrete përmban një shpjegim implicit të ceneve të termave kantiane. Teza e meriton antitezën thjesht sepse është tepër abstrakte. Ndërsa sinteza e përmbyll dhe plotëson triadën, duke e shndërruar në konkrete falë përthithjes së negatives.

Faktet ndodhin pavarësisht çdo iniciative individuale, ndaj dhe filozofia e historisë, e bazuar mbi faktet historike, duhet ta marrë parasysh këtë dimension pavarësie nga individualja. Duke e pasur ekzistencën e vet brenda realitetit objektiv, faktet janë një kompleks rastesh konkrete, të vërtetash të sigurta dhe të qarta; madje në filozofi ka që dallojnë mes *së vërtetës së faktit* dhe *së vërtetës së arsyes*, ndërsa të tjerë e shpallin këtë si identitet të idesë dhe faktit, pasi të njohësh është të bësh ose të ribësh idealisht atë që është objekt i njohjes. Faktet s'janë tjetër veçse veprime që duhen kuptuar në dritën e tërësisë prej nga kanë dalë.

Në këtë mënyrë mund të bëjmë edhe një ndarje mes së kaluarës edhe të tashmes; të parën jemi në gjendje ta perceptojmë të ndërmjetësuar prej burimeve historike, ndërsa të tashmen mund ta perceptojmë pa ndërmjetës. E ardhmja është ajo periudhë kohore që karakterizohet nga mungesa e ndërmjetësit, nga mungesa e burimeve historike. Perceptimi i së kaluarës është subjektiv, i varur nga vullneti i historishkruesit; nga kjo rrjedh që *filozofia e një historie të së ardhmes* nuk ekziston. Megjithatë, nuk do ishte absurde të flisnim për një *filozofi të së ardhmes*, pasi ligjet që rregullojnë të kaluarën dhe të tashmen, ligjësitë e shkakësisë (it. causalità, an. causality) dhe implikimet e saj rregullojnë domosdoshmërisht edhe të ardhmen. Hulumtimin historik dhe të kaluarën mund t'i krahasojmë me një thënie të ungjillit: "*Sepse tani shohim nëpër pasqyrë si në të errët, po atëherë do të shohim faqe më faqe; tashti njoh pak, po atëherë do të njoh sikundër u njoha*" (1 Kor 13:12). Ajo të cilën e shohim si nëpër një pasqyrë, si në të errët është e kaluara; të tashmen e shohim faqe më faqe; të ardhmen do ta njohim ashtu sikundër u njohëm në të shkuarën.

Sipas Battaglia-s, filozofia është "veprimtari njohëse që përpiqet të zbërthejë në sisteme koherente problemet themelore të ekzistencës dhe realitetit". Pra, vetë *filozofia e historisë* do të ishte "veprimtaria njohëse që tenton të zgjidhë në sisteme koherente problemet themelore të historisë". Në lidhje me historinë, mund të parafrazojmë po Battaglia-n:

Hulumtimi historik karakterizohet nga rregullat dhe natyra sistematike, dhe ka për synim konstatimin e vërtetësisë së *ngjarjeve* me anë të kërkimit, gjetjes, botimit dhe shqyrtimit të *burimeve historike*; ajo përzgjedh në bazë të njohjes së kuptimit dhe rëndësisë së tyre, për t'i interpretuar në mënyrë kritike. Synimi i këtij interpretimi është njohja dhe zbulimi i korrelacioneve dhe lidhjeve reciproke, me qëllimin për të nxjerrë në pah *unitetin logjik të zhvillimit historik* si më poshtë vijon:

- procesi i lindjes, ai i zhvillimit dhe përparimit si dhe procesi i dekadencës (konceptim hierarkik i historisë, shih *Carlyle*, *Spengler* dhe *Ortega y Gasset*, të cilët kritikojnë rolin e masave në histori);

- struktura ciklike, rikthimi i përjetshëm ashtu siç e kupton Giambattista Vico;

Bindja dhe synimi për ta interpretuar tërësinë e fakteve njerëzore si një kompleks koherent dhe organik i dha fill *filozofisë së historisë* si dhe *historisë pluraliste*, karakterizuar nga njohja e pluralitetit të formave të njohurive historike dhe nga varësia e saj ndaj materialit të disponueshëm dokumentar, dhe parimeve që drejtojnë përzgjedhjet historiografike. E thënë kjo, na duhet të bëjmë dallimin mes një *filozofie të brendshme* që buron nga vetë historia, dhe një *filozofie të jashtme* që përdoret për të kritikuar historiografinë, si dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjes a ka apo jo një rregullim providencial dhe udhëheqje hyjnore të rrjedhës së ngjarjeve historike; apo mbizotërimin e rastësisë. Ideale do ishte që vetë filozofia që buron nga brenda historisë, të përdorej për ta kritikuar historiografinë.

Në shekullin XX - ku shkojnë dorë për dore pozitivizmi, idealizmi, romantizmi dhe marksizmi - filozofët e kuptojnë botën dhe të tashmen nisur nga një interpretim i veçantë i asaj që ka ndodhur. Vjen e realizohet kështu leximi i së kaluarës me syzet e së tashmes, me qëllimin e qartë për të mbështetur vizionin dhe mendimin e vet. Për Jacob Burkhardt-in shteti, religjioni dhe kultura janë forcat që lëvizin historinë. Nga ana tjetër, Oskar Spengler kundërshton ndarjen në faza kulturore të historisë. Për Arnold Toynbee-në qytetërimet janë protagonistë të kohërave; nga ana tjetër Karl Jaspersi krijon konceptin e "epokës aksiale" dhe ringjall idenë e fillimit, dhe fundit të historisë.

Kuptimi i së kaluarës, luftërave, religjionit, politikës, artit dhe kulturës ka ndihmuar në strukturimin e epokave dhe dhënies kuptim të ekzistencës njerëzore.[2]

Një nga mënyrat që përdorim për t'i bërë një kritikë historisë, është *metoda analitike* - një metodë shkencore për të analizuar ngjarjet historike, burimet e këtyre ngjarjeve si dhe krahasimi, shqyrtimi i versioneve të ndryshme të ngjarjeve, dhënë nga historianët për të arritur në një ide të asaj që ka ndodhur në të vërtetë, për rindërtimin e së kaluarës.

Metoda analitike ka si synim:

- të kërkojë për tipare të përgjithshme në zhvillimin historik;

- t'i shqyrtojë këto tipare në brendi.

Ligji imperativ i determinizmit historik dhe kontingjenca (dispozitat për një ngjarje ose rrethanë të mundshme) e ligjeve të natyrës përsërisin të njëjtën gjë: lindjen, zhvillimin dhe shuarjen e gjithë sendeve.

Të qenit i vërtetë është karakteristikë e asaj që përputhet me realitetin – përputhjen e një fakti me një parim ose realitet objektiv; kjo e vërtetë është e tillë në kuptim absolut ose në lidhje me fakte të caktuara. Në këtë mënyrë, e vërteta ka ekzistencë efektive, që është diçka e vetishme e përvojës ndijesore.

Historia nuk mund të ndahet nga faktet dhe varet tërësisht nga realiteti; dhe kështu, filozofia e historisë, meqenëse është fryma ose ideja e historisë, duhet të deduktohet nga ngjarjet reale historike... ajo duhet të jetë emanacioni i pastër i së gjithë së tërës.[3]

Në lidhje me filozofinë e historisë, F. Kaufmann shquan tri rryma të mëdha: *teoritë historiografike dhe historiologjike* të Windelbandit, Rickertit, Simmelit dhe Troelsch-it; hulumtimet rreth *tipologjisë historike*, të Spenglerit, Max Weberit dhe Sprangerit; dhe në fund, *filozofinë vitale* (jetësore) të historisë dhe *ontologjinë historiologjike*, shënuar nga emrat e Diltheyit dhe Heideggerit.

Interpretimi i historisë është i pamundur brenda vetë suazave të saj, dhe interpretuesi i historisë gjithmonë fut diçka brenda nga vetja e vet. Siç ka thënë M. A. Bloch mbi Niçen: *faktet* në vetvete nuk janë tjetër veçse lënda e parë e historisë; ato kërkojnë pikërisht *interpretimin e fakteve*.[4]

E kaluara është thellësisht komplekse dhe e ardhmja është e paparashikueshme. Carl

1 Allan R. Buss, *A Dialectical Psychology*, 1979, fq. 78.

2 Pedro Rodríguez López, «Come fare storia ai tempi della Post-verità?» në: *Civiltà Cattolica*, 4102, 15 mag/5 giu 2021, anno 172, p. 337-8.

3 Friedrich von Schlegel, *The Philosophy of History: In a Course of Lectures Delivered at Vienna*, Londër, 1852, fq. 65.

4 *Gregorianum. Commentarii de re theologica et philosophica editi a proffessoribus Pontificae Universitatis Gregorianae*, XXXV, 1954, Bruxelles-Roma, 1965, f. 269.

Hempel shkruan diku se edhe shpjegimet e vlefshme historike duhet të thërrasin në ndihmë ligjet e përgjithshme. Duhet të bëjmë pra dallimin mes ligjeve të zhvillimit historik dhe ligjeve historiografike.

Sipas Hegelit, qëllimi ose synimi i Frymës është liria. Në mënyrë që të jetë me të vërtetë e lirë, kjo liri ka nevojë të shprehet dhe të pasqyrohet. Që të jetë me të vërtetë e lirë, kjo liri ka nevojë për një shumësi zgjedhjesh nga të cilat të zgjedhë. Megjithatë, sipas Hegelit, kuptimi i plotë i lirisë mund të zbulohet vetëm gradualisht, në mënyrë progresive.

Historia është procesi me anë të të cilit fryma zbulon vetveten dhe konceptin e vet (Hegeli).

Liria aktualizohet sipas një procesi të mëposhtëm: asaj i vihen përpara zgjedhjet 1, 2, 3 etc., nga të cilat është e lirë të zgjedhë ose jo. Në çastin që ajo zgjedh p.sh. zgjedhjen 1, i paraqiten alternativa të tjera: a, b, c etc. Pasi zgjedh zgjedhjen a, asaj i paraqiten alternativat A, B, C, etj. Shohim të shpaloset kështu një hierarki e aktualizimit në kohë të lirisë, procesi i zgjedhjes së lirë, që është liria absolute për të zgjedhur.

Ndërsa një lexues kantian mund të thotë se ky proces është i pafundmë, lexuesi hegelian mund të thotë se një proces i lirisë përherë e në rritje është tashmë në një kuptim dinamik, *aktualiteti* i plotë i lirisë. Aktualiteti ka lidhje me diçka që ndodh në momentin e tanishëm, që ende ndihet si diçka e gjallë, edhe pse i përket së kaluarës. Aktualja është në veprim, reale, efektive – e kundërta e potenciales, së mundshmes, së zakonshmes.

Hegeli pohon unitetin e faktit historik dhe idesë – ata nuk mund të jenë të pandarë e të dallueshëm. Fakti dhe ideja janë të njënjëshme; nëse nuk do të ishte kështu, nuk do mund të përpunohej një filozofi e historisë. Për t'u marrë filozofikisht me historinë, duhet të kuptojmë se kjo e fundit është thjesht realiteti që ka ngjarë, ndërsa filozofia merret me mendimin e pastër. Për Hegelin, kjo disiplinë ka për detyrë të kërkojë qëllimin përfundimtar, universal të historisë. Historia vihet në lëvizje nga arsyeja dhe gjithçka rregullohet nga dora e padukshme e racionalitetit historik. D'Hondt shkruan: "Sipas Hegelit, arsyeja qeveris botën".[5] Hegeli vazhdon:

Fryma është e lirë; dhe qëllimi i frymës së botës në historinë botërore është të realizojë thelbin, esencën e vet dhe të sigurojë prerogativën e lirisë. Veprimtaria e saj është të njohë dhe të identifikojë vetveten, por ajo e arrin këtë në faza graduale dhe jo në një hap të vetëm... fryma e botës përparon nga determinimet më të ulta te parimet dhe konceptet më të larta të natyrës së vet, te shprehjet më plotësisht të zhvilluara të Idesë së saj.

Çështja në fjalë pra është fundi përfundimtar i njerëzimit, fundi në të cilin fryma e vendos veten në botë.[6]

Pra, sipas Hegelit, fryma – kjo substancë e thjeshtë, e padukshme, jomateriale dhe e përjetshme që e shtrin veprimin në gjithë universin, që është universale në zhvillimin dhe qëllimin e saj – është e lirë. Duke qenë e lirë, kjo aftësi për vetëpërcaktim, e bën të jetë shkak i veprimeve të veta – mund të zgjedhë mes dy ose më shumë zgjedhjesh, mes dy veprimesh ose mosveprimesh dhe është e pajisur me vullnet të lirë, me intelekt. Në këtë mënyrë, fryma është absolutisht e lirë, duke pasur një epistemologji ciklike. Liria e saj mund të kuptohet vetëm në këtë mënyrë. Duke qenë parim aktiv, veprimet e saj shkaktojnë domosdoshmërisht ngjarje historike.

(vazhdon)

5 (Maria Cuppari, *Il filosofo e la contraddizione. La filosofia della storia di Hegel nella cultura tedesca*, 2019, p. 12).
6 (G.W.F. Hegel, *Lectures on the Philosophy of History. Introduction: Reason in History,* Cambridge, 1975, p. 63).

Refleksion pas përkthimit të librit "MBI KOHËN DHE UJIN" të autorit islandez Andri Snaer Magnason, i sapodalë nga shtypi, i Shtëpisë botuese "OMBRA GVG"

MBI EKOCIDIN DHE SHPËRFILLJEN

Nga Elvi Proko

Në datat 30 dhe 31 tetor të këtij viti, u mbajt në Romë Samiti i G20 me pjesëmarrës krerët e shteteve anëtare, të shteteve të ftuar, si dhe të presidentëve të Komisionit Europian dhe të Këshillit Europian për BE-në.

Temat kryesore mbi të cilat u zhvilluan punimet ishin emergjenca sanitare e COVID-19, kriza klimatike dhe rikuperimi global pas-pandemisë. Viti që lamë pas, gjurmët e të cilit janë vulosur rrënjësisht në jetët tona, ka qenë një prej periudhave më të vështira e të dhimbshme të njerëzimit, e për të do të rezervohet një vend i veçantë në radhët e librave të historisë. Për më tepër, më shumë se kurrë janë shfaqur fenomene e katastrofa natyrore si tërmete, përmbytje e zjarre.

Të jetë vallë një paralajmërim, se diku kemi gabuar?

Një temë, të cilën ndoshta tani e kemi perceptuar më qartë, e që Andri Snaer Magnason, poet, dramaturg e aktivist politik mbi temat mjedisore, e kish konceptuar prej kohësh me largpamësi. Ai është një shkrimtar i përkthyer në shumë gjuhë të botës, si dhe fitues i mjaft çmimeve letrare, por aktualiteti i librit të tij të fundit, i cili tashmë është botuar edhe në shqip, ka pasur një jehonë të fortë së fundmi. Këtë libër ai ua ka kushtuar fëmijëve të tij, si dhe brezave që do të vijnë.

"Dymbëdhjetë miliardë tonët e naftës, gazit e karbonit që djegim çdo vit arrijnë në më shumë se tridhjetegjashtë tonë CO_2. Nën këto ritme, temperaturat do të rriten me 1.5 gradë, gjë që do të sjellë pasoja katastrofike për planetin tonë." Një konstatim, i cili, i thënë shqip, "as të ngroh, as të ftoh". Shkencëtarë të ndryshëm në të gjithë botën kryejnë në mënyrë sistematike studime dhe publikojnë raporte mbi ndotjen atmosferike, acidifikimin e oqeaneve, shkrirjen e akullnajave, shpyllëzimin, apo zhdukjen e specieve, madje organizohen edhe mbledhje të jashtëzakonshme prej Kombeve të Bashkuara në lidhje me këto çështje. Përpos faktit se, shifra të tilla shkojnë përtej botëkuptimit të një njeriu të zakontë, i cili nuk është ekspert i fushës, koto kalkulime shkencore shkojnë përtej perceptimit dhe kontekstit tonë kohor dhe hapësinor.

Andri S. Magnason ka marrë përsipër një mision të veçantë. I vetëdijshëm për mungesën thuajse të plotë të impaktit të këtyre studimeve mbi masat e gjera, ai vendos t'i rrëfejë ato, por kësaj radhe ai nuk e bën këtë thjesht duke publikuar shifra, të cilat kushdo do t'i shpërfillte, por duke rrëfyer histori. Histori vetjake, histori të familjes, histori të miqve, vendit të vet e natyrës. Për më tepër, i shoqëron ato me fotografi personale, për të bindur akoma më shumë publikun se është duke rrëfyer me zemër të hapur. Magnasoni e di mirë se, rrëfimi është mënyra e vetme për të hapur një tunel në koracën prej betoni të injorancës, e për të krijuar një urë drejt mendjes inerte e të pandërgjegjësuar. Me shembuj konkretë ai bën të kuptojë lexuesin se, "Jemi sjellë sikur atmosfera të mund të përthithë në pafundësi derdhjet e lëndëve në të, sikur deti të mund të gëlltiste të gjithë mbetjet tona, sikur toka të prodhonte përgjithnjë falë sasive gjithmonë e në rritje të fertilizuesve, sikur kafshët të zhvendoseshin pak më tutje, sa herë që njerëzit zaptonin hapësira të reja." Pena e shkrimtarit përshkruan me dhembje jo vetëm shndërrimin negativ, apo më mirë të themi shpërfytyrimin, që po pëson planeti ynë, i cili gjendet veç një hap larg katastrofës ekologjike, por gjithashtu shndërrimin negativ që ka pësuar shoqëria moderne, një makineri konsumiste, e cila shqetësohet më shumë për zhvillimin material, se sa për atë shpirtëror. Ndër të tjera, ai sjell fakte tronditëse mbi shpërdorimin, të cilat të bëjnë vërtet të reflektosh. Për të rreshtuar disa shembuj, "... në Kinë më 2018-ën gjendeshin 50 milionë apartamente bosh", "... 30% e ushqimeve të prodhuara në botë flaken", "Me anë të territoreve blegtorale që kultivohen aktualisht, mund të ushqejmë katër miliardë njerëz më shumë."

Sigurisht, ky libër nuk duhet konceptuar si një shkrim fatalist mbi fundin e botës, por si një thirrje plot shpresë për ndërgjegjësim, mbi ndryshimin që mund të sjellë në shkallë globale edhe një individ i vetëm me kontributin e tij vetjak, p.sh. duke parapëlqyer të lajë ndonjë pjatë më shumë, në vend që të përdorë pjata plastike, apo të shuajë një llambë të cilën nuk i nevojitet, në vend që ta lërë të ndezur së koti.

Me anë të një rrëfimi të thjeshtë e të këndshëm, pa dorashka, Magnasoni na bën të kuptojmë se duhet ta duam e të përkujdesemi për planetin tonë, pasi shtëpia nuk gjendet vetëm brenda katër mureve, apo kufijve shtetërorë, por në të shkuarën, të tashmen e të ardhmen e planetit ku jetojmë, e ku do të jetojnë edhe fëmijët e nipërit tanë. Çdo vepër e jona do të jetë trashëgimia që do u lëmë brezave që do të vijnë.

Ky libër, mund të konsiderohet si një manual civilizimi, ku me civilizim nuk nënkuptohet përparimi shkencor në kurriz të gjallesave të tjera të planetit ku jetojmë, por përparimi shkencor e shpirtëror në harmoni me to.

Jam shpresëplotë se, në një shoqëri që ka tepër nevojë për leksione qytetarie e humanizmi, siç është shoqëria shqiptare, ky libër do të përcjellë një mesazh të vlefshëm.

KAFKA: NJË FUND APO NJË FILLIM?

nga Morten Hoi Jensen

Sa çudi të kthehemi te Kafka. Duhen vetëm disa faqe që të gjitha paragjykimet tona rreth letërsisë të nisin lundrimin. Mjetet e vjetra – karakteri, komploti, stili – janë të padobishëm për ne; ato vëllime gjigante të teorisë mund të mërgojnë përsëri në raftet e poshtëm; do të ishte më mirë të kontrollohej ridrejtimi ndaj frojdianizmit. Asnjë prej tyre nuk do të na drejtonte në këtë udhë. Eric Heller njëherë shkroi për "gjendjen patetike të kritikëve përballë romaneve të Kafkës". Sa për të ardhur keq! E gjithë vepra e Kafkës është një sulm ndaj interpretimit, ndaj kuptimit; është përgënjeshtrimi më i frikshëm në historinë e letërsisë ndaj pyetjes së pavdekshme, por të gabuar "Çfarë ka dashur autori të thotë me këtë tekst?"

E megjithatë, për ironi, pak autorë janë aq sipërfaqësor në krahasim me ngarkesën kuptimore të Kafkës. Në shekullin e prezantimit të veprës së tij për herë të parë, ai ka qenë i ngujuar nën një bollëk tendash interpretimesh: judaizmi, kristianizmi, psikoanaliza, holokausti, komunizmi, simbolizmi, ekzistencializmi – zgjidheni vet. Ai është profeti i mizorisë së shekullit XX; një aktor në kallëpin e Buster Keaton; korrës i zymtë i modernitetit post-fetar. Ose ka themeluar një zhanër të ri, ose ka shpërbërë çdo zhanër. Dukej sikur edhe vetë Kafka ishte realist mbi veten: "Unë jam fundi ose fillimi", shkruante diku.

Erich Heller, i cili, ashtu si Kafka, ka gradën doktor në drejtësi nga Universiteti Gjerman i Pragës, përbën një rast të fortë për paradoksin qëndror të shkrimit të Kafkës në esenë e tij kanonike mbi Kështjellën (përmbledhur në *The Disingerited Mind*, 1952). Ai na jep skicën bazë të komplotit të romanit: një i panjohur i njohur si K. mbërrin në një fshat duke besuar se është emëruar mbikqyrës territori prej autoriteteve (fshati udhëhiqet prej kështjellës). Kontakti i pakët që ka K. me autoritetet – dy ndihmësit që i janë caktuar, letrat që merr, telefonatat që i ridëgjon – duket sikur e konfirmojnë emërimin. Por K. nuk është kurrë i bindur dhe sidomos në kohën kur lajmërohet nga kryebashkiaku, "Ti sillesh si mbikqyrës territori, siç thua dhe vetë, por, fatkeqësisht, ne nuk kemi nevojë për një të tillë". Dhe kështu K. nis të shpenzojë të shumtën e kohës së romanit duke kërkuar konfirmimin e emërimit të tij nga autoritetet e paarritshme të kështjellës. Heller shtjellon:

Besimi i K.-së shfaqet, që në fillim, të bazohet në të vërtetën dhe iluzionin. Është një arritje e pabesueshme e Kafkës që të detyrojë, në mos të frikësojë, lexuesin në pranimin e padiskutueshëm të këtij paradoksi, të paraqitur me realizëm të pamëshirshëm dhe logjikë të parezistueshme. E vërteta dhe iluzioni janë të përziera në besimin qëndror të K.-së në një mënyrë të tillë që ai është i privuar nga çdo rregull i realitetit. E vërteta është gjithmonë në pikën e heqjes së maskës dhe zbulimit të vetvetes si iluzion, iluzion në rrezik të vazhdueshëm për t'u verifikuar si e vërtetë. Është gjendja e vështirë e një njeriu, i cili, i pajisur me një oreks të pangopur për siguri transhendentale, e gjen veten në një botë të grabitur nga të gjitha pasuritë shpirtërore. Kështu ai është kapur në një rreth vicioz. Ai nuk mund ta pranojë botën – fshatin – pa arritur më parë sigurinë absolute dhe ai nuk mund të jetë i sigurt pa pranuar më parë botën. Megjithatë, çdo kontakt me botën e bën talljen e kërkimit të tij dhe vazhdimi i kërkimit kthehet në barrë të thjeshtë.

A nuk është gjendja jonë e vështirë si lexues të Kafkës, analoge me atë të K.? A nuk jemi të trembur nga pranimi i padiskutueshëm i një paradoksi që na paraqitet me realizëm të pamëshirshëm dhe logjikë të parezistueshme? Konsiderojeni "Një mesazh nga Perandori". Një perandor në prag të vdekjes dërgon prej shtratit të tij një mesazh të destinuar vetëm e vetëm për ty – ty, "subjektit të tij të mjerë". Por ky mesazh nuk do të të gjejë kurrë. Postierit i duhet të penetrojë portat e pafundme dhe paradhomat e pallatit të shenjtë, pa përmendur shkallët dhe oborret, apo edhe një pallat të dytë apo të tretë. Në fund, gjendet një kryeqytet, i mbushur përplot, ku askush nuk mund të depërtojë. "Ti, gjithsesi, ulesh në dritaren tënde dhe ëndërron për mesazhin teksa vjen pasditja".

Figura e largët dhe e munguar e autoritetit, ngarkesat e pafundme burokratike, kotësia e shpresës – "Një mesazh nga Perandori", thuajse si simotra "Përpara Ligjit", ngjesh në pak faqe shenjat më të njohura të atij termi të frikshëm dhe të holluar, Kafkiane – përdorur në mënyrë të vazhdueshme për të përshkruar edhe shqetësimet më të parëndësishme, si të lidhesh me Verizon[1]. Fatmirësisht, termit kohët e fundit i është dhënë një jetë e re prej Reiner Stach (vëllimi i tij i tretë dhe i fundit mbi jetën e Kafkës u botua nga *Princeton University Press*); ai e identifikon në mënyrë të dobishme si "formë të veçantë të retorikës, e cila errëson situatën me saktësi analitike".

Përzgjedhja e re dhe e shkëlqyer e tregimeve të Kafkës nga përkthyesi Peter Wortsman, *Konundrum: Selected Prose of Franz Kafka* (botuar prej *Archipelago Books*), sjell retorikën e veçantë të autorit në jetën e lavdishme. Na kujton se këmaqësia është një element qëndror në reagimin tonë ndaj punës së tij – për përzierjen e saj ndaj së vërtetës dhe iluzionit, për marrëdhënien midis një situate të jashtëzakonshme dhe "precizionit analitik" me të cilin përshkruhet. Ashtu si me përkthimet e tjetra moderne të Kafkës, në veçanti të Michael Hofmann, këtu na jepet një Kafkë më pak i zymtë se alegoristi fetar dhe ekzistencial i dikurshëm. I përfshirë në *Konundrum*, përshembull, është rrëfimi i zhurmshëm i Kafkës, nga një letër drejtuar Felice Bauer, për përpjekjen e tij që të mos shpërthente në të qeshura gjatë "takimit solemn" me drejtorin e Institutit të Sigurimit të Punëtorëve prej Aksidenteve, ku Kafka ishte i punësuar për një dekadë. Duke qëndruar së bashku me një koleg përballë tavolinës kaq shumë të ngjashme me atë të një perandori të drejtorit, Kafka lufton me dëshpërim për ta mbajtur si një masë. Asgjë nuk është aq qesharake sa e qeshura në një situatë që nuk e kërkon atë:

Kur ai dha përgjigjen e tij, po në atë mënyrën e zakonshme, tepër të njohur, tipike skematike perandorake, krejtësisht të pakuptimtë, shoqëruar me sëmbime të rënda në gjoks, ndërsa kolegu im hodhi vështrime anash, qëllimi i të cilëve ishte të më paralajmëronte të kontrolloja veten, megjithëse tashmë isha sforcuar mjaftueshëm për ta bërë këtë, efekti i të cilit ishte më tepër të sillte gjallërisht në mendje këmaqësinë e atë të qeshurën e hershme, nuk munda ta kontrolloja më veten dhe humba çdo shpresë se do të mund ta bëja ndonjëherë.

Këtu kujtohet gjithashtu se Kafka është çdo gjë tjetër veçse një shkrimtar i errët dhe i padepërtueshëm. Mendoj se ai është modernist, por nuk mund të dini asgjë për Joyce, Pound dhe Eliot dhe ende të këmaqeni me botën e formuar në mënyrë të përsosur dhe ftuese të çuditshme të trillimeve të tij. Kur lexova për herë të parë "Metamorfozën" në moshën 15 vjeçare, pa ditur asgjë rreth Kafkës apo modernizmit apo letërsisë në përgjithësi (nuk mund të më paguaje që të lexoja një libër asokohe), ndjeva se ose sapo kisha lexuar historinë më shqetësuese të shkruar ndonjëherë, ose kisha qenë shtylla e një shakaje masive. Ndoshta ky është pikërisht reagimi që një histori e Kafkës duhet të shkaktojë te lexuesi.

Kafka, ndërkohë, mund të lexohet më së miri në pavetëdije. Shumë shpesh, të interpretosh punën e tij është si të prishësh një shaka të mirë duke shpjeguar vijën e grushtit. Duhet të kujtojmë se kur ai u lexoi për herë të parë Procesin miqve të tij, ata u shkrinë gazit; po në të njëjtin roman Jozef K. mendon për vete: "nëse kjo do të kishte qenë komedi, ai do të kishte këmbëngulur ta luante deri në fund"; dhe se Kafka i tha mikut të tij Max Brod, se "ka shpresë, por jo për ne" me një buzëqeshje djallëzore në fytyrë.

Romani i tij është si një komedi përmasash dhe mospërputhjesh. Tek *Metamorfoza* (që në mënyrë të pamatur metamorfizohet në "Shndërrimi" tek përkthimi i Wortsman), shqetësimi i parë i Gregor Samsa-s pasi u zgjua dhe gjen veten të shndërruar në brumbull, nuk është ndryshimi i tij i pashpjegueshëm, por çështja kaq e parëndësishme e punës: "Zot i Madh', mendonte me vete, 'ç'profesion rraskapitës kam zgjedhur! Duke udhëtuar çdo ditë." Ai gjendet shtrirë mbi guaskë, këmbët e tij të shumta lëvizin dhe shqetësimi i tij kryesor është linja e trenit dhe ushqimet e këqija që karakterizojnë profesionin e tij.

Ose marrim "*Artisti i uritur*". Meqenëse askush nuk mund të ulet në netët e shumta të shfaqjeve të artistit të adhuruar të urisë, i vetmi që mund ta kuptojë vërtetë madhështinë e tij është vetë artisti: "vetëm ai mund të vepronte njëkohësisht si spektator i pagabueshëm, plotësisht i kënaqur me përsosmërinë e shfaqjes". Por artisti mendon se uria është e thjeshtë (një arrogancë për të cilën hera-herës dyshohet se është mashtrues) dhe dëshiron t'i lejohet të vazhdojë urinë përtej kufirit 40 ditor të përcaktuar nga drejtuesit. Ai shkel kontratën dhe i bashkohet një cirku, ku i lejohet të jetë i uritur në qejf të tij. megjithatë, në mënyrë të pashmangshme, njerëzit humbasin interesin. Pa askënd – madje as vetë artistin e uritur – për të mbajtur shënim ditët, ai përfundimisht vdes nga uria, i lënë pas dore dhe i harruar. Pak para se të vdiste, mbikëqyrësi i artistit e pyet pse ndihej i detyruar të shkonte pas urisë. Përgjigja e tij absurde? "Sepse nuk kam gjetur ende një ushqim që të më pëlqejë". Estradë e pastër.

Kafka e bën të pashpjegueshmen dhe absurdin tejet qesharak. Shndërrime të papritura, arrestime arbitrare, mesazhe të mbërthyera në tranzit – ne qeshim me to, por e qeshura jonë nuk është aspak e pavlerë; është e qeshura e rraskapitjes, e mosbesimit, një përpjekje e fundit për të hequr diçka nga një kozmos i heshur dhe i padepërtueshëm. "Ju jeni marrë si mbikqyrës territori", K. është njoftuar në Kështjellë, "por për fat të keq, ne nuk kemi nevojë për një të tillë". Nuk ofrohet asnjë shpjegim tjetër; në të vërtetë, kërkimi kokëfortë i K. për një shpjegim është zhbërja e tij. Është si John Cleese i Monty Python që pyet furnitorin e një dyqani djathi nëse ka vërtet djathë. Pasi kërkon çdo lloj djathi të mundshëm vetëm për t'u thënë se kanë mbaruar të gjithë, ai më në fund pyet: "Ju keni vërtet djathë, apo jo?" Për të cilën furnitori i buzëqeshur përgjigjet në mënyrë të pakundërshtueshme: "Sigurisht, zotëri. Është dyqan djathi, zotëri."

Sepse tragjedia fshihet gjithmonë apo edhe mohohet në shkrimet e Kafkës (është gjithmonë tepër vonë, siç tha Michael Hofmann për "kohën e Kafkës", por më e keqja nuk ka ndodhur ende) ka diçka të përhershme në komedinë e Kafkës. Duket se lëkundemi mes të qeshurës dhe dëshpërimit – madje, ka raste kur i ngatërrojmë. Kjo është një komedi që, siç theksoi dikur David Foster Wallace, ka pak të përbashkëta me idenë bashkëkohore të të qeshurit si argëtim dhe siguri, pikërisht sepse i reziston mbylljes dhe rehatisë. Kafka këtu tingëllon hera-herës si Kierkegardi, për të cilin flet në ditarët e tij si "në të njëjtën anë të botës" si ai – veçanërisht Kierkegardi që pyeti: "Po sikur çdo gjë në botë të ishte një keqkuptim, po sikur e qeshura të ishte vërtet lot?"

"E qeshura ime është mur betoni", i thotë Kafka admiruesit të tij Gustav Janouch. "Kundër kujt?" e pyet ai. "Normalisht, kundër vetes," përgjigjet Kafka:

Një goditje ndaj botës është gjithmonë një goditje ndaj vetvetes. Për këtë arsye, çdo mur betoni është thjesht një iluzion, i cili herët a vonë shembet. Sepse e brendshmja dhe e jashtmja i përkasin njëra-tjetrës. Të ndara, ato bëhen dy aspekte hutuese të një misteri që durojmë, por nuk mund ta zgjidhim kurrë.

Tregimet e Kafkës janë "bashkëkohëse dhe mund të vendosen kudo dhe askund", na thotë Wortsman, por autori i tyre, e pavend të thuhet, ka jetuar jo "kudo dhe askund", por më tepër në një vend dhe kohë të caktuar. Dhe bota ku ai banoi – zyra e sigurimeve, apartamenti mbushur përplot me njerëz, qyteti shumëgjuhësh në perandorinë në rënie – e formësoi dhe e brumosi disi. Librat e fundit nga Reiner Stach dhe historianit Saul Friedländer janë përpjekur të humanizojnë Kafkën, si për ta nxjerrë atë disi nga muri

1 Konsulent online

iluziv i betonit. "Bota e pabesueshme" që Kafka kishte brenda kokës së tij përputhej me një botë jo më pak magjepsëse rreth tij – një fakt që ai dhe shumë kritikë të tij herë pas here e harrojnë.

Megjithatë, nëse si unë, ju jeni të kujdesshëm për t'u thelluar në një rrëfim me tre vëllime të jetës së një avokati sigurimesh asket dhe vetëflijues, Stach me një rrufe të pashpjegueshme frymëzimi e ka plotësuar ndërmjarrjen e tij të madhe me një vëllim të veçantë elementësh biografikë, të cilët ai i quan në mënyrë sugjeruese "kundër imazhe", me titull *A është ai Kafka? 99 gjetje*. Botuar për herë të parë në gjermanisht në 2012 dhe përkthyer nga Kurt Beals në 2016, është një koleksion zbulimesh të vogla, duke filluar nga fotografitë dhe shkrimet origjinale, te kartolinat dhe anekdotat e rastësishme. Kjo mënyrë anësore e shikimit të Kafkës është në mënyrë unike shpërblyese, duke iu shmangur parimeve organizative dhe narrative të biografisë, ashtu si vetë Kafka aq shpesh i shmangej parimeve organizative dhe narrative të fiksionit.

Në parathënien e tij, Stach na thotë se pavarësisht nga kërkimet, studimet dhe gërmimet biografike thuajse shekullore, imazhi popullor i Kafkës si një neurotik i pabotshëm – "një njeri i çuditshëm që sjell gjëra të çuditshme" – ka rezoltuar kokëfortësisht jo fleksibël. Ndaj ai kornizon *A është ai Kafka?* si një përpjekje për të "destabilizuar këtë pikëpamje: "Këtu ndjenja e Kafkës për komiken luan një rol të spikatur dhe paradigmatik," shkruan ai. "Humori i tij nuk është gjithmonë i fshehtë, siç mund të pritet nga tekstet e tij të padepërtueshme: ai mund të jetë naiv dhe i çuditshëm, duke zbuluar kënaqësinë e tij në lojërat e fjalëve dhe rreshtat e grushtave, në një mashtrim të aftë të motiveve, ndërrimeve të këndëvështrimit dhe skenarëve të frymëzuar".

Pothuajse çdo kundërimazh i Kafkës arrin të jetë befasues ose i çuditshëm (ose të dyja). Këtu ai i nënshtrohet regjimit të përshtatshmërisë së gurusë danez Jørgen Müller, aty ai flet për birrat e tij të preferuara; *këtu ai është në një udhëtim pune në Boheminë Veriore, duke u shndërruar në teoritë e "mjekësisë natyrore" të Moriz Schnitzler, dhe ja ku po lexon në një librari në Mynih dhe i shkakton të fikëtin një gruaje.*

Më e mira e të gjithave, ndoshta, është letra e dërguar Kafkës nga njëfarë doktor Segfried Wolff, e cila nis me fjalët: "I nderuar zotëri, ju nuk më bëni aspak të lumtur". Dr. Wolff nis të shpjegojë se ai bleu "Metamorfozën" për të kushërirën, dhe gjithçka mori në këmbim ishin ankesat e saj se s'mund t'i gjente kuptimin. Edhe e ëma e kësaj kushërire u hutua nga libri dhe ia kaloi atë një kushërire tjetër, e cila, mjerisht, as që mund ta kuptonte. Të tria gratë më në fund vendosën t'i shkruajnë doktor Wolff, duke i kërkuar një shpjegim. Doktor Wolff është në fund të mençurisë së tij:

Zotëri! Kalova muaj në llogore duke u ruajtur prej rusëve dhe nuk mu drodh qerpiku. Por nëse reputacioni im do të shkonte në djall prej kushërirave të mia, do të ishte e padurueshme.

Vetëm ju mund të më ndihmoni. E keni për detyrë; sepse jeni ju që më futët në këtë rrëmujë. Kështu që ju lutem më tregoni se çfarë duhet të mendojë ime kushërirë kur lexon Metamorfozën.

I juaji sinqerisht,

Dr. Siegfried Wolff

E njëjta letër shfaqet si epigraf për librin e shkurtër të Saul Friedländer, *Franc Kafka: Poeti i turpit dhe i fajit*, i cili së fundmi është shfaqur në letër. Ashtu si Stach, Friedländer është shumë i interesuar për marrëdhëniet e Kafkës me botën rreth tij, dhe ai është veçanërisht i ndriçuar për çështjen e identitetit të Kafkës, për të përdorur një fjalë shumë në modë sot. Një historian i njohur i Holokaustit, i kushton një kapitull të tërë "Kompleksitetit të errët të Judaizmit". Friedländer argumenton me arsyen se "kërkimi i temave hebraike në krijimtarinë kryesore të Kafkës është problematike", dhe na tregon se Kafka ishte qytetari modern i përkryer: si një grindje identitetesh. Sipas fjalëve të Günther Anders:

Si një çek që flet gjermanisht, [Kafka] nuk është aspak në mesin e çekëve; dhe si një hebre gjermanisht folës, jo krejt në mesin e gjermanëve bohem. Si një bohem, nuk përfshihet tek austriakët. Si një zyrtar i një kompanie sigurimesh, përjashtohet dhe nga shtresa e mesme. Megjithatë, si bir i një familjeje jo i klasës së mesme, përjashtohet dhe nga klasa punëtore.

Kafka, tregon Friedländer, qe i interesuar për temat hebraike, por marrëdhënia e tij me sionizmin e mikut të ngushtë Max Brod, mbeti ambivalente në rastin më të mirë të saj. Ndërkohë, Friedländer shkruan "*përshtypja e përgjithshme që merr nga ditarët dhe letrat është ajo e indiferencës ndaj çështjeve botërore dhe politikës së brendshme*".

Tregimet e Kafkës, natyrisht, nuk shpjegohen prej biografisë së tij – por ndriçohen prej saj. Nëse Kafka shpesh lexohet si profet i mizorive që do të vijnë, kjo ndodh sepse ai jetoi në një kohë kur retë e stuhisë që dukeshin në horizont kishin filluar tashmë të bashkoheshin. Me gjithë indiferencën e tij të dukshme ndaj politikës, ai vështirë se ishte i pavëmendshëm ndaj kërcënimit në rritje të antisemitizmit evropian. Siç tregon Friedländer, Kafka reagoi i shqetësuar ndaj trazirave anti-hebreje në Pragë në vitin 1920, duke i shkruar Milenës:

Një ditë më parë dëgjova dikë që i quajti hebrenjtë 'racë zgjebarake'. A nuk është e natyrshme të largohesh nga një vend ku dikush është kaq i urryer? (Sionizmi apo patriotizmi nuk përfshihen fare këtu.) Heroizmi i të qëndruarit është gjithsesi thjesht heroizmi i buburrecëve që nuk mund t'i heqësh qafe as nga banja. Sapo vështrova kah dritarja: policë të armatosur, xhandarë me bajoneta të vidhosura, një turmë që ulëret shpërndahet dhe këtu lart në dritare u krijua gjendja e turpit të pakëndshëm i të jetuarit nën mbrojtje të vazhdueshme.

Pra, lidhja retrospektive me Holokaustin dhe Luftën e Dytë Botërore nuk është e dobët. Nëse ai nuk do t'i nënshtrohej konsumit në vitin 1924, Kafka kishte më shumë gjasa të duronte një fat të ngjashëm me atë që pësuan të motrat, shokët e klasës, miqtë e tij – e gjithë bota që njihte dhe ku u rrit.

Faqet e fundit – "Shënime biografike" – të *A është ai Kafka*? janë disa nga më rraskapitëset që kam lexuar ndonjëherë. Ato përmbledhin, shkurtimisht, fatin e familjes së mbijetuar të Kafkës dhe miqve të afërt. Shkrimtari Oskar Baum vdiq në një spital në Pragë në vitin 1941, por e shoqja u dëbua në Theresienstadt ku edhe vdiq; i biri, Leo, vdiq në 22 Korrik 1946, "në bombardimin e hotelit Kind David në Jeruzalem prej një grupi rezistence hebre". Vëllai i Max Brod, Otto, "pianist i shquar", u vra në Auschwitz në 1944. Përkthyesja e Kafkës Milena Jesenská u arrestua nga Gestapo në 1939; ajo vdiq në kampin e përqëndrimit Ravensbrück në 1944. Elli dhe Valli, dy nga motrat e Kafkës, vdiqën në kampin e shfarosjes Chelmno në vitin 1942. Ottla, motra e vogël, u dërgua në Theresienstadt në vitin 1940. Në vitin 1943, ajo doli vullnetare për të "shoqëruar një grup fëmijësh hebre polakë në Auschwitz" dhe vdiq atje pak kohë më pas. Romancieri Ernst Weiss kreu vetëvrasje kur trupat gjermane pushtuan Parisin. Në fund, e fejuara e dytë e Kafkës, Julie Wohryzek e cila u arrestua dhe u dërgua në Auschwitz, ku u vra në vitin 1944. Diku tjetër në libër thuhet se deri në 5 nga 22 shokët e klasës së Kafkës "duket se janë vrarë në kampet e përqëndrimit".

Në vitet e tij të fundit, Kafka kishte flirtuar hera-herës me idenë për të emigruar në Palestinë për të hapur një restorant me të dashurën e tij, Dora Diamant. Por, duke ditur se çfarë ndodhi përfundimisht me botën në të cilën ai kishte jetuar dhe me të gjithë ata që njihte që ende banonin aty, njeriu ndihet jashtëzakonisht mirënjohës që Kafka, të paktën, u kursye nga ato ankthe që nuk i bëri vetë. Ai është fantazma që mbijetoi.

LA Review of Books
Përktheu nga anglishtja:
Antonio Çikollari

MOTRËS NË KARROCË

Poezi nga Arbër Selmani

Kuptohet,
Një ditë do të ecim të dy së bashku
Kur këmbët tua të mos jenë hekur.

Në mes të një autostrade, në pikun e të nxehtit
Do të pijmë ujin e një bjeshke
Autobusëve do t`u buzëqeshim si dy të marrë.

Në mes plantacionesh, ndoshta dorë për dore
Do të vallëzojmë mbi kokra rrushi
Me shputat tona që na butësohen mbi ajvar.

Ti ende mbetesh në një karrocë,
Për botën, e gjymtuar
Për mua, për jetën time, një motër e munguar.

Do ta blejmë bashkë biletën për kinema
Nuk do të shkojmë, do të vazhdojmë ditën duke numëruar qenushet rrugëve
Si qenushet e lagjes që ta lëpijnë gojën çdo mesditë.

Kuptohet,
Një ditë do ta ngasësh ti veturën,
Kur duart tua të mos lëvizin kaq dridhshëm prej temperaturës.

Në mes të detit, të përcëlluar prej Zotit
Do të notojmë, ndoshta krah për krah
Trupin tënd do ta lëmë të cicërojë si zog mëngjesi.

Ti ende mbetesh në një karrocë,
Që peshon mbi mua dhimbje, padrejtësi, rëndesë,
Për mua që harxhohem, që s`pranoj, që kam shpresë.

Do të çlirohet trupi yt, e do të marrim dy biçikleta
Do t'i futemi shtegut më të gjelbër
Do t'ua shprehim drunjve e dheut dashurinë pa kushte.

Ti ende mbetesh në një karrocë,
Për librin e mrekullive, e harruar
Për një vëlla zemërthyer si unë, e munguar.

Kuptohet,
Një ditë do të bëjmë gjithçka që bën një vëlla e një motër,
Do të paguajmë për dekorimet që nuk na duhen
Do ta lëndojmë njëri tjetrin
Do t`i urrejmë dasmat
Qysh tash e dëgjoj ankesën tënde për pizhamat që t`i vodha
Do të ketë lot mungese
Do t'a pëlqejmë të njëjtin qytet
Do të ngushëllohemi për dashuritë që vdesin pa lindur
Do të pijmë një kafe mëngjesi buzë liqenit
Do të skijojmë bashkë, do të ngjitemi në maje mali.

Ti ende mbetesh në një karrocë
Në një objekt që të mban në jetë, që sheh para teje
Ta përplasë një shuplakë që unë kurrë nuk doja ti ta ndjeje.

Kuptohet,
Do ta njohësh edhe ti botën, një ditë, e di
Do ta njohësh Iranin, Japoninë, gëzimin, plotninë.
Do të ecësh pa mua, pa të mbajtur, pa të shtyrë nga prapa,
Këmbët tua do të bëjnë vetë hapa,
Pa inatet e mia, pa mërzitë e mia, pa kilogramët e mi të psikozës
Se unë peshoj më rëndë se ti, unë peshoj vetmi, unë peshoj një motër gri
E ti peshon shumë forcë e fuqi, në karrocën kaltër e zi.



ROJET E NATËS

Dr. Bledar Kurti

Rojet e Natës (1642) është padyshim një prej veprave më të shquara në historinë e artit. Por, ndoshta për habinë e shumë artdashësve, kjo kryevepër e artistit holandez, Rembrandt van Rijn (1606-1669), i njohur gjerësisht si Rembrandt, është një tablo dite e jo nate. Pra, rojet e ditës e jo të natës. Ajo mori këtë titull vetëm në fund të shekullit të 18-të, shumë kohë më vonë pasi u realizua kjo vepër, për shkak të nxirjes së tablosë nga pesha e kohës, duke krijuar kështu atmosferën e natës.

Rembrandt është një nga figurat më vigane të historisë së artit evropian, madje shumë studiues e konsiderojnë si piktorin më të madh të gjitha kohërave. Ai punoi brenda traditës së rreptë të artit protestant holandez dhe nuk doli kurrë jashtë Holandës. Megjithatë, jo vetëm që teknikisht ishte i jashtëzakonshëm si piktor, por shpalosi edhe një optikë të re mbi artin dhe imazhin: askush përpara Rembrandt nuk i paraqiti gjërat e zakonshme njerëzore të dukeshin aq thellësisht serioze dhe interesante. Në skenat e tij historike dhe biblike, sikurse edhe në portretet e të pasurve dhe të varfërve, Rembrandt duket sikur të prek drejtpërdrejtë në zemër.

Në vitin 1634 Rembrandt u martua me Sakia van Uylenburgh, mbesën e ortakut të tij. Ata blenë një shtëpi së bashku, por tre nga fëmijët vdiqën, dhe pas tyre vdiq edhe bashkëshortja e tij, Sakia. I njohur si artisti më i shquar por edhe më i përvuajturi i kohërave, gjatë asaj periudhe të rëndë e të vështirë të jetës së tij, Rembrandt pikturoi tablonë e tij më të fuqishme, e cila njihet sot si, *Rojet e Natës*.

Për ta kuptuar më mirë këtë vepër duhet të njohim kontekstin historik gjatë së cilës ajo u krijua. Që nga Reformacioni Protestant i nisur nga Martin Luther, ndarja e Evropës në një kamp katolik e një tjetër Protestant, preku edhe artin e vendeve të vogla si Holanda. Në vendet katolike, si Franca, Belgjika, Italia dhe Spanja, artistët merrnin porosi të ndryshme nga kisha e cila donte të shpaloste madhështinë e saj si reagim ndaj Reformacionit Protestant. Besimtarët e pasur porosisnin piktura biblike, pasi katolicizmi e inkurajonte imazherinë e temave biblike dhe të lashtësisë, duke qenë se ikonat dhe statujat e Krishtit, Marisë, dhe shenjtorëve ishin edhe objekt adhurimi dhe devocioni, ndërsa në vendet protestante, si Holanda, Gjermania, vendet skandinave, Anglia, etj., besimtarët besonin tek Perëndia i gjallë dhe i konsideronin idhujtari ikonat apo fytyrat kristologjike, ndaj ata ishin më modestë, njerëz të devotshëm, punëtorë të zellshëm, kursimtarë, dhe nuk i pëlqente karakteri i fryrë i vendeve katolike. Kësisoj artistët në vendet protestante merrnin më pak porosi për të pikturuar tematika biblike, por edhe kur krijonin vepra të tilla ato ishin më shumë shpallje e besimit të tyre, apo përjetime personale ndaj besimit të krishterë, siç bëri Rembrandt duke pikturuar veten e tij gjatë kryqëzimit të Krishtit, duke shpallur se ishte edhe ai që e kryqëzoi Zotin, dhe se Krishti vdiq në atë kryq edhe për mëkatet e tij, ndaj kjo qasje personale shërbeu si shtysë për krijimin e kryeveprave të ndiera dhe tejet emocionale, me ngjyrosje romantike ndaj besimit.

Në shekullin e 17-të Holanda ishte në kulmin e saj ekonomik dhe ushtarak. Rivalja e saj ushtarake por edhe fetare ishte Spanja. Artistët holandezë pikturonin kryesisht portrete sipas kërkesave të njerëzve të pasur të cilët kërkonin të kishin pikturat e njerëzve të tyre të dashur, ose kërkesa nga institucionet qeveritare të cilat donin të shpalosnin autoritetin e tyre përpara publikut. Disa vite përpara se të krijohej kjo vepër, grupet e milicisë holandeze kishin qenë forca të rëndësishme vullnetare të cilat ndihmuan në mbrojtjen e Holandës nga pushtimi spanjoll: por tashmë ato ishin shndërruar në klube sociale për qytetarë të rëndësishëm. Kjo tablo nisi të njihet si *Rojet e Natës* vetëm gjatë dy shekujve të fundit për shkak të nxirjes së saj. Restaurimi i kohëve të fundit zbuloi se ajo është një skenë dite. Vepra njihet edhe si *Parada e Musketierëve*, apo *Kompania e Kapiten Frans Banning Cocq dhe Togerit Willen van Rüytenburch,* të cilat janë më të përshtatshme si titull i veprës, por tashmë titulli *Rojet e Natës* zor se mund të shkëputet nga mendja e publikut.

Qëllimi kryesor i rojeve ishte të mbronin qytetet e tyre. Si të tillë, ata ishin të ngarkuar me ruajtjen e portave, duke siguruar rrugët, duke shuar zjarret dhe duke siguruar rregullin në të gjithë qytetin. Përveç kësaj, ata ishin një prani e rëndësishme në parada të mbajtura për vizitat mbretërore si dhe raste të tjera festive. Secili grup milicie kishte sallën e vet të mbledhjeve si dhe emblemën e vet. Sipas traditës, këto salla të grupeve të milicisë zbukuroheshin me portrete grupore të anëtarëve më të shquar të saj, të cilët shërbyen jo vetëm për të regjistruar ngjashmëritë e këtyre rojeve, por më e rëndësishmja për të mbështetur fuqinë dhe individualitetin e qytetit që ata mbronin. Shkurtimisht, këto imazhe ndihmuan në promovimin e ndjenjës së krenarisë dhe detyrës qytetare.

Në këtë tablo ne shohim qytetarët elitarë të Amsterdamit. Ky grup milicie i pikturuar nga Rembrandt, ishte nën komandën e Kapiten Frans Banning Cocq, i cili mban një pozicion të spikatur e në plan të parë, në qendër të tablosë. Ai mban veshjen formale, ngjyrë të zezë dhe jakën e bardhë me dantella e cila i përkiste shtresës së lartë, të theksuar nga një shirit i kuq përgjatë kraharorit të tij. Në belin e tij ai mban një shpatë (një shpatë e hollë dhe e lehtë) dhe në dorën e tij një shkop, i cili identifikon gradën e tij ushtarake. Me hapin përpara, ai e kthen kokën në të majtë dhe e shtrin fuqishëm dorën e tij të lirë teksa i drejtohet vartësit të tij, togerit Willem van Rüytenburgh, i cili kthehet për të pranuar urdhrat që ai i jep. Ai gjithashtu është i veshur bukur, por në të verdhë të ndritshme, roli i tij ushtarak i referuar nga gjoksorja e çeliktë që ai vesh përreth qafës së tij dhe armës me shtizë në një bosht prej druri që ai mbart. Nëse vrojtoni me kujdes hijen e dorës së majtë të Kapitenit Cocq ajo bie mbi togerin Rüytenburgh, një detaj që shpalos shenjën e hierarkisë dhe autoritetit.

Kjo tablo është një grupim portretesh, e porositur dhe e paguar nga grumbullimi i parave prej të gjithë anëtarëve të milicisë të pikturuar në të. Fatkeqësisht, gjatë shpërnguljes nga holli i milicisë, piktura ka pësuar zvogëlime në pjesën e sipërme dhe anash, duke prerë figura, sidomos në të majtë, duke krijuar një disbalancë të vogël të tablosë. Në versionin origjinal kishte 34 figura, 16 prej të cilave ishin portrete. Secili që figuronte në tablo pagoi 90 gulden. Më vonë, pasi të gjithë këta qytetarë elitarë të Amsterdamit u ndanë nga jeta, në kujtim të tyre u shtua një imazh i një mburoje, e cila dallohet në pjesën qendrore lart tablosë.

Në këtë vepër Rembrandt ka shpalosur një skenë dramatike, karakterizuar nga iluzioni optik, shfrytëzimi i efekteve të veçanta, dhe përdorimi i hije-dritës në mënyrën më të paprecedentë e të magjishme.

Kjo tablo shumë e madhe u përfundua në vitin 1642 dhe u shkurtua në anën e majtë në vitin 1715. Versioni i paprerë përmbante pamje të plota ose të pjesshme të tridhjetë e katër figurave njerëzore dhe një qeni që leh. Tetëmbëdhjetë prej figurave janë modele të porositura. Disa prej tyre kanë shpata me dy tehe, ndërsa të tjerët mbushin pushkë ose gjuajnë me mushqeta. Të kthyera për nga e djathta e tyre, armët, shpatat dhe shtizat, të cilat prekin, shtyjnë ose ndërhyjnë me njëra-tjetrën, konvergjojnë në një model abstrakt të aksionit që fshihet ose nënkuptohet nga retorika ceremoniale e diktuar fort nga udhëheqësit. Por, ashtu si arma që shkrepet pas kapitenit, aksioni është fshehur vetëm pjesërisht. Për një vepër e cila u krijua si simbol i disiplinës, ajo duket sikur është në një kaos të flaktë. Një grup civil rojesh ose milici janë në pikën e marshimit. Kapiteni ka bërë një hap përpara dhe mban dorën e tij jashtë. Daullexhiu rreh daullen e tij. Një njeri i milicisë ngarkon mushqetën e tij. Një vajzë ecën mes tyre. Kaos, megjithatë sa shumë rregull! Rembrandt shpalos një tablo të rregullt në tërësi, pavarësisht dinamikës së lëvizjeve. Një mjeshtëri e vërtetë kompozimi.

Tabloja pati një sukses të madh në atë kohë, e kjo jo vetëm sepse ai e ktheu një tematikë mjaft të rëndomtë në një vepër dinamike të artit. Ndryshe nga portretet e tjera të stilit barok të kompanive e grupeve të milicisë, të cilat tradicionalisht i portretizonin anëtarët e rreshtuar në poza të rregullta ose të ulur në një banket, piktura e Rembrandt tregon se kjo milici ishte e pajisur plotësisht, e gatshme për veprim dhe për të marshuar në mënyrë të menjëhershme. Nuk ka asgjë statike në këtë vepër. Të gjitha figurat janë në lëvizje duke e mbuluar atë me një dinamizëm të rrallë.

Figura më e pazakontë e kësaj vepre është vajza misterioze që shfaqet nga errësira prapa musketierit me të kuqe. Me flokë të bardhë të derdhura dhe me një fustan të bukur prej ari, vajza e re me të gjithë shkëlqimin e saj tërheq vëmendjen e shikuesit. Elementi i saj më i çuditshëm është pula e madhe e bardhë që varet me kokë poshtë nga rripi i mesit të saj. Rëndësia e atij shpendi, veçanërisht kthetrat e tij, i referohen drejtpërdrejtë grupimit të kësaj milicie. Çdo shoqëri milicie kishte simbolin e vet dhe për këtë grup, i njohur si *Kloveniers*, ishte një kthetër e artë mbi një fushë blu. Ndaj vajza nuk është një person i vërtetë, por ajo vepron si një personifikim dhe simbol i këtij grupi milicie.

Me sa duket Rembrandt e krijoi pikturën duke nisur nga sfondi e duke avancuar në planin e përparmë. Duke e nisur nga sfondi i mjegullt ai nisi të shtonte figurat kryesore duke i shpalosur ato gjithnjë e më shumë në plan të parë derisa shikuesi duket se prek dorën e kapitenit dhe armën e togerit, të cilat shfaqen sikur dalin nga tabloja dhe prekin shikuesin. Kjo metodë e pikturimit ka mundësuar një thellësi të skenës dhe ka krijuar efektin tre dimensional e cila e bën veprën të gjallë, dhe shikuesin të ndihet pjesë e atij aksioni.

Teksa u përballa me këtë tablo, në muzeun Rijk, në Amsterdam, befas në mënyrë të pandërgjegjshme ndjeva shtysën ta cingoja me gisht armën në dorën e togerit, pasi isha më se i bindur që do dëgjoja tingëllimën e metalit edhe pse ishte vetëm bojë. Rembrandt ka përdorur pastën e bojës për të materializuar objektet e forta, në mënyrë aq mjeshtërore sa që ato duken të vërteta. Ndërsa drita e portreteve dhe figurave mishore shpalosen edhe më me bukuri sesa e vërteta. Ato kanë një aureolë romantizmi që arrihen në mënyrë unike vetëm nga drita e rrallë e Rembrandt.

Drita e Rembrandt përdoret sot shumë gjerë në fotografi. Fotografët e studios e njohin fare mirë këtë teknikë. Ky është një stil që ndriçon vetëm një anë të fytyrës, por me disa detaje që mbeten në anën e hijes. Tipari i saj kryesor është një theks trekëndor nën syrin në anën e hijes që thekson plasticitetin e fytyrës. Kjo lloj drite shihet më mirë tek autoportretet e Rembrandt, të cilat janë nga më të kërkuarat në botë prej koleksionistëve të artit. Përveçse janë një trashëgimi e vyer artistike, autoportretet e tij janë edhe si një ditar. Mjeshtrit e mëdhenj të artit, përpara tij, si Leonardo, Michelangelo, Dürer, etj. kanë lënë shënime me shkrim, ndërsa Rembrandt nuk la asgjë të shkruar, megjithatë, ne na duket sikur e njohim atë më mirë se cilindo tjetër për arsye se na ka lënë dokumente mahnitëse të jetës së tij në formën e një serie autoportretesh që fillojnë me kohën e rinisë, kur arriti të bëhej mjeshtër i njohur, dhe deri në pleqërinë e vetmuar, ku fytyra i dëshmonte tragjedinë, falimentin financiar dhe vullnetin e pathyer të një njeriu vërtet të madh. Autoportretet e shumta të tij bëhen një autografi e vetme.

Shekulli i 17-të ishte shekulli i artë i pikturës në Holandë. Të frymëzuar nga natyralizmi i mjeshtrit italian, Caravaggio, piktura mori dimensione të reja në vendet e ulëta. Ndër mjeshtrit e shumtë të kohës, Rembrandt zë një vend të veçantë, madje kryesor. Ndonëse i lindur në një qytet universitar ai e braktisi shkollën për t'iu përgjigjur thirrjes epokale të artit.

Megjithëse skenat ilustruese nga Bibla dhe piktura të mëdha të historisë kishin dalë jashtë mode, Rembrandt mbeti i përkushtuar ndaj zhanrit të kompozimit, i shtyrë nga një përkushtim i thellë ndaj besimit të krishterë dhe një ndjeshmërie të theksuar për gjendjen njerëzore. Ai është quajtur edhe si një nga profetët e mëdhenj të artit dhe qytetërimit për shkak të interpretimit njerëzor që ai u bëri atyre tregimeve të vjetra. Një i krishterë protestant i devotshëm, ai u frymëzua nga Bibla dhe krijoi veprat më madhështore të krishterimit si *Sakrifica e Abrahamit, Kthimi i Djalit Plangprishës, Ringjallja e Lazarit, Kryqëzimi i Krishtit, Stuhia në Detin e Galilesë,* të gjitha të shtyra nga besimi personal, nga vuajtja vetjake, dhe aftësia e rrallë për të prekur zemrat e shikuesve përmes dritës, burimit të artit dhe vetë jetës.

Mjeshtri spanjoll, Francesco Goya do shprehej kështu për Rembrandt: "Kam patur vetëm tre mjeshtër në jetën time: Natyra, Velázquez, dhe Rembrandt.» Ndërsa skulptori francez Auguste Rodin tha: «Më krahasoni mua me Rembrandt! Çfarë sakrilegji! Me Rembrandt, kolosin e Artit? Ne duhet të shtrihemi përdhe përpara Rembrandt dhe të mos krahasojmë askënd me të!" Ndërsa Vincent Van Gogh shkroi: "Rembrandt i shkon aq thellë të mistershmes sa që ai thotë gjëra për të cilat nuk gjenden dot fjalë në asnjë gjuhë. Është e drejtë që atë e quajnë magjistar të artit."

FITUESIT E PANAIRIT TË LIBRIT “FIERI 2021”

Dje u mbyll edicioni i 8-të i Panairit Kombëtar të Librit “Fieri 2021”.
Në përfundim, juria e përbërë prej kritikut të njohur, Ali Aliu, dhe drejtueses së Fondacionit HARPA, zonjës Majlinda Rama, dha këto vlerësime:

Çmimi i karrierës
HELENA KADARE

me motivacionin:

"Për vlera të larta krijuese. Ka ndërtuar kode unike ligjërimi, duke e pasuruar prozën romanore shqipe. Shkrimtare me ndikim në letërsinë tonë kombëtare."

Romani më i mirë
MEHMET KRAJA
për romanin "Sëmundja e ëndrrave"

me motivacionin:

"Për kërkimet e tij në të kaluarën historike të shqiptarëve në përgjithësi, frymëzimin nga ajo e kaluar, por gjithnjë parë nga perspektiva e një distance dhe optikës bashkëkohore. Për raportet dhe mpleksjet mes mitit dhe realitetit, të ëndrrës dhe zgjëndrrës që është bosht tematik i romanit."

Libri poetik më i mirë
BARDHYL LONDO
për librin "Prill i hidhur"

me motivacionin:

"Për nivel të lartë artistik dhe estetik në vëllimin "Prill i hidhur". Krijime që e kanë çuar poetin në përsosmëri majash në poezinë bashkëkohore shqiptare."





Studimi më i mirë
FATMIR TOÇI
për librin "Arbëreshët midis realitetit dhe mitit"

me motivacionin:

"Për hulumtimin pasionant të golgotës migruese të arbëreshëve dhe paraqitjen me emocion të lidhjes shpirtërore të tyre me vendlindjen gjatë pesë shekujve."

Çmimi i publikut
Gazeta ExLibris

me motivacionin:

"Për pasqyrimin me profesionalizëm të ngjarjeve kulturore e letrare, si dhe shpalosjen dhe promovimin e vlerave më të mira në fusha të ndryshme."